



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

www.qpz.gov.al

Nr.152

5 tetor

2008

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Ligj nr.9988
datë 15.9.2008

Për ratifikimin e “Marrëveshjes së financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Europiane për programin ndërkufitar Shqipëri-Mali i Zi, për vitin 2007, nën instrumentin e ndihmës së paraaderimit (IPA), komponenti II - bashkëpunimi ndërkufitar, Shqipëri”

7491

LIGJ
Nr.9988, datë 15.9.2008

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË FINANCIMIT NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KOMISIONIT TË
KOMUNITETEVE EUROPIANE PËR PROGRAMIN NDËRKUFITAR SHQIPËRI – MALI I
ZI, PËR VITIN 2007, NËN INSTRUMENTIN E NDIHMËS SË PARAADERIMIT (IPA),
KOMPONENTI II - BASHKËPUNIMI NDËRKUFITAR, SHQIPËRI”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja e financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Europiane për programin ndërkufitar Shqipëri – Mali i Zi, për vitin 2007, nën instrumentin e ndihmës së paraaderimit (IPA), komponenti II - bashkëpunimi ndërkufitar, Shqipëri”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekreten nr.5896, datë 1.10.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

MARRËVESHJE FINANCIMI
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE KOMISIONIT TË KOMUNITETEVE EUROPIANE MBI PROGRAMIN
NDËRKUFITAR SHQIPËRI-MALI I ZI PËR VITIN 2007, NËN INSTRUMENTIN E ASISTENCËS
SË PARAADERIMIT (IPA) KOMPONENTI II - BASHKËPUNIMI NDËRKUFITAR SHQIPËRI

datë

(Menaxhimi i centralizuar)

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Komisioni i Komuniteteve Europiane, në vijim referuar bashkërisht si "Palët" ose individualisht si "Vendi përfitues", në rastin e Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë ose “Komisioni”, në rastin e Komisionit,

duke pasur parasysh se:

a) Më 1 gusht 2006 Këshilli i Bashkimit Europian miratoi rregulloren (EC) nr.1085/2006 që krijon një instrument të asistencës për paraaderimin (në vijim: "Rregullorja kuadër IPA"). Me efekt nga 1 janari 2007, ky instrument përfaqëson bazën e vetme ligjore për dhënien e asistencës financiare për vendet candidate (aktualisht Kroacia, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë dhe Turqia) dhe vendet candidate potenciale (Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi dhe Serbia, duke përfshirë Kosovën, sipas rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara), në përpjekjet e tyre për të forcuar reformat politike, ekonomike dhe institucionale me perspektivën për t'u bërë anëtarë të Bashkimit Europian;

b) Më 12 qershor 2007 Komisioni miratoi rregulloren (EC) nr.718/2007 që implementon rregulloren kuadër IPA, e cila jep detaje për rregullat e zbatueshme të menaxhimit dhe të kontrollit (në vijim: "Rregullorja e zbatimit IPA");

c) Asistenca komunitare, nën instrumentin e asistencës për paraaderim, duhet të vazhdojë t'i mbështesë vendet përfituese në përpjekjet e tyre për t'i forcuar institucionet demokratike dhe shtetin e së drejtës, reformën në administratën publike, të ndërmarrë reforma ekonomike, të respektojë të drejtat e njeriut dhe ato të minoriteteve, të promovojë barazinë gjinore, të mbështesë zhvillimin e shoqërisë civile dhe të zhvillojë bashkëpunimin rajonal, si dhe ripajtimin dhe rindërtimin, dhe të kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshëm dhe reduktimin e varfërisë.

Për vendet kandidate potenciale, asistenca komunitare mund të përfshijë përafrimin me *acquis communautaire*, si dhe mbështetjen për projekte në investime që kanë për qëllim në veçanti ndërtimin e kapaciteteve menaxhuese në fushat e zhvillimit rajonal, të burimeve njerëzore dhe atë rural;

d) Palët kanë nënshkruar në 18 tetor 2007 një marrëveshje kuadër, që përcakton rregullat e përgjithshme për bashkëpunim dhe implementimin e asistencës komunitare nën instrumentin e asistencës së paraaderimit;

e) Më 18 dhjetor 2007 Komisioni miratoi programin ndërkufitar ndërmjet Shqipërisë dhe Malit të Zi nën komponentin për bashkëpunimin kufitar IPA për 2007 (në vijim tutje: "Programi"). Ky program duhet të implementohet nga Komisioni në mënyrë të centralizuar;

f) Për implementimin e këtij programi është e nevojshme që palët të nënshkruajnë një marrëveshje financimi për të përcaktuar kushtet për dhënien e asistencës komunitare, rregullat dhe procedurat që lidhen me disbursimin e kësaj asistence dhe kushteve sipas të cilave do të menaxhohet kjo asistencë,

kanë rënë dakord si më poshtë vijon.

1. Programi

Komisioni do të kontribuojë me anë të një granti për financimin e programit në vijim, i cili është përcaktuar në aneksin A të kësaj Marrëveshjeje.

Numri i programit: 2007/019-366 (CRIS)

Titulli: Programi ndërkufitar ndërmjet Shqipërisë dhe Malit të Zi nën komponentin e bashkëpunimit ndërkufitar IPA për vitin 2007.

2. Zbatimi i programit

1) Programi do të zbatohet nga Komisioni në mënyrë të centralizuar, sipas nenit 53a të rregullores së Këshillit (EC Euratom) nr.1605/2002 mbi rregulloren financiare të zbatueshme për buxhetin e përgjithshëm të Komuniteteve, të ndryshuar sipas rregullores (EC, Euratom) 1995/2006 të datës 13 dhjetor 2006 (në vijim: "Rregullorja financiare").

2) Programi do të zbatohet në përputhje me dispozitat e marrëveshjes kuadër mbi rregullat për bashkëpunimin që lidhen me asistencën financiare të BE-së për Shqipërinë dhe zbatimin e asistencës në kuadër të instrumentit të paraaderimit (IPA) të arritur ndërmjet Palëve në 18 tetor 2007 (në vijim: "Marrëveshja kuadër"), e cila përcaktohet në aneksin B të kësaj Marrëveshjeje.

3. Strukturat dhe autoritetet përgjegjëse

1) Përfituesi do të caktojë një koordinator kombëtar IPA në përputhje me Marrëveshjen kuadër, i cili do të veprojë si përfaqësuesi i Përfituesit kundrejt Komisionit. Ai duhet të sigurojë që të ruhet një lidhje e ngushtë ndërmjet Komisionit dhe Përfituesit si për procesin e përgjithshëm të aderimit, ashtu edhe për asistencën e BE-së për paraaderim nën instrumentin IPA.

2) Koordinator kombëtar IPA do të jetë, gjithashtu, përgjegjës për koordinimin e pjesëmarrjes së vendit përfitues në programet përkatëse ndërkufitare, si dhe në programet transnacionale, ndërrajonale ose në programet që përfshijnë vende që lagen nga dete, nën instrumente të tjera të Komunitetit.

3) Vendi përfitues duhet të ngrejë një strukturë operuese për pjesën e programit në territorin e vet. Kjo strukturë operuese duhet të bashkëpunojë ngushtë përgjatë zbatimit të këtij programi me strukturën operuese të vendit tjetër pjesëmarrës.

4) Sipas nenit 142 të rregullores së zbatimit IPA, strukturat operuese të vendeve pjesëmarrëse duhet të ngrenë një sekretariat të përbashkët teknik për të asistuar strukturat operuese dhe komitetin e përbashkët monitorues në përmbushjen e detyrave të tyre përkatëse.

Sekretariati i përbashkët teknik mund të ketë antenë të ngritur në secilin vend pjesëmarrës.

5) Funksionet dhe përgjegjësitë e strukturave operuese do të përcaktohen në programet ndërkufitare relevante, me përjashtim të tenderimit, kontraktimit dhe pagesave, të cilat janë përgjegjësi

e Komisionit.

4. Financimi

Financimi për implementimin e kësaj Marrëveshjeje do të jetë si me poshtë:

a) Kontributi i Komunitetit për vitin 2007 është përcaktuar në një maksimum prej 853,000 €, siç jepet me detaje në shtojcën A1 të aneksit A të kësaj Marrëveshjeje. Megjithatë, pagesa e kontributit të Komunitetit nga Komisioni do të bëhet brenda limiteve të fondeve në dispozicion.

b) Kostoja e strukturave dhe autoriteteve të ngritura nga vendi përfitues për implementimin e këtij programi do të mbulohet nga Përfituesi, me përjashtim të kostove të referuara në nenin 94(1)(f) të rregullores së zbatimit IPA.

5. Afati përfundimtar për nënshkrimin e kontratave

1) Kontratat dhe marrëveshjet individuale të cilat zbatojnë këtë Marrëveshjeje do të nënshkruhen jo më vonë se dy vjet nga data e përfundimit të kësaj Marrëveshjeje.

2) Në raste të justifikuara siç duhet, ky afat kontraktimi mund të zgjatet përpara datës së përfundimit të tij për një periudhë maksimale prej tre vjetësh nga data e përfundimit të kësaj Marrëveshjeje.

3) Çdo financim për të cilin nuk është nënshkruar një kontratë përpara afatit të kontraktimit, do të anulohet.

6. Afati për ekzekutimin e kontratave

1) Kontratat duhet të zbatohen maksimumi brenda dy vjetësh që nga data e nënshkrimit të tyre.

2) Në raste të justifikuara siç duhet, afati përfundimtar i zbatimit të kontratave mund të shtyhet përpara datës së përfundimit të tyre.

7. Afati i disbursimit

1) Disbursimi i fondeve duhet të bëhet jo më vonë se një vit nga data përfundimtare e ekzekutimit të kontratave.

2) Në raste të justifikuara siç duhet, afati për disbursimin e fondeve mund të shtyhet përpara datës së përfundimit të saj (kontratës).

8. Trajtimi i fitimeve

1) Fitimet, për qëllime të IPA-s, përfshijnë të ardhurat e fituara nga një aktivitet gjatë periudhës së bashkëfinancimit të IPA-s, duke filluar nga shitjet, qiratë, regjistrimet/tarifat e shërbimit ose të ardhura të tjera ekuivalente, me përjashtim të:

a) fitimeve të nxjerra gjatë jetës ekonomike të investimeve të bashkëfinancuara në raste të investimeve në firma;

b) fitimeve të nxjerra brenda kuadrit të një mase financiare projektimi, duke përfshirë kapitalin e një sipërmarrjeje dhe fondet e huasë, fondet e garancisë, lizingun;

c) aty ku është e zbatueshme, kontributeve nga sektori privat për bashkëfinancimin e aktiviteteve, të cilat do të paraqiten së bashku me kontributin publik në tabelat financiare të programit.

2) Fitimet, siç përkufizohen në paragrafin 1 më lart, paraqesin të ardhura të cilat duhet të zbriten nga shuma e shpenzimeve të lejueshme për aktivitetin në fjalë. Jo më vonë se mbyllja e programit, këto fatura duhet të zbriten nga shpenzimet e lejueshme relevante për aktivitetin në shumën e tyre të plotë ose proporcionalisht, në varësi të faktit nëse burojnë plotësisht ose pjesërisht nga aktiviteti i bashkëfinancuar.

9. Shpenzimet e lejueshme

1) Shpenzimi sipas këtij programi do të jetë i lejueshëm për kontributin e Komunitetit, nëse ai është kryer aktualisht pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje.

2) Shpenzimet e mëposhtme nuk do të jenë të lejueshme për kontributin e Komunitetit sipas programit në aneksin A:

a) taksat, duke përfshirë taksat mbi vlerën e shtuar (TVSH);

b) detyrimet doganore dhe të importit, ose çdo detyrim tjetër;

c) blerjet, dhëniet me qira ose me lizing të truallit dhe godinave ekzistuese;

d) gjokat, ndëshkimet financiare dhe shpenzimet për proceset gjyqësore;

e) kostot operacionale;

f) pajisje të dorës së dytë;

g) detyrime bankare, kostot e garancive dhe detyrime të ngjashme;

h) kostot për shkëmbime, detyrime dhe humbje nga këmbimi valutor, të lidhura me ndonjë komponent specifik të llogarive bankare në euro, si dhe shpenzime të tjera tërësisht financiare;

i) kontribute në natyrë;

j) interesi mbi borxhin.

3) Me anë të derogimit nga paragrafi 2 më lart, shpenzimet e mëposhtme do të jenë të lejueshme:

a) taksat mbi vlerën e shtuar, nëse përmbushen kushtet e mëposhtme:

i) nuk janë të rikthyeshme në asnjë lloj mënyre;

ii) është përcaktuar që ato janë kryer nga përfituesi përfundimtar; dhe

iii) janë të identifikuar qartë në projektpropozim;

b) detyrimet për transaksione financiare transnacionale;

c) në rast se zbatimi i një veprimi kërkon që të hapet një ose më shumë llogari të veçanta, detyrimet bankare për hapjen dhe administrimin e llogarive;

d) kostot për konsulencë ligjore, kostot noteriale, kostot për ekspertë teknikë ose financiarë, dhe kostot financiare ose të auditimit, nëse ato janë të lidhura direkt me veprimin e bashkëfinancuar dhe janë të nevojshme për përgatitjen ose zbatimin e tij;

e) kostot e garancisë të siguruara nga një bankë ose institucione të tjetra financiare, në shkallën që kërkohen nga legjislacioni kombëtar ose ai i Komunitetit;

f) shpenzime të përgjithshme, me kusht që të jenë të bazuara në kosto reale që i atribuohen zbatimit të aktivitetit përkatës. Normat bazë të llogaritura mbi bazën e kostove mesatare nuk mund të kalojnë 25 % të atyre kostove direkte të një aktiviteti, i cili mund të ndikojë në nivelin e shpenzimeve të përgjithshme. Për llogaritja duhet të dokumentohet në mënyrën e duhur dhe të rishikohet periodikisht;

g) blerja e truallit me një shumë prej deri në 10% të shpenzimeve të lejueshme të aktivitetit përkatës.

4) Përveç asistencës teknike për programin ndërkufitar, të referuar në nenin 94 të rregullores së zbatimit IPA, shpenzimet e mëposhtme të paguara nga autoritete publike gjatë përgatitjes dhe implementimit të një aktiviteti do të jenë të lejueshme:

a) kostot e shërbimeve profesionale të ofruara nga një autoritet publik që është i ndryshëm nga përfituesi përfundimtar gjatë përgatitjes ose implementimit të një aktiviteti.

b) kostot për sigurimin e shërbimeve që lidhen me përgatitjen dhe implementimin e një aktiviteti të ofruar nga një autoritet publik, i cili është vetë përfituesi përfundimtar dhe që kryen një aktivitet për llogari të tij, pa kërkuar ofrues shërbimesh të tjerë nëse ato janë kosto shtesë dhe lidhen ose me shpenzime të paguara aktualisht dhe direkt për aktivitetin e bashkëfinancuar.

1.1 Autoriteti publik përkatës duhet ose t'ia faturtojë kostot e referuara në pikën (a) të këtij paragrafi përfituesit përfundimtar, ose t'i vërtetojë këto kosto në bazë të dokumenteve me vlerë të njëjtë provuese, të cilat bëjnë të mundur identifikimin e kostove reale të paguara nga ai autoritet për atë aktivitet.

1.2 Kostot e referuara në pikën (b) të këtij paragrafi duhet të vërtetohen me anë të dokumenteve të cilat bëjnë të mundur identifikimin e kostove reale të paguara nga autoriteti publik përkatës për atë veprim.

5) Pa cenuar dispozitat në paragrafët 1 deri 4, rregulla të mëtejshme mbi shpenzimet e lejueshme mund të përcaktohen në programin ndërkufitar në aneksin A të kësaj Marrëveshjeje.

10. Ruajtja e dokumenteve

1) Të gjitha dokumentet që lidhen me programin në aneksin A duhet të ruhen të paktën për pesë vjet që nga data në të cilën Parlamenti Europian mbyll vitin buxhetor të cilit i përket dokumenti.

2) Në rast se programi në aneksin A nuk është mbyllur përfundimisht brenda afatit të përcaktuar në paragrafin 1 më lart, dokumentet e lidhura me të duhet të ruhen deri në fund të vitit i cili pason vitin në të cilin programi në aneksin A është mbyllur.

11. Plani për decentralizimin pa kontrollë *ex-ante*

1) Vendi përfitues duhet të përcaktojë një plan të detajuar me etapa treguese dhe afate kohore për të arritur decentralizimin me kontrollë *ex-ante* nga Komisioni. Përveç kësaj, vendi përfitues duhet të hartojë një plan tregues për të arritur decentralizimin pa kontrollë *ex-ante* nga Komisioni.

2) Komisioni duhet të monitorojë zbatimin e planeve të përmendura në paragrafin 1, dhe të marrë parasysh rezultatet e arritura nga vendi përfitues në këtë kontekst, veçanërisht në sigurimin e

asistencës. Plani për të arritur decentralizimin pa kontrolle *ex-ante* mund t'i referohet heqjes dore gradualisht nga tipet e ndryshme të kontrolleve *ex-ante*.

3) Vendi përfitues duhet të mbajë të informuar rregullisht Komisionin mbi progresin e arritur në zbatimin e këtij plani.

12. Interpretimi

1) Në bazë të ndonjë dispozitë të shprehur në kundërshtim me këtë Marrëveshje, termat e përdorura në këtë Marrëveshje duhet të kenë të njëjtin kuptim me termat e dispozitave të rregullores kuadër IPA dhe Rregullores së Zbatimit IPA.

2) Në bazë të një dispozitë të shprehur në kundërshtim me këtë Marrëveshje, referencat e kësaj Marrëveshjeje do të jenë referenca të një Marrëveshjeje të tillë, të ndryshuar, plotësuar apo zëvendësuar herë pas here.

3) Çdo referencë ndaj rregulloreve të Këshillit apo Komisionit është bërë ndaj versionit të tyre siç është treguar. Nëse kërkohet, modifikimet e këtyre rregulloreve duhet të zhvendosen në këtë Marrëveshje me anë të amendimeve.

4) Titujt në këtë Marrëveshje nuk kanë domethënie ligjore dhe nuk cenojnë interpretimin e saj.

13. Pavlefshmëria e pjesshme dhe të metat e paqëllimshme

1) Nëse një dispozite e kësaj Marrëveshjeje është ose bëhet e pavlefshme ose kjo Marrëveshje përmban të meta të paqëllimita, kjo nuk do të ndikojë në vlefshmërinë e dispozitave të tjera të kësaj Marrëveshjeje. Palët do të zëvendësojnë çdo dispozitë të pavlefshme me një dispozitë të vlefshme, e cila është sa më afër qëllimit dhe objektivit të dispozitës së pavlefshme.

2) Palët do të ndreqin çdo të metë të paqëllimtë nëpërmjet një dispozite e cila i përshtatet sa më mirë qëllimit dhe objektivit të kësaj Marrëveshjeje, në përputhje me rregulloren kuadër IPA dhe rregulloren e zbatimit IPA.

14. Rishikimi dhe amendimi

1) Zbatimi i kësaj Marrëveshjeje do t'i nënshtrohet rishikimeve periodike në kohë të rënë dakord ndërmjet Palëve.

2) Çdo amendim për të cilin është rënë dakord ndërmjet Palëve do të jetë me shkrim dhe do të jetë pjesë e kësaj Marrëveshjeje. Amendime të tilla do të hyjnë në fuqi pasi vendosen ndërmjet Palëve.

15. Përfundimi

1) Pa cenuar paragrafin 2, kjo Marrëveshje do të përfundojë tetë vjet pas hyrjes së saj në fuqi. Ky përfundim nuk do të përjashtojë mundësinë që Komisioni të bëjë korrigjime financiare në përputhje me nenin 56 të rregullores së zbatimit IPA.

2) Kjo Marrëveshje mund të përfundojë nga secila Palë duke informuar me shkrim Palën tjetër. Ky përfundim do të ketë efekt gjashtë muaj kalendarike që nga data e njoftimit me shkrim.

16. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1) Mosmarrëveshjet e lindura nga interpretimi, operimi dhe zbatimi i kësaj Marrëveshjeje, në secilën prej dhe të gjitha nivelet e pjesëmarrjes, do të rregullohen miqësisht nëpërmjet konsultimit mes Palëve.

2) Në mungesë të zgjidhjeve miqësore, secila Palë mund ta paraqesë çështjen për arbitrazh në përputhje me rregullat opsionale për arbitrazh të Gjykatës së Përhershme të Arbitrazhit që lidhen me Organizatat Ndërkombëtare dhe shtetet, në fuqi në datën e kësaj Marrëveshjeje.

3) Gjuha që do të përdoret në procedimet e arbitrazhit do të jetë anglishtja. Autoriteti caktues do të jetë Sekretari i Përgjithshëm i Gjykatës së Përhershme të Arbitrazhit, pas një kërkesë me shkrim të dërguar nga secila prej Palëve. Vendimi i arbitrit do të jetë detyrues për të gjitha palët dhe nuk do të ketë asnjë apel.

17. Njoftime

1) Çdo komunikim në lidhje me këtë Marrëveshje do të bëhet me shkrim dhe në gjuhën angleze. Çdo komunikim duhet të firmoset dhe duhet të dërgohet si një dokument origjinal ose me faks.

2) Çdo komunikim në lidhje me këtë Marrëveshje duhet të dërgohet në adresat e mëposhtme:

Për Komunitetin:

z.Helmuth Lohan
Shef i Delegacionit
Delegacioni i Komisionit European në
Shqipëri
Rruga e Durrësit 127-1
Laparakë-Tiranë
Fax: + 355 4230752

Për Vendin Përfitues:

znj.Majlinda Bregu
Ministër i Integritetit European
Bul.Dëshmorët e Kombit
Tiranë, Shqipëri
Fax +355 4256267

18. Gjuha

Marrëveshja e Financimit është hartuar në dy kopje në gjuhën angleze.

19. Anekset

Anekset A, B dhe C do të formojnë pjese përbërëse të kësaj Marrëveshjeje.

20. Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi ditën e nënshkrimit të saj. Në rast se palët nënshkruajnë në data të ndryshme, kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit nga pala e dytë.

Nënshkruar, për dhe në emër të Komisionit

Z. Helmuth Lohan
Shef i Delegacionit të Komisionit European
Tiranë
Datë:

Nënshkruar, për dhe në emër të Këshillit të
Ministrave të Republikës së Shqipërisë

Znj. Majlinda Bregu
Ministër i Integritetit
Tiranë
Datë:

ANEKSI A Programi ndërkufitar ndërmjet Shqipërisë dhe Malit të Zi nën komponentin bashkëpunimi ndërkufitar IPA për vitin 2007, miratuar me vendimin e Komisionit C(2007)6342.

Shtojca A1 Propozimi i Financimit për vitin 2007 për Programin Ndërkufitar Shqipëri-Mali i Zi.

Shtojca A2 Programi Ndërkufitar Shqipëri-Mali i Zi 2007-2009 IPA CBC.

ANEKSI B Marrëveshja kuadër ndërmjet Komisionit të Komuniteteve Europiane dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë datë 18 tetor 2007.

ANEKSI C Raportimi

1) Struktura Operuese të vendeve përfituese në një program ndërkufitar duhet t'i dërgojnë Komisionit dhe Koordinatorëve Kombëtare përkatës IPA një raport vjetor dhe një raport përfundimtar mbi zbatimin e programit ndërkufitar pas kontrollit të tyre nga Komiteti i Përbashkët i Monitorimit

1.3 Raporti vjetor duhet të dërgohet çdo vit brenda datës 30 qershor dhe për herë të parë në vitin e dytë që pason miratimin e programit ndërkufitar.

1.4 Raporti përfundimtar duhet të dërgohet jo më vonë se 6 muaj pas mbylljes së këtij programi ndërkufitar.

2) Raportet e referuara në paragrafin 1 duhet të përmbajnë informacionin e mëposhtëm:

a) progresin e bërë gjatë zbatimit të programit ndërkufitar dhe prioritetet në lidhje me qëllimet specifike, të verifikueshme, me një përcaktim sasior, kurdo dhe kudo që kjo të jetë e mundur, duke përdorur treguesit në nenin 94 (1) (d) të rregullores së zbatimit IPA në nivel të akteve prioritare;

b) hapat e ndërmarra nga Strukturat Operuese për të siguruar cilësinë dhe efektivitetin e zbatimit, në veçanti:

- masat monitoruese dhe vlerësuese, duke përfshirë masat për mbledhjen e të dhënave;
- një përmbledhje të problemeve të rëndësishme të hasura në zbatimin e këtij programi ndërkufitar dhe çdo masë të marrë;
- përdorimin e asistencës teknike;

c) masat e marra për të siguruar informimin dhe publicitetin mbi këtë program ndërkufitar.

1.5 Aty ku është e përshtatshme, informacioni i referuar në pikat (a) deri (c) të këtij paragrafi

mund të jepen në formë të përmbledhur.

1.6 Nuk është e nevojshme që informacioni i referuar në pikën (b) të përfshihet nëse nuk ka pasur një ndryshim të rëndësishëm që nga raporti i mëparshëm.

SHTOJCA A 1
PROPOZIMI FINANCIAR PËR VITIN 2007
PËR PROGRAMIN NDËRKUFITAR SHQIPËRI-MAL I ZI

1. Identifikimi

Përfituesit	Shqipëria dhe Mali i Zi
Numri CRIS	2007/019-366
Viti	2007
Kosto	Shqipëria: 853,000 € Mali i Zi: 600,000 € Vlera totale e kontributit IPA: 1,453,000 €
Strukturat Operuese	Në Shqipëri: Njësia e Bashkëpunimit Rajonal në Drejtorinë e Mbështetjes Institucionale dhe Procesit të Integritetit – Ministria e Integritetit Europian–institucioni përgjegjës për koordinimin e Instrumentit të Ndihmës së Paraaderimit (IPA 2007-2013) Në Mal të Zi: Sekretariati për Integritetin Europian – institucioni përgjegjës për koordinimin e Instrumentit të Ndihmës së Paraaderimit (IPA 2007-2013)
Autoritetet zbatuese	Për Shqipërinë: Komisioni Europian Për Malin e Zi: Komisioni Europian
Data përfundimtare për hyrjen në fuqi të Marrëveshjes së Financimit:	Maksimumi brenda datës 31 dhjetor 2008
Data përfundimtare për nënshkrimin e kontratave	2 vjet që nga data e përfundimit të Marrëveshjes së Financimit Nuk ka afat për projektet e auditimit dhe vlerësimit që mbulohen nga kjo Marrëveshje Financimi, duke iu referuar nenit 166(2) të Rregullores Financiare
Data përfundimtare për zbatimin e Marrëveshjes	Këto data vlejnë edhe për bashkëfinancimin kombëtar 2 vjet nga data përfundimtare e nënshkrimit të kontratave. Këto data vlejnë edhe për bashkëfinancimin kombëtar.
Kodi i Sektorit	15050, 16110, 25010, 33210, 41010
Zëri buxhetor përkatës	22.02.04.01
Task Menaxheri i Programimit	Për Shqipërinë: Drejtoria e Përgjithshme e Zgjerimit, Njësia C1 Për Malin e Zi: Drejtoria e Përgjithshme e Zgjerimit, Njësia C2
Task Menaxheri i Implementimit	Seksionet Operacionale të Delegacioneve të KE-së në Shqipëri dhe Mal të Zi

2. Përmbledhje

2.1 Hyrje

31 Lidhja me MIPD

Programi ndërkufitar midis Shqipërisë dhe Malit të Zi do të kontribuojë në implementimin e Komponentit II të instrumentit IPA "Bashkëpunimi ndërkufitar" të Dokumenteve Tregues Shumëvjeçare të Planifikimit (MIPDs) 2007-2009 për të dy vendet. Ky program do të sigurojë asistencë për "Stabilizimin demokratik dhe ngritjen e kapaciteteve administrative", "Zhvillimin ekonomik dhe social", "Infrastrukturën" dhe "Asistencën teknike", të identifikuar si fusha kryesore të

ndërhyrjes në MIPD për Shqipërinë, dhe do të adresojë nevojën për "zhvillimin e aktiviteteve ndërkufitare në fushën ekonomike, sociale dhe mjedisore të zonave kufitare", për të "Adresuar sfidat e përbashkëta, në veçanti në fushat e mjedisit dhe shëndetit publik dhe zhvillimi" si dhe për të "Promovuar aktivitetet lokale "njerëzit për njerëzit", duke përfshirë OJQ-të dhe autoritetet lokale", të identifikuar në MIPD-në për Malin e Zi.

Fushat e ndërhyrjes së IPA 2007 janë përzgjedhur pas një analize të Komisionit Europian dhe konsultimeve me autoritetet e të dy vendeve, në bazë të analizës SWOT (Pikat e Forta, Pikat e Dobëta, Mundësitë, Kërcënimet) që ndodhet në aneksin 2 të këtij Vendimi Financimi, dhe pas marrjes në konsideratë të kapaciteteve implementuese.

32. Procesi i Programimit

Programimi u krye nga janari deri në maj 2007. Programi u hartua nëpërmjet një procesi të gjerë konsultimesh me aktorët lokalë dhe përfituesit potenciale në të dy anët e kufirit. Autoritetet kombëtare dhe strukturat e përbashkëta u asistuan gjatë këtij procesi nga projekti Ngritja e Kapaciteteve të Institucioneve Ndërkufitare (CBIB), financuar nga Programi Rajonal CARDS 2003. Ai u koordinua në secilin vend nga koordinatoret përkatës ndërkufitare: Ministria e Integritimit Europian në Shqipëri dhe Sekretariati për Integritimin Europian në Mal të Zi.

Në janar 2007, secili vend ngriti një Strukturë Operuese (SO) të ngarkuar me përgatitjen e programeve ndërkufitare. Komiteti i Përbashkët i Programimit, i cili përbëhej nga anëtarë të SO, u ngrit gjithashtu në janar 2007.

Strukturat Operuese u takuan për herë të parë më 14 shkurt 2007, me qëllim identifikimin e institucioneve përgjegjëse për përgatitjen e programit ndërkufitar dhe zhvillimin e një plani veprimi paraprak.

Komiteti i Përbashkët i Programimit u takua më 26 Shkurt 2007 dhe ra dakord mbi zonat përfituese dhe planin e veprimit.

Gjatë muajit mars dhe prill 2007, aktorët kryesorë lokalë u konsultuan dhe Strukturat Operuese u takuan disa herë për të diskutuar analizën e rajonit ndërkufitar dhe SWOT dhe për të identifikuar prioritetet dhe masat.

Komiteti i Përbashkët i Programimit u mbledh më 17 Prill 2007 për të rënë dakord mbi rajonin ndërkufitar dhe analizën SWOT, si dhe për të diskutuar prioritetet dhe masat. Komiteti u mbledh sërish më 23 maj 2007 për të miratuar draftin e programit ndërkufitar.

33. Lista e zonave përfituese

- Plani Strategjik i Veprimit për Liqenin e Shkodrës/Skadar i marsit 2007, midis Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit të Malit të Zi dhe Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave të Shqipërisë.

Ky program është gjithashtu në harmoni me strategjitë sektoriale të të dy vendeve: për Shqipërinë, Strategjia Kombëtare për Zhvillimin Social dhe Ekonomik (NSSD), Strategjia e Decentralizimit, Strategjia e Zhvillimit Rajonal– Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit (MDGs) 2003 për rajonin e Shkodrës dhe dokumenti Promovimi i Zhvillimit Lokal nëpërmjet MDGs 2003 për Rajonin e Kukësit; për Malin e Zi, Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Malit të Zi (NSSD), Masterplani për Zhvillimin e Turizmit, Plani Hapësinor, Plani Hapësinor i Zonës Bregdetare.

Për më tepër, programi ndërkufitar në aneksin 2 të këtij Vendimi Financimi, i cili është hartuar bashkërisht nga autoritetet e Shqipërisë dhe Malit të Zi gjatë gjysmës së parë të vitit 2007, pas një procesi të gjerë konsultimesh me aktoret në të dyja anët e kufirit, përbën bazën për planifikimin dhe zbatimin shumëvjeçar.

Mësimet e nxjerra

Pjesa më e madhe e iniciativave ndërkufitare ka filluar vetëm kohët e fundit, duke e bërë të parakohshëm përkufizimin e 'mësimeve të nxjerra'. Megjithatë, pikat e mëposhtme mund të theksohen nga përvoja ndërkufitare e vendeve të Ballkanit Perëndimor:

- Projektet që fokusohen në mbrojtjen e mjedisit reflektojnë prioritetet e përcaktuara nga institucionet kombëtare dhe rajonale, duke parashikuar një ndërfutje të qëndrueshme në prioritetet lokale dhe kombëtare të zhvillimit. Megjithatë, është e rëndësishme të krijohen lidhje të ngushta midis shoqërisë civile dhe sektorit privat në zhvillimin e programit.

- Thirrjet për propozime në shumën të vogla për aktivitetet ndërkufitare të ndërmarra në programet e mëparshme ndërkufitare kanë treguar kapacitetet të ultë për përgatitjen e projekteve nga pjesa më e madhe e përfituesve përfundimtarë. Kjo mund të pengojë zbatimin e programit. Trajnimi

specifik i aplikanteve potenciale do të jetë thelbësor gjatë gjithë programit.

- Disa bashki kanë pasur rol udhëheqës në iniciativat e kaluara dhe të tashme ndërkufitare. Këto bashki duhet të kenë një rol kryesor në zbatimin e programit (transferimi i ekspertizës etj.).

Për më tepër, një vlerësim i pavarur i programeve të bashkëpunimit ndërkufitar financiar nga programi PHARE u krye nga konsorciumi MWH. Përvoja ka treguar se parakushtet për një implementim sa më efektiv përfshijnë, përveç bashkëpunimit të ngushtë midis vendeve pjesëmarrëse në nivelet politike dhe operacionale:

- bashkëpunimin ndërkufitar midis ministrive të linjës dhe marrëdhënie efektive pune midis organizatave të lidhura me to;

- autoritetet funksionale lokale dhe të zhvillimit rajonal, të pajisura me stafin e duhur në një mjedis të qëndrueshëm;

- marrëdhënie të ngushta pune midis institucioneve dhe delegacioneve përkatëse të Komisionit;

- bashkëpunimin ndërkufitar funksional midis organizatave përkatëse të sektorit privat, si p.sh. dhomat e tregtisë, shoqatat dhe OJQ-të.

Koordinimi i Donatorëve

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë është i përfshirë në procesin e koordinimit të donatorëve nëpërmjet Sistemit të Planifikimit të Integruar (IPS), një mekanizëm që ka për qëllim të reformojë mënyrën sesi menaxhohen fondet publike (të brendshme dhe të huaja). IPS u miratua nga Këshilli i Ministrave në nëntor 2005 dhe duhet të përdorë një kuadër strategjik koherent, duke siguruar që politikat thelbësore të Shqipërisë dhe proceset financiare të funksionojnë në mënyrë koherente, efçente dhe të integruar. Nën programin CARDS 2004, fondit të mirëbesimit të Bankës Botërore për zbatimin e IPS iu sigurua një kontribut i Komisionit Evropian.

Këshilli i Ministrave pret gjithashtu të përmirësojë procesin e konsultimit me komunitetin e donatorëve dhe të harmonizojë ndihmën ndërkombëtare me prioritetet kombëtare nëpërmjet Departamentit të Koordinimit të Strategjive dhe Donatorëve, në Këshillin e Ministrave. Ministri i Integritimit Evropian është emëruar Koordinator i Kombëtar IPA.

Delegacioni i Komisionit Evropian, në rolin e tij si kryetar i Sekretariatit Teknik të Donatorëve, ka lehtësuar koordinimin e mbledhjes së të dhënave për të gjithë donatorët që nga vitit 2003. Roli i koordinimit të donatorëve është në procesin e të kaluarit gradualisht ndaj autoriteteve. Marrëdhënie të ngushta pune mbahen me institucionet financiare ndërkombëtare (EIB, EBRD, Banka Botërore, KfW).

Në Mal të Zi, koordinimi i donatorëve mbështetet kryesisht nga strategjitë sektoriale si dhe strategjitë ndërsektoriale mbi reduktimin e varfërisë, zhvillimin e qëndrueshëm etj. Autoritetet malazeze kanë riorganizuar koordinimin e donatorëve dhe kanë emëruar zyrtarë të lartë të qeverisë për të koordinuar ndihmën e donatorëve në të gjithë sektorët kritike. Agjencia Evropiane e Rindërtimit (EAR) në Podgoricë merr pjesë në mënyrë të rregullt në takimet e koordinimit me BE-në dhe donatorë të tjerë bilaterale. Ajo ka zhvilluar gjithashtu një marrëdhënie të ngushtë dhe të frytshme me institucionet financiare ndërkombëtare – veçanërisht EIB, EBRD dhe Bankën Botërore; dhe me institucionet financiare bilaterale si KfW gjermane.

Aktivitetet e financuara nga BE-ja, të menaxhuara nga EAR dhe në të ardhmen nga Delegacioni i KE-së, kanë kanalizuar investime thelbësore nga këto institucione në fushat e mjedisit dhe infrastrukturës së transportit të Malit të Zi. BE-ja ka zhvilluar gjithashtu marrëdhënie të mira pune me agjencitë e OKB-së, në veçanti me UNHCR për çështjet e refugjatëve dhe personave të zhvendosur brenda vendit, dhe me UNICEF për çështjet e mbrojtjes së fëmijëve. Ajo është duke punuar gjithashtu ngushtë me Këshillin e Evropës mbi reformën në administratën publike, dhe me OSBE-në në çështjet e drejtësisë, demokracisë dhe sigurisë.

Përsa i përket këtij programi ndërkufitar, vendet anëtare të BE-së dhe institucionet financiare ndërkombëtare janë konsultuar për draftin e programit gjatë procesit të programimit, me qëllim identifikimin e plotësueshmërive midis projekteve të ndihmës së donatorëve.

Zonat përfituese në Shqipëri janë dy rajone ekuivalente me nivelin NUTS III: rajoni i Shkodrës dhe rajoni i Kukësit.

Mali i Zi është i ndarë në 21 bashki të cilat janë njësitë bazë të vetëqeverisjes. Territori përfitues i Malit të Zi mbulon një territor prej 9 bashkish: Budva; Berane; Andrijeviça; Plav;

Danilovgrad; Podgorica; Bar; Ulcinj; Cetinje.

34. Zona të afërta (në përputhje me nenin 97 të Rregullores Zbatuese IPA)

Në Mal të Zi ka një zonë të afërt: bashkia Rozaje.

	Sip km ²	Popullsia
Rajoni ndërkufitar i Shqipërisë	5,936	337,247
Rajoni ndërkufitar i Malit të Zi (totali i zonave përfituese dhe të afërt)	5,745	357,654
Rajoni ndërkufitar në total	11,681	694,901

Territori i zonave përfituese është pothuajse i njëjtë në secilin vend dhe popullsia është gjithashtu e balancuar.

2.2 Objektivi (Global) i programit

Objektivi global i këtij programi është të nxisë bashkëpunimin midis njerëzve, komuniteteve dhe institucioneve në zonat kufitare, me qëllim zhvillimin e qëndrueshëm, stabilitetin dhe prosperitetin e këtyre zonave me interes reciprok për qytetaret e të dy vendeve. Ky program do të ketë efekte katalizuese meqë ka si synim të ndërtojë kapacitetet e aktorëve lokale, bashkive, institucioneve rajonale dhe shoqërisë civile, dhe si rrjedhim aftësinë e tyre për të marre pjesë në iniciativa ndërkufitare.

2.3 Akset prioritare, masat respektive dhe aspektet e tyre specifike në lidhje me implementimin e buxhetit të vitit 2007.

Aksi Prioritar I: Promovimi i kohezionit rajonal dhe konkurrueshmërisë nëpërmjet një përjasjeje që integron zhvillimin ekonomik, mjedisor dhe social.

Ky prioritet do të kontribuojë në cilësinë e standardeve të jetesës në zonën e programimit duke ofruar mundësi për partneritete ekonomike dhe shkëmbim të interesave të përbashkëta përgjatë kufirit. Masat që duhet të zbatohen pritet të rrisin cilësinë e shërbimeve, të gjenerojnë mundësi punësimi dhe sipërmarrjeje, të përmirësojnë mbrojtjen e mjedisit dhe të nxisin shkëmbimet kulturore. Ato do të lehtësojnë gjithashtu forcimin e komuniteteve lokale dhe organizatat e shoqërisë civile dhe do të promovojnë kohezionin social.

Ky prioritet konsiston në tre masa specifike.

Masa I.1: Zhvillimi ekonomik me fokus te turizmi

Objektivi specifik i kësaj mase është të nxisë zhvillimin ekonomik të zonës së programimit, bazuar në potencialet e tyre turistike dhe kulturore. Rezultatet e pritshme janë menaxhimi i përbashkët i aktiviteteve turistike dhe rritja e cilësisë së shërbimeve, konkurrueshmërisë dhe atraktivitetit të sektorit të turizmit.

Kjo mase do të nxisë iniciativa për të modernizuar shërbimet turistike duke zhvilluar shërbime të përbashkëta këshilluese për biznesin dhe duke stimuluar ndërveprimin e rregullt midis bizneseve të vendosura përgjatë rajonit ndërkufitar, nëpërmjet: rrjeteve bizneset-për-bizneset; marketingut të përbashkët në tregjet e brendshme dhe atë të BE-së; bashkëpunimit të organizatave të edukimit për shërbimet e novacionit dhe formimit profesional; investimeve të përzgjedhura në infrastrukturën e biznesit; promovimit të imazhit të zonës ndaj investuesve dhe vizitoreve potenciale.

Masa I.2: Mbrojtja dhe promovimi i mjedisit

Objektivi specifik i kësaj mase është të mbështesë iniciativat e përbashkëta me qëllim mbrojtjen, promovimin dhe menaxhimin e ekosistemeve sensitive dhe zhvillimin e qëndrueshëm mjedisor të zonës së programimit. Rezultatet që priten janë menaxhimi i përbashkët i zonave të mbrojtura dhe rritja e ndërgjegjësimit të popullsisë rreth çështjeve të mjedisit.

Kjo masë do të mbështesë bashkëpunimin midis organizatave të mbrojtjes së mjedisit, aktive në zonën e programimit për të përgatitur dhe zbatuar plane menaxhimi për zonat e ekoturizmit, me fokus kryesor në Liqenin e Shkodrës/Skadar dhe rrethinat e tij.

Masa I.3: Rritja e kohezionit social nëpërmjet aktiviteteve njerëzit për njerëzit

Objektivi specifik i kësaj mase është të inkurajojë qytetarët e zonës së programimit të përfshihen në një serë mundësish për bashkëpunim dhe ngritje partneritetesh dhe do të rezultojë në ngritjen e rrjeteve të reja dhe shkëmbime midis aktorëve lokalë.

Aktivitetet njerëzit për njerëzit pritet të rrisin në mënyrë direkte rrjedhën e informacionit dhe komunikimit përgjatë zonës kufitare. Aktivitetet e parashikuara nën këtë masë do t'i afrojnë njerëzit, komunitetet lokale dhe shoqërinë civile të zonës kufitare me njëri-tjetrin, p.sh. mbështetje për

shkëmbimet kulturore, promovimi i punimeve artizanale, prodhimeve tradicionale dhe trashëgimisë lokale.

Aktivitetet njerëzit për njerëzit do të financohen edhe nga masat I.1 dhe I.2. Do të sigurohet harmonizimi midis këtyre tre masave.

Aksi Prioritar II: Asistencë teknike për një menaxhim eficient të programit dhe rrjedhës së informacionit

Asistenca Teknike do të sigurohet nëpërmjet dy masave.

Masa II.1: Administrimi, monitorimi dhe vlerësimi i programit

Asistenca Teknike do të përdoret për të mbështetur punën e dy Strukturave Operuese (SO) kombëtare dhe Komitetin e Përbashkët të Monitorimit (JMC), duke siguruar një implementim, monitorim dhe vlerësim eficient të programit, si dhe një përdorim optimal të burimeve. Kjo do të arrihet nëpërmjet ngritjes dhe veprimtarisë së Sekretariatit të Përbashkët Teknik (SPT) në Shqipëri dhe antenës SPT në Mal të Zi. SPT do të kryejë menaxhimin e përditshëm të programit dhe do të përgjigjet para Strukturave Operuese dhe Komitetit të Përbashkët të Monitorimit

Masa II.2: Informimi dhe publiciteti mbi programin

Objektivi specifik i kësaj mase është të sigurojë ndërgjegjësim mbi programin në radhët e komuniteteve kombëtare, rajonale dhe lokale dhe në përgjithësi mes popullsisë në zonën e programimit. Ai gjithashtu mbështet aktivitete ndërgjegjësimi në nivel vendi, me qëllim që të informojë qytetarët e të dy vendeve rreth programit.

Itinerari tregues dhe shumat për zbatimin e masave

Masat I.1, I.2 dhe I.3 do të zbatohen nëpërmjet skemave të granteve. Kriteret e detajuara të përzgjedhjes dhe dhënies së granteve do të përcaktohen në paketën e aplikimit të thirrjes për propozime (Udhëzime për aplikuesit). Është parashikuar që thirrjet për propozime, për shumën totale IPA dhe bashkëfinancimi kombëtar prej rreth 1.5 milionë €, do të ndërmerret në tremujorin e katërt të vitit 2008.

Masat II.1 dhe II.2 konsistojnë në asistencën teknike dhe do të zbatohen nëpërmjet marrëveshjeve individuale të granteve të drejtpërdrejta pa thirrje për propozime midis Komisionit Europian dhe autoriteteve kombëtare përkatëse, në përputhje me nenin 168 1. (c) të Rregullave të Zbatimit të Rregullores Financiare, duke pasur parasysh se autoritetet kombëtare përkatëse, d.m.th. koordinatori CBC sipas kuptimit të nenit 22 (2) (b) të Rregullores së Zbatimit IPA dhe strukturat operuese, gëzojnë de facto një situatë monopoli për zbatimin e programit ndërkufitar. Nënkontraktimi i aktiviteteve të mbuluara nga marrëveshja e drejtpërdrejtë e grantit është i mundur. Marrëveshjet e drejtpërdrejta të granteve, në shumën totale prej 145,300 €, mund të nënshkruhen menjëherë pasi Marrëveshjet e Financimit të kenë hyre në fuqi. Shumat e alokuara IPA për masat II.1 dhe II.2 do të plotësohen nga një shumë totale prej 25,641 € të bashkëfinancimit kombëtar që do të sigurohet nga autoritetet e të dy vendeve.

Thirrjet për propozime do të përgatiten me ndihmën e asistencës teknike të parashikuar në aksin prioritar II të këtij programi. Në veçanti, asistenca teknike do të financojë funksionimin e Sekretariatit të Përbashkët Teknik i cili do të hartojë Udhëzimet e thirrjeve për propozime për Aplikuesit, nën mbikëqyrjen e Komitetit të Përbashkët të Monitorimit.

Një shqetësim potencial mund të jetë mungesa e kapaciteteve thithëse për gjenerimin e projekteve nga ana e aktorëve lokalë. Ky shqetësim do të adresohet me anë të aktiviteteve nën aksin e asistencës teknike, me qëllim shpjegimin e programit përfituesve potencialë.

Aktivitetet e parashikuara nën këtë program janë projektuar mbi bazën e analizës SWOT (Pikat e Forta, Dobësitë, Mundësitë dhe Kërcënimet) në aneksin 2 të këtij vendimi Financimi dhe gjithashtu duke mbajtur parasysh shumat financiare të kufizuara. Bashkëfinancimi garanton që do të respektohet parimi i plotësimit i BE-së.

2.4 Vështrim i përgjithshëm mbi përvojën e kaluar dhe në vazhdim në fushën e bashkëpunimit ndërkufitar, duke përfshirë mësimet e nxjerra dhe koordinimin e donatorëve.

Bashkëpunimi midis Shqipërisë dhe Malit të Zi është relativisht i vonshëm. Ai është zhvilluar me tepër në nivel të institucioneve qendrore sesa në rajonet kufitare. Bashkëpunimi midis dy vendeve

është mbështetur në protokollet dhe marrëveshjet ekzistuese si më poshtë:

- Marrëveshje e tregtisë së lirë midis dy vendeve.
- Protokoll i Bashkëpunimit i nënshkruar në dhjetor 2000 ndërmjet Ministrisë së Turizmit të Malit të Zi dhe Komitetit Shqiptar për Zhvillimin e Turizmit.
- Forumi Rajonal i bashkëpunimit midis Shkodrës dhe Malit të Zi. Përfaqësues të qeverisë lokale dhe sektori privat marrin pjesë në këtë forum.
- Marrëveshja e Lundrimit e nëntorit 2004, sipas të cilës palët bien dakord me funksionimin e një linje ndërkombëtare lundrimi Shkodër-Virpazar.

2.5 Çështje horizontale

Aplikimi i përbashkët do të duhet të mbulojë të dy palët në projekt dhe të përmbushë kriteret e mëposhtme:

- partnere përfitues nga të dyja anët e kufirit
- mbështesë lidhjet midis institucioneve dhe organizatave relevante nga të dyja anët e kufirit
- nxisë pjesëmarrje të barabartë të grave dhe të grupeve të marginalizuara
- plotësojë nevojat e veçanta të minoriteteve etnike
- të jetë i qëndrueshëm nga ana mjedisore

Partnerët në projekte duhet të ndërtojnë mekanizma koordinimi të rëna dakord për të sinkronizuar projektet e përbashkëta gjatë gjithë implementimit të tyre.

2.6 Kushtet

- Riorganizimi i strukturave operuese në çdo vend: OSs ekzistuese u ngritën me qëllim përgatitjen e programit ndërkufitar. Implementimi i programit mund të kërkojë një tjetër lloj strukturë.
- Ngritja e Komitetit të Përbashkët të Monitorimit.
- Ngritja dhe organizimi i Sekretariatit të Përbashkët Teknik (SPT) në Shqipëri dhe antenës në Mal të Zi.

- Emërimi i stafit të duhur për të marrë pjesë në aktivitetet trajnuese, ditët e informimit dhe aktivitetet monitoruese.

2.7 Parametrat

Këto parametra janë të një natyre treguese, në përputhje me seksionin 2.3.

	N* (2008)	N+1 (2009) (kumulative)	N+2 (2010) (kumulative)
Numri i granteve direkte në Shqipëri	1		
Numri i granteve direkte në Mal të Zi	1		
Numri i thirrjeve të përbashkëta për propozime ndërmarrë në Shqipëri dhe Mal të Zi	3		
Norma e Kontraktimit në Shqipëri (%)	10	100	
Norma e Kontraktimit në Mal të Zi (%)	10	100	

* n është data e përfundimit të Marrëveshjes së Financimit

2.8 Hapat për decentralizimin e menaxhimit të fondeve të BE-së pa kontrollet *ex ante* nga Komisioni

Në përputhje me nenin 8(4)c) të Rregullores së Implementimit IPA, vendet përfituese duhet të hartojnë një plan me etapa indikative dhe afate kohore për të arritur decentralizimin pa kontrolle *ex ante* nga Komisioni.

Në rastin e Shqipërisë, një mision këshillues nga njësia e auditit E.5 të Drejtorisë së Përgjithshme të Zgjerimit të KE u zhvillua në prill 2007. Gjatë këtij misioni, autoriteteve shqiptare iu paraqit drafti i dokumentit “Hapat për DIS”. Këto autoritete janë duke punuar mbi planifikimin e

këtyre hapave. Projekti 2 I financuar nga Komponenti I i programit IPA për Shqipërinë për vitin 2007, do të sigurojë një vlerësim të hollësishëm të strukturave administrative ekzistuese në Ministrinë e Financave dhe ministrinë kryesore të linjës që përfitojnë nga ndihma e BE-së dhe përgatitjen e tyre për të marrë përsipër përgjegjësitë e DIS.

Në Malin e Zi, puna për dhënien e decentralizimit pa kontrollet *ex-ante* është në një fazë fillestare. Një plan i detajuar specifik dhe itinerari për decentralizimin me kontrollet *ex-ante* duhet të përgatitet nga vendi përfitues, në përputhje me guidën e Komisionit "Plani për Sistemin e Decentralizuar të Implementimit, DIS". Për momentin, jo nën asistencën multilaterale të aktorëve të tjerë ndryshe nga BE-ja, një listë kontrolli është përgatitur mbi kualifikimet dhe rezultatet e pritshme në përgatitjen dhe implementimin e DIS, e cila do të shërbejë si tregues për të gjithë trajnimet e ardhshme të organeve të administratës publike të përcaktuara për t'u marrë me IPA-n. Një mision SIGMA u zhvillua në qershor 2007 për të bërë vlerësimin e mangësive për zbatimin DIS. Pas atij misioni, autoritetet kombëtare priten të marrin vendime mbi organizimin dhe vendndodhjen e organeve publike relevante.

3. Buxheti për vitin 2007

3.1 Tabela treguese financiare e vitit 2007 për Shqipërinë

	Asistenca BE-IPA		Kontributi Kombëtar		Totali (IPA plus Kontributi Kombëtar)
	EURO	%	EURO	(%)	EURO
Aksi prioritar I	767,700	85	135,476	15	903,176
Aksi prioritar II	85,300	85	15,053	15	100,353
TOTALI	853,000	85	150,529	15	1,003,529
					100

3.2 Tabela indikative financiare e vitit 2007 për Malin e Zi

	Asistenca BE- IPA		Kontributi Kombëtar		Totali (IPA plus Kontributi Kombëtar)
	EURO	%	EURO	(%)	EURO
Aksi prioritar I	540,000	85	95,294	15	635,294
Aksi prioritar II	60,000	85	10,588	15	70,588
TOTALI	600,000	85	105,882	15	705,882
					100

3.3 Parimi i bashkëfinancimit të projekteve të financuara nga programi

Kontributi i Komunitetit është llogaritur në raport me shpenzimet e lejuara që për programin ndërkufitar midis Shqipërisë dhe Malit të Zi është bazuar në shpenzimet totale, siç është rënë dakord nga vendet pjesëmarrëse dhe parashikuar në programin ndërkufitar.

Zbatohen dispozitat e nenit 90 të Rregullores (EC) Nr. 718/2007 të datës 12 qershor 2007 (Rregullorja e Implementimit IPA)¹. Norma e kontributit të Komunitetit për këtë program është 85%. Bashkëfinancimi nën aksin prioritar do të sigurohet nga përfituesit përfundimtarë të grantit dhe mund të jetë nga fonde publike dhe private. Përfituesit përfundimtarë të grantit duhet të kontribuojnë me një minimum prej 15% të kostos totale të lejueshme të projektit, si për projekte investimesh ashtu edhe për ngritjen e institucioneve. Bashkëfinancimi nën aksin prioritar II do të sigurohet nga autoritetet kombëtare.

¹ FZ L 170 29.6.2007, fq 1.

4. Masat e Implementimit

Masat e Implementimit për të dy vendet do të bazohen në menaxhimin e centralizuar të ndihmës së KE-së.

4.1 Metoda e Implementimit

Ky program do të implementohet në mënyrë të centralizuar nga Komisioni Evropian në përputhje me Nenin 53a të Rregullores Financiare² dhe dispozitave korresponduese të Rregullave të Implementimit³.

Roli i Komisionit në përzgjedhjen e projekteve në kuadër të këtij programi ndërkufitar midis vendeve përfituese specifikohet në Nenin 140 tek Rregullorja e Implementimit IPA.

4.2 Rregullat e përgjithshme për procedurat e prokurimit dhe dhënies së grantit

Prokurimi duhet të zbatohet sipas dispozitave të Pjesës II, Titulli IV të Rregullores Financiare dhe Pjesës II, Titulli III, Kapitulli 3 i Rregullave të Implementimit⁴, si dhe rregullat dhe procedurat për kontratat e shërbimeve, pajisjet dhe punimet të financuara nga buxheti i përgjithshëm i Komuniteteve Europiane për qëllime bashkëpunimi me vendet e treta, miratuar nga Komisioni në datë 24 Maj 2007 (C(2007)203⁴).

Procedurat e dhënies së grantit duhet të ndjekin dispozitat e Pjesës I, Titulli VI të Rregullores Financiare dhe Pjesës I, Titulli VI të Rregullave të tij të Implementimit.

Sipas rastit, Autoriteti Kontraktues do të përdorë gjithashtu formatin standard dhe modelet që lehtësojnë aplikimin e rregullave të mësipërme të cilat ndodhen në "Guidën Praktike të procedurave të kontraktimit për veprimet e huaja të KE-së" (Guida Praktike), publikuar në faqen e internetit të EuropeAid⁵ në datën e fillimit të procedurave të prokurimit ose dhënies së granteve.

4.3 Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor (EIA) dhe Mbrojtja e Natyrës (sipas rastit)

Të gjitha investimet duhet të bëhen në përputhje me legjislacionin Komunitar mjedisor.

Procedurat për vlerësimin e ndikimit mjedisor parashikuar në direktivën⁶ EIA aplikohen plotësisht në të gjitha projektet e investimeve nën instrumentin IPA. Nëse direktiva EIA nuk është transpozuar plotësisht, procedurat duhet të jenë të ngjashme me ato të vendosura në këtë direktivë.

Nëse një projekt ka të ngjarë të ketë ndikim në vendet me rëndësi për mbrojtjen e natyrës, një vlerësim i saktë i mbrojtjes së natyrës duhet të bëhet, ekuivalent me atë të nenit 6 të Direktivës së Habitatit, dhe duhet të dokumentohet⁷.

5. Monitorimi dhe vlerësimi

5.1 Monitorimi

Implementimi i programit ndërkufitar do të monitorohet nga komiteti i përbashkët i monitorimit sipas nenit 142 të Rregullores së Implementimit IPA, ngritur nga vendet përfituese pjesëmarrëse, i cili përfshin edhe përfaqësues të Komisionit.

Në Shqipëri, Komisioni mund të ndërmarrë çdo veprim që ai e konsideron si të nevojshëm për të monitoruar programin në fjalë.

5.2 Vlerësimi

Programi do të jetë subjekt i vlerësimeve në përputhje me nenin 141 të rregullores së

2 Rregullorja 1605/2002 (FZ L 248, 16.9.2002, fq.1.) amenduar nga rregullorja (EC, Euratom) nr.1995/2006 (FZ L 390, 30.12.2006, fq.1).

3 Rregullorja 2342/2002 (FZ L 357, 31.12.2002, fq. 1) amenduar nga rregullorja (EC, Euratom) nr.478/2007 (FZ L 111, 28.4.2007, fq. 1).

4 Shih shënimet 2 dhe 3 më lart

5 Adresa: http://ec.europa.eu/europeaid/work/procedures/implementation/practical_guide/index_en.htm

6 Direktiva e Këshillit 85/337/EEC e datës 27 qershor 1985 mbi vlerësimin e ndikimeve të disa projekteve publike dhe private mbi mjedisin (FZ L 175, 5.7.1985, fq.40. Direktive e amenduar se fundmi nga direktiva 2003/35/EC, FZ L 156, 25.6.2003, fq. 17.

7 Direktiva e Këshillit 92/43/EEC e datës 21 maj 1992 mbi ruajtjen e habitateve natyrore dhe faunes dhe florës së egër (OJ L206, 22.7.1992). Direktive e amenduar se fundmi nga Rregullorja (EC) nr.1882/2003 (FZ L284, 31.10.2003, fq. 1).

Implementimit IPA, me qëllim për të përmirësuar cilësinë, efektivitetin dhe qëndrueshmërinë e ndihmës së Komunitetit, strategjinë dhe implementimin e programit ndërkufitar.

6. Auditimi, kontrolli financiar dhe masat kundër mashtrimit

Llogaritë dhe aktivitetet e të gjitha palëve të përfshira në implementimin e këtij programi, si dhe të gjitha kontratat dhe marrëveshjet që implementojnë këtë program, nga njëra anë janë subjekt i mbikëqyrjes dhe kontrollit financiar të Komisionit (duke përfshirë edhe zyrën europiane kundër mashtrimit), të cilat mund të zhvillojnë kontrolle, kur e gjykon të arsyeshme, ose vete ose nëpërmjet një auditori të jashtëm, nga ana tjetër, auditive nga Gjykata Europiane e Revizorëve. Kjo përfshin masa të tilla si p.sh. verifikimin *ex-ante* të tenderimit dhe kontraktimit të zhvilluara nga Delegacionet e vendeve përfituese

Me qëllim sigurimin e një mbrojtjeje efikase të interesave financiare të Komunitetit, Komisioni (duke përfshirë dhe Zyrën Europiane Kundër Mashtrimit) mund të zhvillojnë kontrolle në vend dhe inspektive në përputhje me procedurat e parashikuara në rregulloren e Këshillit (EC, Euratom) 2185/96⁸.

Kontrollet dhe auditimet e përshkruara më lart aplikohen për të gjithë kontraktorët, nënkontraktorët dhe përfituesit e grantit që kanë përfituar fonde nga Komuniteti.

7. Ndryshimet e kufizuara

Ndryshime të kufizuara në implementimin e këtij programi që kanë ndikim mbi elementet thelbësore të renditur në Nenin 90 të Rregullave të Implementimit të Rregullores Financiare, e cila është e një natyre treguese⁹, mund të ndërmerren nga zyrtari autorizues i Komisionit me anë të delegimit (AOD), ose nga zyrtari autorizues i Komisionit me anë të nën-delegimit (AOSD), në përputhje me kompetencën e deleguar nga ana e AOD, në përputhje me parimet e menaxhimit të mirë financiar, pa qenë i nevojshëm një vendim ndryshimi financiar.

AKRONIME

AK	Autoriteti Kontraktues
BE	Bashkimi Europian
BNK	Bashkëpunimi Ndërkufitar
CEFTA	Marrëveshja e Tregtisë së Lire për Evropën Qendrore
CBIB	Ndërtimi i Institucioneve Ndërkufitare
FAQ	Pyetjet me të Shpeshta
IPA	Instrumenti i Ndihmës së Para-aderimit
KPM	Komiteti i Përbashkët i Monitorimit
SPT	Sekretariati i Përbashkët Teknik
MDG	Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit
MIPD	Dokumenti Indikativ i Planifikimit Shume-vjeçar
MSA	Marrëveshja e Stabilizim - Asociimit
NUTS	Nomenklatura e Njësive për Statistikat Territoriale
PPB	Produkti i Përgjithshëm Bruto
PNUD	Programi i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara
PRAG	Udhëzuesi Praktik për Procedurat e Kontraktimit të financuara nga buxheti i përgjithshëm i BE-së në kuadër të aksioneve të jashtme
PZHK	Plani i Zhvillimit Kombëtar
OJQ	Organizate Jo Qeveritare
SKSHES	Strategjia Kombëtare për Zhvillimin Ekonomik dhe Social
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillimin dhe Integrimin
OSBE	Organizata për Sigurimin dhe Bashkëpunimin në Evropë
SKBZHR	Strategjia Kombëtare e Bujqësisë dhe e Zhvillimit Rural
SME	Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme
SO	Struktura Operative

⁸ Rregullorja e Këshillit (EC, Euratom) 2185/96 e datës 11 nëntor 1996, FZ L 292; 15.11.1996; fq. 2.

⁹ Këto elemente thelbësore janë të natyrës treguese, shuma treguese e thirrjes për propozime dhe për prokurimet, numri tregues, lloji i kontratave të parashikuara dhe itinerari tregues për ndërmarrjen e procedurave të prokurimit.

SWOT	Pikat e forta, Pikat e dobëta, Mundësitë, Rreziqet
TA	Asistenca Teknike
UNSCR	Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara
VET	Edukimi dhe Trajnimi Profesional

SEKSIONI I

PREZANTIMI DHE PROCESI I PROGRAMIMIT

1.1 Prezantimi

Programi Ndërkufitar ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Malit të Zi do të shërbejë si udhëzues strategjik për implementimin e asistencës nën Komponentin II – “Bashkëpunimi Nder-Kufitar” të Instrumenteve të Asistencës së Para – Aderimit (IPA). Ai është ideuar si vijim i parimeve të theksuara në rregullat për implementimin e IPA si dhe atyre që përcaktohen në draft rregulloren e IPA.

Objektivi i përgjithshëm i këtij programi është promovimi i bashkëpunimit ndërmjet njerëzve, komuniteteve dhe institucioneve të zonave kufitare, me synim arritjen e marrëdhënieve të mira të fqinjësisë, zhvillimit të qëndrueshëm, stabilitetit dhe prosperitetit në interes të përbashkët të të dy vendeve.

Programi është ndërtuar mbi bazën e partneriteteve ekzistuese dhe iniciativave të bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve dhe njërive të qeverisjes vendore në zonën kufitare. Edhe pse deri tani ekzistojnë disa arritje në drejtim të krijimit të partneriteteve lokale veçanërisht në fushat e tregtisë dhe mbrojtjes së ambientit, bashkëpunimi ndërmjet shoqërisë civile, komuniteteve të biznesit dhe institucioneve kulturore mbetet akoma në një nivel shumë modest. Motivimi i institucioneve lokale dhe njerëzve për t’i përdorur në mënyrë sa më efektive mundësitë e bashkëpunimit që ofron Komponenti II i IPA-s, do të përbëjë edhe sfidën kryesore për Shqipërinë dhe Malin e Zi gjatë implementimit të këtij programi.

Ky program Nder-Kufitar do të implementohet gjatë periudhës 2007-2013. Programi do të implementohet në të dy vendet sipas skemave ekzistuese të menaxhimit të centralizuar.

1.2 Procesi i programimit

Procesi i programimit u realizua në periudhën nga janari deri në Maj 2007. Programi u zhvillua duke ndjekur një proces të gjere konsultimesh me palët e interesuara vendase dhe përfituesit potenciale në të dyja anët e kufirit. Gjatë këtij procesi autoritetet kombëtare dhe strukturat e përbashkëta patën ndihmësen e Projektit "Ndërtimi i Institucioneve Ndërkufitare CBIB)10. Tabela e mëposhtme paraqet në mënyrë të përmblëdhur procesin e përgatitjes së këtij programi.

Periudha	Aktivitetet dhe qëllimi
Janar 2007	Ngritja e Strukturave Operative (SO) dhe komitetit të përbashkët të programimit
14 Shkurt 2007	Takimi i parë i Strukturave Operative, identifikimi i institucioneve përgjegjëse për përgatitjen e programit nderkufitar, përgatitja e një planin e veprimit paraprak.
26 Shkurt 2007	Takimi i Komitetit të Përbashkët të Programimit. Arritje e marrëveshjes në lidhje me zonat të cilat do mbulohen si dhe për planin e veprimit.
Mars 2007	Procesi i analizës SWOT dhe të situatës si dhe konsultime me palët kryesore të interesuara vendore.
Mars-prill 2007	Takime të ndryshme të strukturave operative, diskutime rreth situatës dhe analiza SWOT, identifikimi i prioritetëve dhe masave.
17 Prill 2007	Takimi i Komitetit të Përbashkët të Programimit. Marrëveshje rreth analizës së situatës dhe diskutime në lidhje me përparësitë dhe masat.
23 Maj 2007	Komiteti i Përbashkët i Programimit, takim për aprovimin e projektprogramit nderkufitar.

Përveç kësaj, Vendet Anëtare të BE dhe IFIs janë konsultuar rreth këtij draft programi gjatë procesit të programimit me qëllim identifikimin e mundësive për koordinim ndërmjet projekteve të asistencës së donatoreve.

2. Përshkrimi i Zonës së mbuluar nga programi

Programi Nderkufitar mbulon një territor prej 11.681 km². Gjatësia e vijës kufitare ndërmjet të dy vendeve është 210 km, nga të cilat 172 km janë kufij tokësor dhe 38 km janë kufij ujor të Detit Adriatik, Liqenit të Shkodrës dhe lumenjve malore.

Tabela 1: Zona e mbuluar nga Programi Nderkufitar


ZONAT QE MBULOHEN	
SHQIPERIA: Zone që mbulohet	
Territori = 5.936 km ²	
Popullsia = 337,247 banorë	
Rajoni i Shkodrës	
Rajoni i Kukësit	
MALI I ZI:	
1. Zone që mbulohet	
Territori = 5.745 km ²	
Popullsia = 357 654 banorë.	
Bashkia Budva	
Bashkia Berane	
Bashkia Andrijevica	
Bashkia Plav	
Bashkia Danilovgrad	
Bashkia Podgorice	
Bashkia Bar	
Bashkia Ulqin	
Bashkia Cetinje	
2. Zone e afërt	
Bashkia Rozaje	
Totali i zonës së mbuluar nga programi ndërkufitar	
Territori = 11.681 km ² .	
Popullsia = 694,971 banorë.	

Ne Shqipëri rajoni është ekuivalenti i nivelit NUTS III. Pjesa Shqiptare e zonës së programimit mbulon dy rajone me popullsi totale prej 337,247 banoresh¹¹ të cilët banojnë në 8 bashki dhe 52 komuna apo 468 qendra banimi (qytete apo fshatra)

Ne Malin e Zi klasifikimi sipas NUTS nuk është akoma i aplikueshëm. Mali i Zi ndahet në 21 bashki si njësi baze të vetë qeverisjes vendore¹². Pjesa e Malazeze e zonës së programimit mbulon një territor prej 10 bashki dhe 613 qendra banimi (qytete dhe fshatra) me një popullsi totale prej 357 654 banorë. Popullsia totale që banon në zonat që përfitojnë nga programi numëron 694,971 banorë.

Popullsia që banon në zonat që përfitojnë nga programi numëron 694,901 banorë.

Tabela 2: Krahësimi i territorit dhe popullsisë në zonat përfituese të programit



Figurat 1 dhe 3 tregojnë një situatë të ndryshme për sa i përket pjesës nga totali të cilën e zënë popullsia apo territori në secilën zonë përfituese brenda çdo vendi. Territori i bashkive përfituese në Malin e Zi përbën 42% të territorit të përgjithshëm të Malit të Zi si dhe 57.7% të popullsisë, ndërkohë që rajonet përfituese në Shqipëri përbejnë 21% të territorit të përgjithshëm të Shqipërisë si dhe 10.7% të popullsisë në Shqipëri. Popullsia e zonave përfituese në secilën anë të kufirit është e ndarë në mënyrë pothuajse të njëjtte, siç tregohet në figurën 4.

3. Situata aktuale dhe analizat e Zonës së Programimit

3.1 Historia

Mali i Zi ka qenë një mbretëri e pavarur qysh vonë nga Mesjeta e deri në vitin 1918. Pas luftës së parë botërore, Mali i Zi u bë pjesë e Federatës Jugosllave dhe mbeti pjesë e kësaj federate bashkë me Serbinë edhe pas kolapsit të Jugosllavisë në vitet 1991-92.

Statusi i pavarësisë së Malit të Zi u vendos me referendum për pavarësi më 21 Maj 2006 dhe menjëherë pas kësaj Parlamenti i Malit të Zi shpalli pavarësinë e vendit. Më 28 Qershor 2006, Mali i

¹¹ INSTAT të dhënat për popullsinë, 2005

¹² Mali i Zi ndahet në tre rajone gjeografike: veriore, qendrore dhe jugore të cilat nuk kanë autoritet menaxhues apo të decentralizuar.

Zi u be shteti i 192-te i Kombeve te Bashkuara.

Pas 50 vjetësh regjim totalitar komunist, ne vitin 1991 Shqipëria hyri ne rrugën e reformave demokratike. Duke e marre veten pas kolapsit financiar te vitit 1997, Shqipëria ka arritje shume te mira ne drejtim te treguesve te qëndrueshëm te rritjes ekonomike. Rritja mesatare vjetore është 7% për vitet 1997-2005, çka është nga me te lartat për ekonomitë e tranzicionit. Menaxhimi i suksesshëm makroekonomik i ka dhënë një kontribut te rëndësishëm kësaj rritjeje, çka ka përberë edhe një faktor kyç për uljen e nivelit te varfërisë¹³ ne vend dhe për zhvillimin e përgjithshëm ekonomik.

Te dyja vendet marrin pjese ne Procesin e Stabilizim Asociimit. Shqipëria e nënshkroi Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit me date 12 Qershor 2006.

3.2 Demografia

Popullsia e përgjithshme ne zonën e programimit numëron rreth 0.7 milion¹⁴ banore. Zonat kufitare kane shume karakteristika te përbashkëta por gjithashtu edhe diversitet ne lidhje me zhvillimet demografike. Zona e programimit ka një popullsi te shpërndarë si dhe një numër te kufizuar qytetesh te mëdha (mbi 50,000 banore) Zona karakterizohet nga tendenca te fuqishme migrimi ne dhjetëvjeçarin e fundit, i orientuar kryesisht drejt qendrave urbane me potenciale me te mëdha ekonomike.

Popullsia qe banon ne zonën përfituese Shqiptare shkon deri ne 0.34 milion apo 10.7 % te popullsisë se përgjithshme ne Shqipëri. Kjo zone ka nivel te ulet urbanizimi (veçanërisht rajoni i Kukësit). Qyteti i Shkodrës është qendra me e madhe urbane me rreth 83,000 banore. Lëvizjet e mëdha migratore qysh nga rënia e regjimit komunist kane ndikuar negativisht ne rritjen e popullsisë dhe strukturën e popullsisë ne këtë zone. Pavarësisht nga nivelet e larta te fertilitetit dhe rritjes natyrale pozitive, popullsia ne zonën kufitare Shqiptare është zvogëluar me rreth 1/3 për shkak te lëvizjeve migratore te brendshme dhe te jashtme te popullsisë.

Popullsia qe jeton ne zonën përfituese te Malit te Zi është rreth 0.35 milion çka përbën rreth 58% te popullsisë totale te Malit te Zi. Kjo zone ka nivel te larte urbanizimi dhe popullsia është e përqendruar kryesisht ne qendrat urbane te zhvilluara ekonomikisht (si Podgorica, Bar dhe Budva) Migracioni inter-rajonat ka ndikuar ne tendencat e rritjes se popullsisë. Ne zonat me te zhvilluara ekonomikisht vërehet një rritje pozitive e popullsisë gjë qe fsheh disi tendencën negative te rritjes natyrale. Ne zonat me pak te zhvilluara ndodh fenomeni i kundërt.

Tabela 2: Te dhënat për popullsinë

Zona e Programit Nder-kufitar	Popullsia aktuale	Ndryshimet e popullsisë (%)	Popullsia urbane (%)	Dendësia e popullsisë (banore për km ²)	Age dependency ratio (%)
	2005	2005/1991	2005	2005	2005
Shqipëria	337,247	-31 %	44%	57	22,5 %
Mali i Zi	357,724	+9,489 %	60.4%	60	55.25 %
Totali	694,971	-12 %	52.4%	59	53.4 %

Zona e programimit ka një dendësi te popullsisë relativisht te ulet, rreth 59 banore për km². Te dyja zonat përfituese kane te njëjtën mesatare te densitetit te popullsisë 57 banore për km². Ne pjesën malazeze, për arsye te përqendrimit te një numri qytetesh, densiteti i popullsisë i afrohet me shume mesatares kombëtare te Malit te Zi (68 banore për km²) Ne pjesën Shqiptare dendësia e popullsisë është dy here me i ulet se mesatarja kombëtare (109 banore për km²).

¹³ Banka Botërore, "Shqipëria: Ristrukturimi i Shpenzimeve Publike ne Mbështetje te Rritjes ekonomike – Rishikimi Institucional dhe i Shpenzimeve Publike, dhjetor 2006 , Volumi I, f.2.

¹⁴ Popullsia për palën Shqiptare ne vitin 2005 dhe popullsia për palën malazeze ne vitin 2003.

3.3 Pakicat etnike

Ne zonën e programimit jetojnë grupe të ndryshme etnike, veçanërisht në palën Malazeze. Heterogjeniteti i popullsisë rezultojnë në një varietet normash kulturore dhe sociale në vendndodhje të ndryshme. Në pjesën malazeze, përveç shumicës malazeze, pakica të tjera etnike janë Serbet, Shqiptaret dhe Boshnjaket. Grupi më i madh etnik në pjesën Malazeze janë Serbet të cilët përbejnë 27.9% të popullsisë totale. Grupi i dytë i pakicave janë Shqiptaret të cilët arrijnë në 9.4%; Boshnjaket përbejnë rreth 8.9 %. Pjesa Shqiptare banohet në mënyrë me homogjene nga etnia Shqiptare me disa përjashtime në Rajonin e Shkodrës ku banon një pakice shumë e vogël (me pak se 1% e popullsisë së Rajonit të Shkodrës) me etni Malazeze.

3.4 Përshkrimi Gjeografik

Zona e programimit ndërmjet Shqipërisë dhe Malit të Zi pozicionohet në Evropën Jug-lindore, në afërsi të fundit jugor të bregdetit lindor të Adriatikut. Ai kufizohet me Serbinë në veri-lindje dhe Kosovën në lindje. Kjo zonë shtrihet përmes maleve, fushave, luginave dhe liqeneve. Ultësirat e Rajonit të Shkodrës së bashku me Luginën e Zetes përbejnë ultësirat me të mëdha dhe pjesën më pjellore të zonës së programimit. Pjesë tjetër toke bujqësore pjellore shtrihet përgjatë luginave të lumenjve Drini dhe Morava, faktor që favorizon kultivimin e frutave dhe perimeve.

Malet janë të pasura me ujë, lende drusore dhe burime minerale. Pjerrësitë, lartësitë, relievet dhe temperatura i bëjnë zonat malore të ndryshme me ekosisteme të diferencuara. Malet e kësaj zone përfshijnë disa nga terrenet më të vështira në Evropë me një lartësi mesatare prej më shumë se 2.000 metrash mbi nivelin e detit. Në qendër të zonës së programimit, masivi i Alpeve Shqiptare (në jug-lindje të Malit të Zi dhe në veri të Shqipërisë) arrijnë pikën më të lartë në Jezerce me një lartësi prej 2,642 metrash mbi nivelin e detit. Përhapja e shumë komuniteteve të vogla në zonë të vështira dhe të vetmuara, veçanërisht në pjesën Shqiptare, sjell pasojë për ekzistencën e tyre e cila bazohet në ngastra të kufizuara të punës dhe sezone të shkurtra kultivimi.

3.5 Infrastruktura

Infrastruktura në të dyja anët e zonës së programimit është e vjetruar për arsye të mungesës së theksuar të investimeve. Rrugët dhe hekurudhat janë në kushte të këqija. Infrastruktura e porteve dhe e aeroporteve (në anën Malazeze) janë disi në kushte më të mira. Me qëllim kombinimin e plote të potencialeve të tyre, të dyja palët duhet të realizojnë përmirësime domethënëse në infrastrukture, veçanërisht në zonat me potencial turistik. Kjo përfshin garantimin e furnizimit të pandërprerë me energji elektrike si dhe riparimi dhe modernizimi i ujit dhe higjienës. Furnizimi me ujë të pijshëm është një faktor kyç në zhvillimin e infrastrukturës turistike.

3.5.1 Infrastruktura rrugore

Pozicioni gjeografik i zonës së programimit ka një rëndësi të madhe, duke qenë se korridori i transportit Adriatik-Jon i rrjetit të rrugëve Evropiane, e përshkon këtë territor. Infrastruktura rrugore arrijnë në 10.05315 km. Densiteti i rrugëve prej 866.6 km për 1,000 km² është shumë më pak se mesatarja e Bashkimit Evropian (1,253 km).

Shqipëria dhe Mali i Zi janë pjesë të Rrjetit SEETO16 . Korridori më i rëndësishëm në këtë zonë është segmenti i rrugës Shkodër – Podgorica, i cili lidhet nëpërmjet Hanit të Hotit. Ky korridor bën pjesë në Rrjetin e Rrugëve Kryesore Evropiane. Ekzistojnë 5 pika kufitare kalimi ndërmjet Shqipërisë dhe Malit të Zi ndërkohë që njëra prej tyre ofron edhe lidhje hekurudhore ndërmjet dy vendeve dhe, nëpërmjet Podgoricës, neper rrjetin rajonal hekurudhor. Infrastruktura rrugore është përmirësuar nëpërmjet rikonstruksionit të segmentit Shkodër-Muriqan si dhe rehabilitimit të segmentit Shkodër-Zogaj. Janë planifikuar përmirësime të tjera në infrastrukturën e transporteve të cilat përfshijnë ndërtimin e linjës së trakteve nëpërmjet Liqenit të Shkodrës si dhe një ure e re mbi Lumin Buna, çka do ta shkurtojë në mënyrë domethënëse komunikimin ndërmjet dy anëve të kufirit.

Pavarësisht nga përmirësimet aktuale, komunikimet ndërmjet dy anëve mbeten të papërfunduara dhe të kufizuara. Infrastruktura e transportit është larg plotësimit të kërkesave teknike bashkëkohore. Ajo ka nevojë për rehabilitim rrënjësor dhe ndërhyrje rikonstruksioni sidomos në pjesën Shqiptare. Përveç kësaj, shpërndarja e pabarabartë përgjatë territorit dhe zhvillimi

15 Kjo përben gjatësinë totale të rrugëve moderne, rrugëve nacionale dhe rrugëve rurale/komunale

16 Observatori Juglindor i Transportit, Korridoret Rrugore & Lidhjet përfshijnë: Shqipëri, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Kosova sic përcaktohet në Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1244, ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, Serbia, Mali i Zi

pamjaftueshëm për te përballuar trafikun intensive, pengon zhvillimin ekonomik dhe përdorimin optimal të pozicionit gjeografik. Një rrjet funksional transporti rrugor është esencial për zhvillimin e mëtejshëm ekonomik të zonës së programimit dhe rritjes së nivelit të turizmit.

3.5.2 Hekurudhat

Në zonën e programimit operojnë tre segmente hekurudhore; një në pjesën Shqiptare dhe dy në pjesën malazeze. Segmenti Shqiptar lidh Tiranën me Shkodrën nëpërmjet Lezhës dhe e kalon kufirin duke vazhduar deri në Podgoricë¹⁷. Duke qenë se zhvillimi i infrastrukturës fokusohet në rrjetin e rrugëve, rrjetit të hekurudhave i është kushtuar një vëmendje e pakët nga qeveritë përkatëse, çka ka sjelle prishjen e kushteve fizike të hekurudhave ndër vite.

3.5.3 Portet detare dhe Aeroportet

Tivari përfaqëson portin detar më të madh të zonës së programimit (në Malin e Zi) Ai ka një kapacitet përpunimi prej 5 milion ton mallra dhe ofron lidhje tragetesh me qytetet e Barit dhe Ankones në Itali. Aeroporti kryesor është ai ndërkombëtar i Podgoricës. Ekziston gjithashtu edhe një aeroport në Beranë, i cili përdoret kryesisht për aviacion të përgjithshëm dhe nuk është i pajisur për të përpunuar avionë të mëdhenj. Aeroporti i ri i Kukësit (Shqipëri) do t'i shtrië shërbimet e aviacionit civil në një të ardhme të afërt edhe tek fluturimet kombëtare.

3.5.4 Sistemi hidroenergjetik

Për sa i përket burimeve natyrore zona e programimit ka potenciale për prodhimin e hidroenergjisë. Kapaciteti aktual i instaluar në Shqipëri është 1,446 MW, çka përfaqëson një shkallë përdorimi prej vetëm 35% të potencialit hidroenergjetik. Pothuaj 90% e kësaj energjie gjenerohet në pjesën Shqiptare të zonës së programimit (përgjatë kaskadës së lumit Drin) që përfshin tre hidrocentralet më të mëdha të vendit Fierza, Koman dhe Vau i Dejës me kapacitete respektiv të instaluar prej 500 MW, 600 MW dhe 250 MW.

3.5.5 Uji dhe sistemet e kanalizimeve

Furnizimi me ujë, sistemet e ujërave të zeza dhe ujitja përbejnë një tjetër komponent të infrastrukturës së varfër të zonës së programimit. Për arsye të investimeve të pamjaftueshme gjatë viteve, struktura e përgjithshme e ujërave dhe trajtimit të ujërave të zeza në këtë zonë është e varfër, kjo me problematike në anën Shqiptare. Në pjesën Malazeze janë bërë me shumë investime për sisteme moderne të grumbullimit të mbeturinave, siç është zona e groposjes “Lovanja”, e para dhe aktualisht e vetmja zonë sanitare rajonale për groposje në Malin e Zi e cila është ndërtuar në përputhje me standardet e BE-së.

3.5.6 Telekomunikimi

Telekomunikimi në zonat e programimit bazohet si në linjat tokësore (fikse) ashtu edhe në sistemin mobil. Aksesit i përdoruesve ndaj shërbimit telefonik është i ndryshëm në të dy vendet. Në zonën e programimit ekzistojnë 134.706 abonentë të telefonisë fikse, por pjesa më e madhe e tyre rreth 88.3% janë në Malin e Zi. Me përjashtim të qyteteve kryesore, depërtimi i telekomit Shqiptar në zonat rurale është i ulët. Keqfunksionimi i sistemit të telefonisë fikse në Shqipëri dhe mbulimi i ulët i tij (vetëm 1/5 e banesave në pjesën Shqiptare) është zëvendësuar me përdorimin e telefonisë mobile. Në zonën e programimit shërbimi i telefonisë mobile ka një nga penetrimet më të mëdha të telefonisë celulare për banor në Evropë. Katër operatorë (dy në Shqipëri dhe dy në Malin e Zi¹⁸) ofrojnë shërbime GSM. Të gjithë operatorët ofrojnë mbulim kombëtar dhe gjithashtu shërbime të avancuara. Vështirësitë e përhapura në komunikim kanë sjelle si pasoje mungesën e informacionit dhe izolimin. Po kështu përhapja e shërbimit të internetit është e ulët, veçanërisht në pjesën Shqiptare.

3.6 Zhvillimi ekonomik

3.6.1 Përshkrim i përgjithshëm ekonomik

Si Mali i Zi ashtu edhe Shqipëria janë anëtare të marrëveshjes së Tregtisë së Lire të Evropës Qendrore¹⁹ (CEFTA). Marrëveshja e Tregtisë së Lire përfshin një numër komoditetesh potenciale të cilat përmirësojnë kapacitetet e eksporteve në të dy vendet. Lista e komoditeteve përfshin produkte bujqësore dhe agro-industriale të freskëta dhe të përpunuar si fruta, perime, peshk, produkte qumështi, mjaltë, bime mjekësore dhe aromatike, erza, produkte drusore, tekstile dhe lëkura, etj.

¹⁷ Kjo është një linjë hekurudhore jo-elektrike me një trasë që shërben si për transport pasagjierësh ashtu edhe për trafik mallrash.

¹⁸ Operatori i trete celular e ka marrë licencën në Malin e Zi dhe duhet të fillojë funksionimin duke filluar nga Shtatori.

¹⁹ Mali i Zi e ka nënshkruar CEFTA më 19 Dhjetor 2006 por implementimi saj do të fillojë më 12 qershor 2007.

Zhvillimi i përgjithshëm ekonomik ne zonën e programimit është i zbalancuar. Pjesa Shqiptare ka një zhvillim me te ulet ekonomik jo vetëm krahasuar me pjesën e Malit të Zi por gjithashtu krahasuar me pjesën tjetër të Shqipërisë. GDP për fryme për pjesën e Malit të Zi²⁰ është 33 % me e larte se mesatarja kombëtare, ndërkohë që ne Shqipëri nuk ekzistojnë të dhëna zyrtare për GDP për fryme ne nivel rajonal.


Ne pjesën Shqiptare sektori i bujqësisë bazuar ne sipërfaqen e kufizuar të tokës bujqësore (mesatarisht 0,2221 ha për banor) mbulon 68 % të të punësuarve të përgjithshëm krahasuar me 41.15% % ne pjesën e Malit të Zi. Ne pjesën Shqiptare, nga rreth 2 600 ndërmarrje private jo-bujqësore, 65% e tyre operojnë ne sektorin tregtar (44 %) dhe shërbime (21 %), dhe vetëm 14% ne industrinë e lehte. Infrastruktura e dobët dhe problemet që kanë të bëjnë me pronësinë mbi tokën, kanë ndikuar negativisht ne zhvillimin e bizneseve lokale dhe kanë dekurajuar investuesit e huaj. Edhe pse investimet e huaja direkte kanë luajtur një rol të rëndësishëm ne ristrukturimin e ekonomisë Shqiptare duke i dhënë një shtytje rritjes ekonomike, ne pjesën Shqiptare është investuar vetëm një fraksion i vogël i kapitaleve të huaja, ndërkohë që situata është diçka më e mirë ne pjesën Malazeze për arsye të investimeve ne turizëm. Nuk ekzistojnë të dhëna për shpërndarjen e Ndërmarrjeve të Vogla e të Mesme ne Malin e Zi sipas sektorëve kryesore të ekonomisë, por duke gjykuar nga të dhënat e punësimit, sektorët me dominues rezultojnë të jenë tregtia me (15.3%) dhe industria e përpunimit (14.1%).

3.6.2 Zhvillimi Bujqësor dhe Rural

Toka bujqësore, sipërfaqja e së cilës kap 227 mijë hektarë (nga të cilat 76 mijë ha ne Shqipëri dhe 151 ha ne Malin e Zi) përfaqëson një atribut të rëndësishëm ekonomik për zonën. Sipërfaqja e përgjithshme e tokës bujqësore për frymë është 0.33 ha, ku mesatarja ne Shqipëri është 0.23 ha ndërsa ne Malin e Zi është 0.42 ha për frymë. Toka bujqësore nuk është e shfrytëzuar ashtu siç duhet. Kjo është si pasojë e topografisë dhe përberjes gjeologjike që përcakton edhe dominimin e të terrëneve pak pjellore. Zonat bregdetare ne pjesën e malit të Zi si dhe zonat përreth Liqenit të Shkodrës (luginat e Zetës dhe ulësira të Shkodrës) janë të përshtatshme për fruta (fruta subtropikale dhe ullinj) si dhe për prodhim drithërash (Figura 5) Kjo zonë ka kushte optimale për prodhimin e patateve dhe të perimeve. Pjesët kodrinore të zonës së programimit janë të përshtatshme për rritjen e ripertypësive të vegjël dhe ky reliev është i pasur me bime për prodhim mjalti, bime mjeksore, etj. Kushtet natyrore janë të përshtatshme për një zhvillim të diversifikuar të bujqësisë duke qenë se ne të njëjtën kohë teper komplekse. Zonat kodrinore-malore me një reliev të thyer dhe me mungesë ulësirash, janë faktori kryesor kufizues për zhvillimin e bujqësisë. Produktiviteti bujqësor si ne Malin e Zi ashtu edhe ne Shqipëri bazohet tek parcelat me pronësi familjare shpesh të orientuara drejt plotësimit të nevojave të tyre. Ne pjesën veriore dhe juglindore të zonës pjesa më e madhe e territorit janë lëndina, të përshtatshme për kullotjen e bagetive gjatë verës. Ne Shqipëri migrimi në shkallë të gjërë i fuqisë punëtore nga zonat rurale ka sjellë si pasojë uljen e përdorimit të tokave të punëshme, si edhe të prodhimit.

3.6.3 Industria

Sektori industrial ne zonën e programimit bazohet ne prodhimin e energjisë elektrike, celikut, aluminit, nxjerrjes së qymyrit, pyjeve dhe përpunimit të drurit, tekstileve dhe industrisë së lekures. Sektori i industrisë është me prezent ne pjesën e Malit të Zi, ku ekzistojnë kapacitete të konsiderueshme vecanerisht për përpunimin dhe finalizimin agro-industrial, prodhimin e cigareve dhe të konfeksioneve, etj. Ne zonën e programimit ndodhen kompanitë më të mëdha Malazeze siç janë Uzina e Aluminit në Podgoricë. Sektori industrial ne pjesën Shqiptare është pak i zhvilluar. Industria e bakrit, dikur shumë e rëndësishme për zonën dhe krejt ekonominë e vendit, është bërë sot e



²⁰Ne tre bashki të zonës së programimit (Budva, Bara dhe Podgorica) GDP për capita është më e lartë se mesatarja kombëtare. GDP për capita për vitin 2004 kapte shifrën 2,645.43€.



²¹Të dhënat përfaqësojnë popullsinë agrare kundrejt asaj totale.

paperfillshme. Kapacitetet agro-perpunuese ne pergjithesi jane te kufizuara. Megjithese duket sikur ekziston nje interes i madh ne krijimin e qendrave bujqesore dhe te perpunimit te produkteve te qumeshtit, ekzistojne mundesi financimi shume te kufizuara per te investuar ne teknologjite bashkekohore.

Industria minerare. Ne pjesen Malazeze ekziston nje miniere qymyri ne Berane. Gjithashtu edhe pjesa Shqiptare eshte e pasur me burime nentokesore, vecanerisht baker. Gjate periudhes se komunizmit industria minerare ishte mjaft e perhapur. Aktualisht te gjitha minierat ne Gjegjan dhe Nimce, (zona e Kukedit), ne Golaj (ne zonen e Hasit) dhe Kam (ne Tropoje) jane te mbyllura.

3.6.4 Sektori I SME-ve

Permiresimi I klimes per biznes net e dyja anet e zones se programimit, ka kontribuar ne rritjen e numrit te SME-ve. Sipas Zyave te Taksave (ne Malin e Zi dhe Shqiperi) ne zonen e programimit ekzistojne rreth 13.000 Ndermarrje te Vogla e te Mesme te regjistruara: 80 % ne pjesen e Malit te Zi dhe 20 % ne pjesen Shqiptare. Numri me I madh I SME-ve ndodhet ne Podgorica, Budva dhe Herceg Novi, per pjesen Malazeze si dhe ne Shkoder per pjesen Shqiptare. (shih Figurat 6 dhe 7)



SME-te luajne nje rol te rendesishem per zhvillimin ekonomik te te dy zonave. Ato kane rendesi vitale per sa i perket mundesive te punesimit qe ofrojne, promovimit dhe diversifikimit te aktiviteteve ekonomike, mbeshtetjen e rritjes se qendrueshme, dhe duke kontribuar ne menyre domethenese ne eksporte dhe shkembime tregtare. Deri tani kane ekzistuar perpjekje per ta rritur bashkepunimin ndermjet dhomave te tregtise dhe SME-ve, por ekzistojne akoma mundesi teper

te medha per ta intensifikuar nivelin e bashkepunimit dhe aktivitetet per shkembimin e njohurive, ne vecanti ne sektoret e sherbimeve dhe ate te turizmit.

3.6.5 Turizmi

Turizmi eshte nje sektor me potenciale rritjeje, kjo per shkak te burimeve natyrore si dhe te vendeve me karakter historik dhe kulturor qe ndodhen ne te dyja anet e zones se programimit. Secila pjese e kufirit ka potencialet e saj individuale: natyre terheqese, bregdet te mrekullueshme, liqene terheqese, parqe kombetare, vende historike si dhe mundesi per zhvillimin e sporteve malore dhe dhe turizmit rural.

Niveli i turizmit ne pjesen perfituese Shqiptare (me nje perjashtim te vogel per Shkodren), eshte simbolik. Kjo ka te beje me faktore te shumte sic jane: kushtet e keqija te infrastruktures (rruget, energjia, uji dhe higjiena), kapacitetet e vogla akomoduese, marketingu jo-profesional si dhe mungesa e informacionit dhe guidave turistike. Shkodra eshte nje qytet i lashte me nje te kaluar te pasur historike. Ekzistojne vende te shumta terheqese per zhvillimin e turizmit. Ne afersi te Shkodres ndodhen: plazhi i Velipojes, Liqeni I Shkodres, Keshtjella e Rozafes, Kisha e Shirgjit, Ura e Mesit, rrenojat Ilire te Gajtanit dhe qyteti mesjetar I Sardes. Shkodra perben gjithashtu nje pikenisje te mire per udhetime per tek Alpet Shqiptare. Pjesa e paprekur e Rajonit te Kukedit eshte e njohur per bukurite e egra dhe mund te ngjalle interes te madh tek turistet malore. Liqenjte dhe lumenjte e shumte ofrojne mundesi te shkelqyera panoramash per objekte turistike dhe turizem aventurash ne kete zone.

Zona perfituese e Malit te Zi ofron nje infrastrukture turizmi shume me mire te zhvilluar. Ne vitin 2006 kjo zone u vizitua nga 0.8 milion turiste me nje mesatare qendrimi prej 6.4 ditesh. Rreth 1/3 e vizitoreve ishin te huaj. Nje bregdet shume i bukur shtrihet pergjate pjeses perendimore duke filluar

nga Ulqini (plazhi I vjeter I gjate 13 km), Bar dhe Budva (21 km i gjate me 17 plazhe). Bar eshte nje qytet port, por i mirenjohur per shume objekte historike dhe kulturore te cilat ofrojne nje numer te madh festivalesh dhe evenimentesh kulturore. Bregdeti i Budvas perben qendren e turizmit te Malit te Zi.

Megjithate zhvillimi i turizmit ne kete zone po perballlet me veshtiresi te medha per shkak te problemeve qe kane te bejne me furnizimin me uje, planet rregulluese te qyteteve, nje numer i madh akomodimesh te pa-regjistruara, ndertime pa leje dhe infrastrukture e keqe rrugore (ne zonat malore)

3.7 Burimet njerezore

3.7.1 Edukimi, Puna Kerkimore dhe Zhvillimi


Sistemi i edukimit ne Malin e Zi eshte i mire-zhvilluar ne te tre nivelet. Ekzistojne 221 shkolla fillore me 44,866 studente. Ka nje shkalle te ulet analfabetizmi i cili arrin ne me pak se 2%. Vetem ne Podgorice ekzistojne 12 shkolla te mesme, ne Bar dhe Cetinje 3, Berane 4 si dhe nga nje shkolle ne cdo qytet tjeter. Qendra me e madhe universitare eshte ne Podgorice e cila perbehet nga 10 fakultete. Cetinje dhe Budva kane departamente rajonale te Universitetit te Malit te Zi.


Ne Shqiperi ekzistojne 310 shkolla fillore dhe tetevjecare me 60,678 studente si dhe 49 shkolla te mesme me 16,949 studente. Ekziston nje universitet ne qytetin e Shkodres me nje numer total prej 10,089 studentesh. Universiteti i Shkodres perfaqeson qendren me te rendesishme te zhvillimit intelektual, kulturor dhe social ne pjesen Shqiptare te programimit. Funksionimi normal i shkollave, sidomos ne zonat rurale eshte influencuar nga ndryshimet e dendura gjeografike. Ne disa zona urbane ka mbipopullim klasash. Pavaresisht disa permiresimeve, perseri shume shkolla nuk ofrojne nje edukim cilesor per shkak te mungeses se mesuesve te kualifikuar, mungeses se laboratoreve dhe mjeteve didaktike, investimeve te pamjaftueshme, etj.

3.7.2 Tregu i Punes (punesimi dhe papunesia)

Megjithese nuk raportohen diferenca te medha ndermjet Shqiperise dhe Malit te Zi ne lidhje me shkallen e papunesise ne nivel kombetar, situata ne zonen e programimit eshte e kunderta. Shkalla mesatare e papunesise eshte rreth 15, 6% ne pjesen Malazeze, ndersa ne ate Shqiptare eshte 28.8%. Niveli i papunesise ne pjesen Shqiptare eshte dy here me i larte se mesatarja kombetare dhe numeron rreth $\frac{1}{4}$ e papunesise totale te gjithe Shqiperise.

Grupmosha nen 45 vjec perfaqeson 80-90 % te popullsise se papune (Figura.8 me poshte). Nivelet e papunesise sipas nivelit te edukimit jane te ndryshme ndermjet vendeve (Figura 7). Shkalla e papunesise ndermjet personave me edukim te mesem ne Malin e Zi eshte me e larte (63%) ne krahasim me Shqiperine (52%), nderkohe qe ne Shqiperi niveli i papunesise ne kuadrin e popullsise me edukim tetevjecar eshte me i larte (46%) se san e Malin e Zi (29%).





Struktura e punesimit sipas sektoreve eshte e ndryshme ne secilen ane te kufirit. Ne Malin e Zi sektoret e turizmit, sherbimeve, bujqesise, arkitektures dhe tregtise punesojne pjesen me te madhe te fuqise punetare. Ne anen Shqiptare pjesa e me e madhe e fuqise puntore eshte e punesuar ne bujqesi, tregti, industrine e lehte (tekstile dhe te lekures) dhe sherbimet.

Shkalla e larte e papunesise dhe dominimi i sektorit bujqesor, kontribojne per nje nivel me te larte varferie ne pjesen Shqiptare. Treguesi sipas te cilit “nje pjese e popullsisë jeton me me pak se 2 USD ne dite” i matur ne vitin 2002, demonstroi qe nje pjese e madhe e popullsisë jeton nen nivelin e varferise. Te dhenat paraprake nga LSMS 2005 treguan permiresime, por varferia eshte akoma e larte dhe e vazhdueshme ne zonat rurale dhe malore.

Sipas Dokumentit Strategjik per Uljen e Varferise ne Malin e Zi te vitit 2004, 12.2% e popullsisë eshte e varfer. Niveli i varferise eshte me i madh midis minoriteteve Rom, Aşkelja dhe Egjiptiane (52.3%).

3.8 Ambienti dhe Natyra

Zona e programimit eshte e pasur me rezerva natyrore dhe zona te mbrojtura. Ne pjesen e Malit te Zi jana dy Parqe Kombetare (Liqeni I Shkodres dhe Lovćen). Ne pjesen Shqiptare ekzistojne 7 parqe kombetare, rezerva natyrore dhe panorama te mbrojtura (Thethi, Tropoja, Shkoder, Buna-Velipoje).

Baseni i Liqenit te Shkodres eshte nje zone shume e rendesishme per arsye te vlerave te saj biologjike, shkencore, kulturore, shendetesore, argetuese dhe turistike. Sot liqeni eshte nja nga zonat me te rendesishme te zogjve te Europes Jug-lindore me rreth 270 specie te regjistruara qe perfshijne edhe pelikane te rralle. Industrite, depozitat e fermave bijqesore, shkarkimi i ujrave te zeza dhe mungesa e trajtimit te mjaftueshem te kanalizimeve, po cojne gradualisht ne eutrofikimin e Liqenit te Shkodres. Pervec kesaj gjuetia pa kriter e peshkut ne te dy anet e kufirit ka sjelle pakesimin e ushqimit per zogjte qe ushqehen me peshq.

Kompania e aluminit ne Podgorice eshte ndotesi i vetem me i madh i Malit te Zi. Nuk ekziston nje filtrim i pershtatshem gjate perpunimit te boksitit dhe shnderrimit ne alumin. Mungesa apo perdorimi i filtrave difektoze ka shkaktuar nivele te larta pluhrash te imta, solventesh dhe fluoridesh. Terreni eshte i ndotur me PCB. Uji tokesor eshte i ndotur me PCB dhe fluoride. Nje depozite bujqesore pesticidesh (selinon) ne Rajonin e Kukesit ne Shqiperi, eshte vecanerisht helmuese per njerezit dhe kancerogjen. Gjithashtu te gjitha minierat e mbylluara ne Rajonin e Kukesit krijojne ndotje.

Burimet natyrore ne pjesen Shqiptare jane te ruajtura por disa vende jane te ndotura dhe me rrezik te larte degradimi. Pyjet rrezikohen nga c’pyllezimi; lumenjte dhe liqenet rrezikohen nga ndotjet prej groposjeve te paligjshme (menaxhim i dobet i mbeturinave industriale dhe urbane); fauna eshte e kercenuar nga peshkimi pa kriter dhe gjuetia ilegale. Degradimi i tokes eshte nje fenomen qe haset si ne Kukes ashtu edhe ne rajonin e Kukesit.

Ne vitin 2005 Shqiperia dhe Mali i Zi organizuan nje takim te nivelit te larte i cili iu dedikua diskutimeve rreth mbrojtjes se burimeve dhe diversitetit te Liqenit te Shkodres. Perfaqesues nga te dy qeverite vendosen krijimin e nje komiteti qe do te merret me sfidat ambientale te Liqenit te Shkodres.

Me ndihmen e PNUD-it u krijua Zyra per Zhvillimin e Qendrueshem nen kabinetin e Kryeministrit te Malit te Zi. Si Shqiperia ashtu edhe Mali i Zi i kane dhene prioritet ceshtjeve te cilat kane te bejne me ambientin. Programet e perbashketa, megjithese te kufizuara, kane si synim intensifikimin e aksioneve per mbrojtjen e natyres dhe ambientit te zones. Ne Malin e Zi, Ministria per Mbrojtjen e Ambientit ka krjuar para pak vitesh sistemin e monitorimit te cilesise se ajrit dhe terrenit, nderkohe qe Ministria e Bujqesise, Pyjeve dhe manaxhimit te Ujit ka detyrimin ligjor te monitorimit te cilesise se ujit. Megjithate ekziston nevoja per permiresimin e te dhenave nga sistemet e monitorimit te ambientit, cka duhet realizuar ne te dy anet e kufirit.

3.9 Kultura

Kultura ne zonen e programimit eshte ne pergjithesi e karakterizuar nga elemente tradite te ndryshme, te perbashketa si dhe individuale. Qendrat turistike dhe qytetet e medha jane te pasura me trashegimni kulturore qe perfshijne monumentet dhe objektet e kultit (kishat, manastiret dhe xhamite), qytetet e vjetra, zonat arkeologjike dhe muzeumet e ndryshme. Zona e programimit eshte gjithashtu e pasur me tradita te diversifikuara kulinare dhe zejtarie te cilat mund te luajne nje rol te rendesishem ne promovimin dhe zhvillimin e metejsheem te turizmit. Disa nga OJQ-te e grave ne te dy anet e kufirit kane filluar nga puna per vleresimin dhe ruajtjen e ketyre trashegimnive.

Komunikimi dhe shkembimi ndermjet institucioneve publike te kultures dhe shoqatave te ndryshme, edhe pse ne nje nivel modest kane kontribuar ne krijimin e kontakteve te reja. Keto kontakte duhen intensifikuar ne te ardhmen, duke hedhur ne kete menyre bazat per nje bashkepunim me aktiv nder-kufitar. Ruajtja e trashegimise kulturore eshte faktor shume i rendesishem per ruajtjen e identitetit te ketij rajoni.

3.10 Kuadri Institucional

Mali i Zi eshte i ndare ne 21 bashki si njesi baze te vete-qeverisjes. Shqiperia ka nje strukture administrative te ndryshme. Vendi eshte i ndare ne 12 qarqe te cilat perfshijne 36 rrethe. Qarqet ndahen ne bashki (ne zonat urbane) dhe ne komuna (ne zonat rurale). Zhvillimi rajonal perben nje element kyc ne procesin aktual te reformave te decentralizimit ne Shqiperi. Reformat fiskale te koheve te fundit kane si synim te arrijne autoritet te plote te njesive te qeverisjes vendore per sa i perket taksimit te bizneseve te vogla. Perpjekjet per te vene ne zbatim skemen e kreditimit te bashkive do t'u japin me shume liri njesive lokale ne drejtim te implementimit te programeve te zhvillimit.

3.11 Te metat kryesore, mosbarazite dhe potencialet per zhvillimin e zones se programimit

Analiza e pikave te forta dhe dobeseve te zonave perfituese net e dy vendet, kontriboi per te nxjerre ne pah disa aspekte te vecanta te veshtiresive/problemeve nga njera ane, dhe te burimeve/mundesive nga ana tjeter, te cilat influencojne bashkepunimin nder-kufitar ne kete zone.

Analizat e situates ne zonen e programimit rezultuan ne konkluzionet kyce te meposhtme ne lidhje me pikat e forta te kesaj zone:

- Sektori i turizmit eshte pranuar qe eshte shume i rendesishem per zhvillimin ekonomik dhe social te rajoneve qe ndodhen ne zonen e programimit. Intensifikimi i metejsheem I shkembimeve kulturore si dhe vleresimi i trashegimnise historike dhe kulturore do te kontribojne ne forcimin e identitetit te rajonit. Megjithate, zhvillimi i turizmit po prballet me veshtiresi ne rritje te cilat rrjedhin nga infrastruktura rrugore dhe nga situata ambientale.

- Burimet ekzistuese natyrore kane nje rendesi domethenese ne lidhje me cilesine e jetes dhe perfitimet ekonomike te popullates te zones, kjo nepermjet venies se ketyre burimeve ne funksion te objektivit te zhvillimit te sektorit te turizmit. Gjithesesi, e gjithë zona po prballet me probleme mjedisore per sa i perket vleresimit dhe ruajtjes. Nje nga prioritetet e momentit ka te beje me ruajtjen e zonave bregdetare nga shkarkimet e mbeturinave ujore dhe solide, ashtu si edhe ndotjes se ajrit nga aktivitetet industriale.

- Ekonomite lokale jane ne zhvillim e siper dhe objektivi i tyre eshte qe te behen me terheqese per investimet e huaja direkte. Forcimi i rrjeteve te SME-ve dhe lidhjeve te sherbimeve qe ekzistojne ne secilen ane te zones se programimit, eshte nje faktor themelor. Zhvillimi infrastruktures dhe perhapja e lidhjeve te rrjeteve dhe sherbimeve te afta qe te mbeshtesin perhapjen e njohurive dhe te novacionit , do te kontriboje ne drejtim te rritjes se pergjithshme te prosperitetit dhe ekonomise.

Me poshte pasqyrohen pikat kryesore te dobeta te cilat dalin nga analizat socioekonomike:

- struktura e tregut te punes paraqet nivele te larta papunesie tek te rinjte dhe vecanerisht tek

femrat.

- prezenca e flukseve te fuqishme migrimi ka influencuar fuqine punetore dhe ka rezultuar ne pakesimin e punonjesve te pergatitur dhe te edukuar.

- nivelet e standardit te jeteses te te gjitha komunitetit ne territorin e zones se programimit gjate viteve te fundit jane perkeqesuar dhe se bashku me krizen e tregut te punes kane rritur fenomenet e izolimit, veshtiresive sociale dhe emigrimit te te rinjve;

- zhvillimi ulet i ekonomive eshte i lidhur ngushte me perdorimin e pamjaftueshem te potencialiteve ekzistuese te burimeve natyrore dhe kulturore dhe ne vecanti me potencialet e turizmit;

Ne te njejten kohe territor shfaq potencialitete, mundesi dhe burime themelore sic jane:

- nje numer i larte te rinjsh te cilet kerkojne punesim duke patur nivel arsimimi shkollen e mesme-te larte, kjo fale gjithashtu edhe presences se nje sistemi edukimi universitar te gjere dhe te kualifikuar;

- nje sistem ndermarrjesh me te vogla e perhapur ne zonen e programimit, vecanerisht dinamike;

- nje trashegimni ambientale, natyrore dhe historiko-artistike e rendesishme dhe prezente ne shumicen e territorit te zones se programimit;

- nje sistem oferte trainimi dhe novacioni, e perhapur gjeresisht neper territor, e afte per te mbeshtetur sic duhet kerketat qe vijne nga sistemi socio-ekonomik si i tere;

- nje pozicionim gjeografik i cili i jep zones rolin e nje udhekryqi te privilegjuar te arterieve te komunikimit per zonen e Ballkanit nga njera ane dhe Europes Qendrore nga ana tjeter. (korridori n.10).

3.12 Analizat SWOT te zones se programimit

Tabelat e meposhtme pasqyrojne nje analize te detajuar te kater kategorive, pikave te dobeta, pikave te forta, mundesive dhe rreziqeve ne zonen e programimit:

PIKAT E FORTA	PIKAT E DOBETA	MUNDESITE	RREZIQET
I. KUADRI LIGJOR & INSTITUCIONAL			
- Protokolli ekzistues i bashkepunimit ndermjet Shqiperise dhe Malit te Zi - Ekzistenca e Forumit Rajonal te bashkepunimit ndermjte rajonit te Shkodres dhe Malit te Zi - Implementimi i marrveshjeve dhe programeve te perbashketa per ruajtjen e Liqenit te Shkodres - Kuadre te pergjithshme ligjore te favorshme dhe terheqese per zhvillimin e FDI-ve;	- Mosperputhje ndermjet njesive administrative lokale ne fushen e zhvillimit ekonomik dhe social. - Kapacitete te kufizuara te autoriteteve te vete-qeverisjes lokale, se ciles i duhet shtuar niveli i ulet i infrastructures se informacionit dhe komunikimit. - Eksperience e kufizuar ne zonat perfituese per identifikimin dhe implementimin e programeve te perbashketa dhe projekteve nderkufitare.	- Mundesite per te zhvilluar mekanizma dhe instrumenta te ndryshem te cilat synojne lehtesimin e krijimit te partneriteteve per iniciativat nderkufitare; - Mundesi per rritjen e kapaciteteve te organizatave te shoqerise civile per te marre pjese ne programet e perbashketa dhe per te zhvilluar iniciativa partneriteti publik/ privat.	- Vonesa ne adoptimin e venies ne zbatim te kuadrit ligjor respektiv te pronesise, ka impakt negativ ne implemetimin e programeve strategjike rajonale dhe lokale te zhvillimit - Adminstrata te vete-qeverisjes lokale te pazhvilluara dhe pa pajisjet e duhura. - Mungese interesi dhe kapacitetesh tek punonjesit e sektorit publik per t'ju pergjigjur kerkesave te programeve te reformes.
II. EKONOMI/ PRODHIM / SME-TE			
- Marrdhenia e tregtise se lire ndermjet dy vendeve - Burime kulturore dhe natyrore te pershtatshme per pershejtimin e zhvillimit ekonomik; - Burimet natyrore, Liqeni i Shkodres, dhe trashegimnia kulturore si potencial per zhvillimin e turizmit - Nivel relativisht i mire i edukimit ne zonen e programimit, nga prezenca e universiteteve dhe qendrave te tjera te trainimit profesional; - Ekzistenca e inkubatoreve te biznesit (ne Malin e Zi) dhe agjensive rajonale te zhvillimit (ne Shqiperi) - Investime ne infrastrukture te cilat synojne mbeshitetjen e zhvillimit te industries se turizmit ne zonat qe rrethojne Liqenin e Shkodres	- Diferenca ndermjet njesive te vete-qeverisjes lokale ne fushen e zhvillimit social dhe ekonomik; pabarazi e larte e zhvillimit urban me ate rural; - Mungesa e njohurive per standardet nderkombetare per te permiresuar aksesin ndaj tregjeve rajonale dhe atyre te BE-se. - Teknologji dhe fuqi puntore te pazhvilluara ne sektorin e industrise dhe bujqesise	- Mundesi per te krijuar dhe zhvilluar nje product te integruar turizmi qe te perfshije zonat e liqenit, bregdetit si dhe ato malore - Konkureshmeria ne rritje e turizmit; - Mundesia per te terhequr investimet dhe per te rritur partneritetet publike/private per krijimin e nje infrastrukture rrugore te pershtatshme; - Inkurajim i bashkepunimit nderkufitar ndermjet agjensive te cilat mbeshetin SME-te, qendrave urbane dhe agjensive te zhvillimit - Mundesi per permiresimin e lidhjeve ekonomike te ndermarrjeve Shqiptare me ndermarrjet Malazeze	- Relievi dominuar malor mund te kete nje impact negative ne zhvillimin ekonomik lokal; - Vonesa ne zgjidhjen e ceshtjeve te pronesise

PIKAT E FORTA	PIKAT E DOBETA	MUNDESI	RREZIQE
III. INFRASTRUKTURA & KOMUNIKIMI			
- Aksesit ndaj Korridorit 10	- Mungesa te rendesishme dhe	- Rruha kryesore Adriatik-Jon e cila mund	- Infrastruktura elektrike e vjeteruar

mundeson trafikun e transportit ne brendesi te Ballkanit dhe prej aty ne Europen Qendrore. - Fluksi ne rritje i trafikut ne pikat e kalimit kufitar ne vitet e fundit . - Nderlidhja hekurudhore - Problemet aktuale te permiresimit te rrjeteve rrugore	problemet me rrjetin e rrugeve dytesore se bashku me kushtet e pafavorshme te motit gjate periudhes se dimrit. - Pikat kufitare te kalimit te papajisura sic duhet per transportin e mallrave. - Transporti i pasigurte se bashku me konditat e veshtira gjeografike; - Mungesa e trajtimit te ujrave te zeza dhe kanalizimeve	te integroje Shqiperine dhe Malin e Zi me korridoret moderne Europiane te transportit. - Perdorim me i mire i rrjeteve ekzistuese te komunikimit dhe transportit - Mundesi per lehtesimin e levizjes se njerezve dhe mallrave nepermjet permiresimit te infrastruktures te rrugeve dhe pikave kufitare te kalimit te kufirit - Investime me te medha ne sistemet e ujit te pijshem dhe te kanalizimeve	- Infrastruktura e pazhvilluar e rrugeve, hekurudhave dhe porteve; - Burime lokale financiare te pamjaftueshme per rindertimin dhe mirembajtjen e infrastruktures lokale te demtuar; - Ndertimet ilegale te cilat shkaktojne nje presin shtese ndaj infrastruktures dhe kane impakt negativ ne mbrojtjen e zonave bregdetare - Vonesa ne ceshtjet e zgjidhjes se kthimit te pronave
IV AMBIENTI & CILESIA E JETESES			
- I pasur me burime natyrore dhe parqe - Ekzistenca e disa Parqeve Natyrore te pershtatshme per zhvillimin e eko-turizmit - Liqeni i Shkodres dhe pyjet me rendesi te madhe ambientale - Te pasur me bime mjekesore dhe specie bimesh karakteristike. - Ekzistenca e programeve per zhvillimin dhe ruajtjen e Parqeve Kombetare (Liqeni i Shkodres)	- Ekzistenca e eko-sistemeve vecanerisht te ndjeshme te cilat kerkojne nje nivel te larte ruajtje - Burimet natyrore nuk njihen akoma si burim i konsiderueshem potencial i te ardhurave - Mungesa e kanalizimeve dhe trajtimit te mbetjeve ujore sjell rritjen e ndotjes te burimeve natyrale ujore; - Kontroll i pamjaftueshem ne lidhje me trajtimin e mbeturinave, rrezikon si cilesine e ujit ashtu edhe cilesine e terrenit - Nivel i ulet i implementimit te legjislacionit te BE-se qe ka te beje me ceshtjet ambientale ne sektoret private dhe publike.	- Zona e pasur me burime natyrore relativisht e ruajtur per shkak te mungeses se industrive te zhvilluara; - Mundesi per zgjerimin e parqeve kombetare dhe rezervave natyrore dhe per nje manaxhim nder-kufitare te burimeve natyrore. - Ndergjegjesim me i madh i publikut ne lidhje me nevojat e ruajtjet se ambientit - Mundesi per aktivizem per ruajtjen e ambientit nga organizatat jo-qeveritare ne rajon - Mundesi per te zhvilluar kapacitetet lokale (si tek njesite e vete-qeverisjes lokale ashtu edhe tek organizatat jo-qeveritare) per te ndermarre studime te arrira te vleresimit te impaktit perpara se te leshohet nje licence apo nje leje per nje aktivitet investimi.	- Mungesa e ambienteve per trajtimin e mbetjeve te ngurta, ndertuar sipas standardeve te BE-se; - Mungesa e nje vleresimi te duhur te impaktit perpara fillimit te investimit. - Mungesa e kontrollit dhe shfrytezimi i tepert i burimeve natyrore mund ta vene ne rrezik serioz ambientin, standardet e jeteses dhe mireqenien e popullsise lokale - Rreziku i zhdukjes se specjeve origjinale dhe ndryshimi i biodiversitetit

PIKAT E FORTA	PIKAT E DOBETA	MUNDESITE	RREZIQET
V. BURIMET NJEREZORE & EDUKIMI			
- Ekzistenca e institucioneve kerkimore dhe te Universiteteve te Shkodres dhe Podgorices (me fakultete	- Mungesa e punonjesve te kualifikuar per nevojat specifike te industries dhe agroperpunimit	- Permiresime te nivelit te trainimit profesional, cka do te kishte nje impakt direkt ne kualifikimin e tregut	- Per shkak te rregullores se ngurte te punes, force pune e pa-regjistruar - Infrastruktura sociale tregon

dhe departamente fakultetesh ne Budva dhe Cetinje) si dhe krijimi i atyre te reja, ka si rezultat nje force pune te re dhe te edukuar ne lartesis e duhur te kerkesave te tregut bashkekohor; - Ekzistenca e nje rrjeti te institucioneve te trainimeve profesionale per mbeshtetjen e rritjes se kualifikimeve te punonjesve; - Implementimi i nje programi edukimi te akredituar ne shkalle nderkombetare vecanerisht ne nivelin universitar (Deklarate e Bolonjes); - Popullsi relativisht e re ;	- Niveli i larte i papunesise vecanerisht ne zonat urbane - Shpopullimi, perkeqesimi demografik ne rajonet perfituese dhe migrimi i punes; - Migrimi ka ardhur ne rritje gjate viteve. - Popullsi ne plakje dhe numer ne rritje i shtepive te banuara nga te moshuar neper zonat rurale per arsye te migrimit te popullsise me moshe te re - Mungesa e gjuheve te huaja dhe njohurive per Teknologjine e Informacionit (IT) sidomos ndermjet fuqise puntore me moshe mesatare te nevojshme per pershpjtimin e zhvillimit ekonomik; - Mungesa e njohurive praktike dhe nivel i ulet i njohurive teknike te asimiluara nga studentet, krijon impakt ne krijimin e nje fuqie puntore qe nuk ploteson kerkesat e tregut te ri te punes.	te punes duke e bere ate me terheqes per ndermarrjet e huaja. - Zhvillimi dhe implementimi i kurseve te ndryshme per rritjen e kualifikimeve aktuale. - Mundesi ekzistuese per rritjen e potencialeve te punesimit ne sektorin privat dhe iniciativave te biznesit te orientuara ndaj kerkesave te tregut;	dobesi evidente. Vecanerisht te preکشme jane rajonet rurale dhe ato malore - Perqendrimi i aktivitetit ekonomik dhe mundesive te punesimit tek qytetet e medha cfare do ta thellonte edhe me teper problemin e shpopullimit te banimeve rurale.
VI. KULTURA & TURIZMI			
- Diversiteti multikulturor si nje force pozitive per forcimin e identitetit kombetar dhe atij kulturor. - Pasuria e trashegimnia e burimeve kulturore - Klime e favorshme Mesdhetare - Ekzistenca e tradites ne shkembimet kulturore	- Mbrojtje dhe ruajtje e dobet e trashegimnise historike dhe arkeologjike - Pamundesia per te zhvilluar elementet e ndare te trashegimnise kulturore me anen tjeter te kufirit - Praktika te pmjaftueshme per zhvillimin e turizmit historic dhe kulturor. - Furnizime te papershtatshme – sic jane furnizimi i vazhdueshem me uje, cilesia e	- Mundesi per zhvillimin e turizmit ekologjik, llixhave dhe atij kulturor si dhe formave te tjera te turizmit, cka do te sillte zhvillimin e turizmit rajonal nder-kufitar. - Rritja potenciale e faciliteteve kulturore (organizatat kulturore) - Mundesite per zhvillimin e formave te specializuara te turizmit (turizmi	- Kujdes i paket ndaj ruajtjes dhe mbrojtjes te monumenteve dhe trashegimnise kulturore dhe historike - Niveli akoma i ulet i zhvillimit ekonomik nuk ofron resurse te mjaftueshme per investime ne kulture ; - Mungese e ndergjegjesimit ndaj

	ujit te pijshem dhe furnizimi me energji elektrike, do te ndikojne ne cilesine e turizmit dhe tek te ardhurat prej tij..	liqenor dhe malor, vizitat ne qytete, etj) - Mundesi per te zhvilluar strategji dhe programme te perbashketa per zhvillimin e turizmit, ruajtjen dhe promovimin e trashegimnise historike dhe kulturore ; - Mundesi per te zhvilluar dhe forcuar kapacitetet e institucioneve lokale qe kane te bejne me ceshtjet e kultures dhe tradites..	potencialeve qe trashegimnia kulturore dhe historike mund te zhvilloje ne rajon.
--	---	---	---

SEKSIONI II STRATEGJIA E PROGRAMIT

1. Eksperienca me aktivitetet nder-kufitare

Niveli i bashkepunimit ndermjet Shqiperise dhe Malit te Zi eshte relativisht i koheve te fundit. Ky bashkepunim eshte realizuar me shume ne nivelin e institucioneve qendrore dhe me pak ndermjet rajoneve kufitare.

Bashkepunimi mes dy vendeve bazohet ne protokollet dhe marrveshjet ekzistuese si me poshte:

- Marrveshja e Tragtime se Lire ndermjet dy vendeve.
- Protokolli i Bashkepunimit ndermjet dy vendeve sipas te cilit te dyja palet bien dakord qe te zhvillojne aktivite te perbashketa per te promovuar turizmin; per te hapur pika te tjera te kalimit te kufirit dhe modernizuar ato ekzistuese me qellim sigurimin e faciliteve te tjera per transportin e njerezve dhe te mallrave; per te zhvilluar nje konvente per bashkepunimin ne fushen e turizmit; per te vepruar ne menyre te perbashket per projektin e zhvillimit te Liqenit te Shkodres; dhe per te promovuar nenshkrimin e kontratave ndermjet firmave te turizmit dhe kompanive te hoteleve ne te dyja vendet. Rezultati i ketij protokolli deri ne momentin e tanishem ka qene modest dhe me impakt te vogel.

- Forumi Rajonal i bashkepunimit ndermjet Shkodres dhe Malit te Zi. Ky forum ka si synim promovimin e bashkepunimit ndermjet dy rajoneve. Ne kete forum bejne pjese perfaqesues te qeverisjes vendore dhe te sektorit privat, te cilet duhet te organizojne takime te perbashketa 3-4 here ne vit.

- Marrveshja e Lundrimit te Nentorit 2004, sipas se ciles palet bien dakord per realizimin e nje linje lundrimi nderkombetare Shkodra-Virpazar.

- Plani i Aksionit Strategjik per Liqenin e Shkodres i Marsit 2007 i krijuar ndermjet Ministrise se Turizmit dhe Ambientit te Malit te Zi dhe Ministrise se Ambientit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave te Shqiperise.

Mesimet e nxjerra

Pjesa me e madhe e iniciativave te bashkepunimit nderkufitar kane filluar vetem kohet e fundit, duke e bere te parakohshme percaktimin e sakte te « mesimeve te nxjerra ». Megjithate, pikat e meposhtme mund te theksohen nga eksperienca ne bashkepunimin nderkufitar midis vendeve te tjera te Ballkanit Perendimor:

- Projektet e fokusuara ne mbrojtjen e ambjentit reflektojne prioritete te percaktuara nga institucionet rajonale dhe kombetare, duke pasur nje perfshirje te mire ne prioritetet e zhvillimit kombetar dhe lokal. Megjithate, eshte e rendesishme qe te perfshijne shoqerine civile dhe sektorin private ne programin e zhvillimit.

- Thirrjet per propozime per fonde te vogla per aktivite te bashkepunimit nderkufitar te lancuara ne periudhat e meparshme kane treguar se ekzistojne kapacitete te ulta ne te gjitha perfuturit lidhur me pergatitjen e propozimeve. Kjo do te ishte nje pengese per zbatimin e programit. Trajnimi specifik per aplikantet e mundshem, gjate zbatimit te programit, do te ishte esenciale.

- Nje numer i vogel bashkish kane pasur nje rol udheheqes ne te kaluaren si dhe ne iniciativat aktuale te bashkepunimit nderkufitar. Keto bashki duhet te luajne nje rol kyc gjate zbatimit te programit (transferimi i njohurive etj) .

Gjithashtu, nga konsorciumi MWH eshte realizuar nje vleresim i programeve te BNK nen programin PHARE. Eksperienca tregoi se kushtet paraprake per zbatimin efektiv te programit perfshijne, pervec bashkepunimit te ngushte ndermjet vendeve pjesemarrese ne nivelin politik dhe operacional edhe :

- bashkepunim nderkufitar ndermjet ministrive te linjes dhe marredhenie pune efektive ndermjet organizatave respektive;

- funksionim te autoriteteve te zhvillimit rajonal dhe autoriteteve lokale, me stafin e duhur dhe nje nje ambjent te qendrueshem;

- marrdhenie te ngushta bashkepunimi ndermjet institucioneve rajonale dhe Delegacioneve respektive te Komisionit;

- funksionim i bashkepunimit nderkufitar ndermjet organizatave respektive ne sektorin privat, te

tilla si dhomat e tregetise, shoqatat e biznesit dhe OJQ-te.

2. Strategjia e Programit të Bashkëpunimit Nder-kufitar

Programi i bashkëpunimit nder-kufitar ndërmjet Shqipërisë dhe Malit të Zi do të kontribuojë në implementimin e Komponentit II të IPA-s “Bashkëpunimi Nder-kufitar” dhe Dokumentit të Planifikimit Indikativ Shumëvjeçar (MIPDs) për të dy vendet. Ky program do të ofrojë asistencë për “Stabilizimin demokratik dhe krijimin e kapaciteteve administrative”, “Zhvillimi Ekonomik dhe Social”, “Infrastruktura”, dhe “Asistencë Teknike”, të identifikuar si zonat kryesore të nderhyrjes tek MIPD për Shqipërinë dhe do t’i përgjigjet nevojave për “Zhvillimin e aktivitetëve ekonomike, ambientale dhe sociale nder-kufitare të zonave kufitare”, si dhe “Te adresojë sfidat e përbashkëta në vecanti në fushën e ambientit dhe shëndetit publik dhe zhvillimit” dhe “Te promovojë aksione lokale të tipi person-me-person duke përfshirë OJQ dhe autoritetet vendore” në MIPD për Malin e Zi.

Argumenti. Analiza e mesipërme e situatës dhe ajo SWOT nxjerrin në pah faktin që zona e programit është shumë e pasur me burime natyrore dhe kulturore por pjesë të konsiderueshme të saj janë të nën-zhvilluara krahasuar me standardet respektive kombëtare. Ekziston një potencial i madh për zhvillimin ekonomik dhe të turizmit të cilat janë përgjithësisht të pa shfrytëzuara siç duhet. Ekziston një nivel i lartë papunësie dhe i një fuqie punëtore të pa-kualifikuar dhe ekonomia e zonës është e bazuar kryesisht tek bujqësia, peshkimi dhe industritë e vogla jo-konkuruese. Që pas vitit 1990 niveli i shkëmbimeve ndërmjet kufijve është rritur në mënyrë të ndjeshme, por akoma i bazuar në disa transaksione tregtare të vogla nder-kufitare të mallrave të huaja. Marrëdhëniet ndërmjet operatorëve ekonomikë dhe organizatave rajonale dhe lokale të Shqipërisë dhe Malit të Zi, janë të dobëta dhe duket se këto pak mirëkuptim të përbashkët në lidhje me mundësitë ekonomike nder-kufitare të rajonit.

2.1 Objektivi i përgjithshëm strategjik i programit

Strategjia e këtij programi përcakton prioritetet dhe masat e përshtatshme të nevojshme për të siguruar një bashkëpunim të harmonizuar dhe të integruar të paleve të interesuara në zonën e programit, duke mbështetur dhe përkrahur aspiratat e të dy vendeve për ta thelluar bashkëpunimin rajonal.

Sic përmendet edhe me lart objektivi i përgjithshëm strategjik i këtij programi, në përputhje edhe me mundësitë financiare të vena në dispozicion, është:

- Promovimi i bashkëpunimit ndërmjet njerezve, komuniteteve dhe institucioneve në zonat kufitare, duke synuar një zhvillim të qëndrueshëm, stabilitet dhe prosperitet në interesin e përbashkët të qytetareve të të dy vendeve.

Përveç kësaj programi do të synojë të ndërtojë kapacitete të paleve të interesuara në vend, institucioneve bashkiake dhe rajonale si dhe shoqërisë civile për të marrë pjesë në iniciativat nder-kufitare.

2.2 Objektivat specifike

Objektivat specifike të programit përfshijnë:

- Promovimin e zhvillimit ekonomik të zonës nëpërmjet valorizimit ekonomik të potencialeve të saj turistike dhe kulturore.

- Mbeshtetjen ndaj iniciativave të përbashkëta dhe aksioneve që synojnë mbrojtjen, promovimin dhe menaxhimin e ekosistemeve dhe zhvillimin e qëndrueshëm të ambientit.

- Inkurajimin e bashkëpunimit të qytetareve dhe krijimit të partneriteteve në të dy anët e kufirit.

- Forcimin e kapaciteteve të strukturave kombëtare dhe atyre të përbashkëta për menaxhimin e programit nder-kufitar

- Përgatitjen & përhapjen e informacionit rreth programit si dhe përmirësimin e kapaciteteve të përfituesve potenciale për përgatitjen dhe zbatimin e projekteve.

- Vënie në dispozicion të ekspertizës teknike për vlerësimet e programeve të jashtme

3. Përparesite dhe masat

Duke marrë parasysh si anet e forta ashtu edhe ato të dobëta të zonave të përfshira; kuadri strategjik i programit është strukturuar në dy nderhyrje prioritare kryesore të cilat janë ndarë në masa me të detajuara:

Nr.	Prioriteti
-----	------------


Drejtimi I Prioritar	Promovimi i afrimit rajonal dhe konkurrueshmerise nepermjet nderhyrjeve te cilat integrojne zhvillimin ekonomik, ambiental dhe social
Drejtimi Prioritar II	Asistence teknike per te patur nje manaxhim programi dhe fluks informacioni sa me efektiv.

Ideja kryesore per perzgjedhjen e ketyre prioriteteve bazohet ne identifikimin e nderhyrjeve potenciale me interes dhe perfitim te perbashket tek nje spekter i gjere perfituesish te ndodhur ne te dy anet e kufirit.

Prioriteti i pare do te promovojë iniciativa dhe aksione te perbashketa nderkufitare te cilat synojne permiresimin e ekonomive rajonale ne nje menyre te qendrueshme sociale dhe ambientale, ndersa prioriteti i dyte do te garantoje nje manaxhim dhe implementim efektiv te krejt programit nepermjet mbeshtetjes se asistences teknike.

Krahas kujdesit paresor qe i jepet zhvillimit te qendrueshem social, ekonomik dhe ambiental, programi nder-kufitar do te inkurajoje perгатitjen dhe zbatimin e projekteve te mbeshtetur ne dy principe vitale horizontale, partneriteti nder-kufitar dhe shanset e barabarta. Krijimi i partneriteteve reale me efekte nder-kufitare eshte i domosdoshem per implementimin e ketij programi. Programi do te mbeshtese iniciativat qe promovojne shanset e barabarta dhe barazine gjinore. Prioritet do t'i jepet atyre projekteve te cilat demonstrojne perpjekje per te krijuar mundesi te barabarta per gjini, etni dhe persona me aftesi te kufizuar, ne perputhje me principet e BE.





Krijimi i kapaciteteve do te jete nje element i rendesishem i programit. Ai do te synoje ne intensifikimin dhe konsolidimin e dialogut nder-kufitar dhe marredhenieve institucionale ndermjet institucioneve lokale dhe rajonale si dhe shoqerise civile, me qellim permiresimin e bashkepunimit dhe ndarjes se experiences ndermjet paleve kryesore te interesuara, si dhe permiresimit te kapaciteteve per te manaxhuar projekte nder-kufitare.

Masat e paraqitura me lart pasqyrojne nje informacion te detajuar ne lidhje me aktivitetet perkatese si edhe per grupet perfituese. Per secilen mase eshte propozuar nja grup treguesish cka do te sherbeje per te vleresuar ne menyre te pershtatshme efektivitetin e procesit te implementimit te programit te bashkepunimit nder-kufitar. Ato ofrojne nje instrument te dobishem e konkret per te matur jo vetem rezultatet sasore por edhe ato cilesore te programit.

3.1 **DREJTIMI** PRIORITAR 1 Promovimi i afersise rajonale dhe konkures nepermjet nje qendrimi i cili integron zhvillimin ekonomik, ambiental dhe social

Analiza e situates si dhe ajo SWOT se bashku me informacionin e marre prej perfituesve ne te dy anet e kufirit, demonstrojne ne menyre te qarte nevojën per nderhyrje ne ato zona te cilat mbeshtesin zhvillimin ekonomik afrimin kulturor dhe social. Pas konsultimeve te gjera me palet e interesuara, u vendos qe fokusi i ketij programi te vihet ne menyre specifike tek ato nderhyrje te cilat kane si synim promovimin e afersise rajonale dhe konkures nepermjet nje qendrimi qe integron zhvillimin ekonomik,

ambiental dhe social.

Ideja kryesore e ketij prioriteti eshte e bazuar ne faktin qe te dyja zonat perfituese jane te pershtatshme per sa i perket burimeve individuale dhe nevojave. Gjate dekadash nuk eshte shfrytezuar mundesia per bashkepunim, per ten dare vlerat dhe potencialet e perbashketa per zhvillim ekonomik dhe kohezion social, nderkohe qe vendet po i kapercejne problemet e tyre te tranzicionit. Ky program ka si synim qe t'i fuqizojte me tej iniciativat te cilat synojne ne menyre individuale zhvillimin e ketyre rajoneve.

Ky prioritet i programit do te kontribojte ne cilesine e jeteses dhe standardet e saj duke ofruar mundesi per shkembime dhe partneritete me te gjera me interes te perbashket ne te dy anet e kufirit. Aksionet qe duhen implementuar priten te kene ndikim ne permiresimin e cilesise se sherbimeve, te krijojne vende pune, mundesi ndermarrjeje, lehtesira ne mbeshtetje te biznesit dhe te situates se ambientit.

Masat ne kuadrin e ketij prioriteti te programit kane nje spekter relativisht te gjere nderhyrjesh.

Nderhyrjet do te mbeshtesin zhvillimin ekonomik me fokus (por jo vetem) tek turizmi, per arsye se turizmi konsiderohet te kete nje potencial te madh per rajonin ne teresi. Pervец kesaj do te mbeshteten shkembimet me karakter kulturor dhe ato social.

- Nje pjese e programit eshte ideuar ne mbeshtetje te masave per mbrojtjen e ambientit, ndergjegjesimit dhe respektimit te aspekteve te ambientit me fokus te vecante tek Liqeni I Shkodres.

Partneriteti dhe bashkepunimi person-me-person eshte nje element kyc i ketij programi. Ai do te kerkoje te permiresojte fluksin e shkembimit te eksperiencës dhe komunikimit ne te dy anet e kufirit. Aksionet nen kete mase do te lehtesojne ne menyre intensive forcimin e komuniteteve lokale dhe OJQ-ve dhe te promovojne afersine sociale.

Duhet permendur gjithashtu se masat dhe aksionet e parashikuara ne kuadrin e ketij programi synojne qe te jene realiste ne lidhje me arritjet duke patur parasysh burimet e kufizuara financiare ne dispozicion. Sigurisht qe nje pjese e konsiderueshme e problemeve te identifikuar ne analizat e situates dhe SWOT, nuk do te mund te mbeshteten. Nje nga keto fusha per fat te keq do te jete sidomos modernizimi i infrastruktures, i cili do te kerkonte financime mjaft te medha.

Ky prioritet do te perfshije tre masa specifike:

Nr.	Masa
Masa 1	Zhvillimi ekonomik me theks ne promovimin e turizmit
Masa 2	Mbrojtja dhe promovimi i ambientit
Masa 3	Permiresim i afersise sociale nepermjet veprimeve person-me-person

3.1.1 MASA 1 - Zhvillimi ekonomik me theks ne promovimin e turizmit

Objektiva specifike e kesaj mase eshte:

- Promovimi i zhvillimit ekonomik ne zonen e mbuluar nga programi nepermjet vleresimit te potencialeve te saj turistike dhe kulturore.

Kjo mase do te fokusohet kryesisht tek aksionet ne mbeshtetje te promovimit te kesaj zone kufitare si destinacion turistik.

Aksionet do te synojne te ndihmojne promovimin e aktiviteteve ekonomike lokale dhe krijimin e kushteve te favorshme per permiresimin e cilesise se sherbimeve, konkurences dhe terheqjes nga turizmi dhe shkembimet kulturore.

Ideja e nderhyrjeve si pjese e kesaj mase bazohet ne faktin se ekzistenca e burimeve te pasura dhe te favorshme natyrale si edhe vendet me rendesi historike dhe kulturore ne te dy anet e kufirit, e bejne turizmin sektorin me potencial i cili mund te kontribuojte jo vetem ne promovimin e zhvillimit ekonomik, por gjithashtu edhe ne intensifikimin e shkembimeve kulturore dhe valorizimin e trashegimise dhe identitetit historik te zones se perfshire ne program.

Promovimi i turizmit ne zonen e mbuluar nga programi do te konsistoje ne krijimin e avantazheve

dhe mbështetjes për bashkëpunimin ndër-kufitar nëpërmjet një procesi të ndarjes dhe shkëmbimit të njohurive dhe informacionit.

Programi do të inkurajojë iniciativat për modernizimin e shërbimeve të turizmit nëpërmjet zhvillimit të shërbimeve të përbashkëta të konsulencës së biznesit, duke stimuluar një ndërveprim të rregullt ndërmjet bizneseve të ndodhura në rajonin që përfshin të dy anët e kufirit, me anë të: rrjeteve biznes–me-biznes, marketing dhe promovim i përbashkët si në tregjet vendase ashtu edhe në ato të BE, përmirësim i inovimit me anë të bashkëpunimit me organizatat e edukimit për shërbimet e inovimit dhe trainimeve profesionale, investime të zgjedhura në infrastrukturën e biznesit, promovimit të imazhit të zonës kundrejt investitoreve dhe vizitoreve potenciale.

Rezultatet e pritshme do të kenë një impakt në aktivitetet e ndërmarrë për promovimin e turizmit në të dy anët e kufirit si dhe në përmirësimin e shërbimeve të vlerave kulturore dhe historike dhe të diversitetit kulturor, si karakteristika unike të cilat ndajnë mes tyre këto zona në të dy anët e kufirit.

Tabela e mëposhtme jep një përmbledhje të aktiviteteve indikative dhe të përfituesve potenciale që duhen mbështetur në këto mëse, ashtu si edhe indikatorët e përfituesve dhe monitorimit.

DREJTIMI	Promovimi i afërsisë rajonale dhe konkurrueshmërisë nëpërmjet një qëndrimi i cili integron aktivitetet ekonomike, ambientale dhe sociale.	
PRIORITAR I		
MASA 1.1	Zhvillimi ekonomik me theks në promovimin e turizmit	
Veprimet Indikative		Përfituesit

- Mbeshtetje ndaj aksioneve te perbashketa innovative me synim futjen e praktikave te reja turistike; - Krijimi i rrjeteve dhe shoqatave me qellim arritjen e nje zhvillimi te koordinuar te aktiviteteve te perbashketa te biznesit - Transferimi i njohurive me qellim permiresimin e aftesive te njerezve per te bere biznes si dhe per teknologji te reja, marketing, promovim, etj. - Aktivitete te perbashketa per zhvillimin e infrastruktures baze per mbrojtjen e trashegimnise historike, kulturore, artistike dhe gjuhesore ne zonen nderkufitare; - Marketingu dhe aktivitete te perbashketa per te nxjerre ne pah produktet tipike te zones nderkufitare; - Zhvillimi i aktiviteteve te cilat synojne mbeshtetjen e bashkepunimit ndermjet SME-ve, organizatave te edukimit si dhe atyre kerkimore & te zhvillimit per permiresimin e inovimit dhe teknologjise ne biznese. - Projekte te perbashketa trainimesh profesionale ne perputhje me kerkesat e tregut dhe nevojat sektoriale per njohuri. - Studime kerkimore per identifikimin e hapsirave te treg, mundesive per biznes, produkte me vlere te larte, perhapje e rezultateve net e dy anet e rajonit kufitar. - Iniciativa te perbashketa per percaktimin e orientimeve te zones nderkufitare (p.sh. multi-media, tourizmi, ICT, perpunimi ushqimor, elektronika, bioteknologjia) - Stimulimi i perdorimit te ICT ne prodhim per informacionin rreth turizmit dhe marketing & manaxhim te SME-ve. - Mbeshtetje per rikrijimin apo permiresimin e infrastrukturave te vogla turistike (shtigje per ecje, pista per cikliste, qendra per pajisjen e vizitoreve, pika informacioni, qendra te rrjeteve turistike)	- Njesite e Qeverisjes Vendore (Rajonet, Bashkite dhe Komunat) - Shoqatat Profesionale, - Dhomat e Tregtise; - Institucionet/agjensite kombetare dhe lokale; - Ndermarrjet publike; - Institucionet e edukimit dhe ato kerkimore; - Qendrat per Trainimin Profesional - Organizatat ne Mbeshtetje te Biznesit - SME-te - Zyrat Lokale te Punes OJQ-te
TREGUESIT ²²	
Treguesit e verifikueshem te objektivate	
	Numri i nderhyrjeve per t'u zbatuar (45)
	Numri i aktiviteteve te perbashketa per promovimin e praktikave te reja ne turizem (6)
	Numri i studimeve kerkimore per te identifikuar boshlleqet e tregut, mundesite e tregut, produktet me vlere te larte. Perhapjen e rezultateve neper rajonin kufitar (4)
	Numri i aksioneve qe fokusohen ne aktivitetet inovative (11)
	Numri i kontakteve te biznesit dhe aktiviteteve te partneritetit te organizuara (6)
	Numri i trainimeve/seminareve dhe konferencave te perbashketa te organizuara (11)
Treguesit e rezultateve	Numri i projekteve te infrastruktures ne shkalle te vogel te implementuara (7)
	Territor nderkufitar qe eksperimenton manaxhimin e perbashket te zonave turistike
	Firma dhe institucione te perfshira ne projekte qe kane te bejne me turizmin/ aktivitete qe kane te bejne me zhvillimin rajonal
	Iniciativa dhe aktivitete promovuese
	Ri-vleresim/permiresim I trashegimnise dhe objekteve kulturore

²² Treguesit jane llogaritur vetem per periudhen 2007-2009 per te cilat eshte percaktuar tashme niveli I financimit

Treguesit e impaktit	Bashkepunim i qendrueshem i rritur ndermjet entiteteve publike ne sektoret e turizmit dhe te kultures
	Shumellojshmeri me e madhe e produkteve dhe ofertave turistike dhe kulturore
	Volum me i madh i biznesit ne sektorin e turizmit nder-kufitar
	Potencial me i madh per perdorimin e metodave dhe aplikimeve inovative te bizneseve
	Nivel me i larte i bashkepunimit ndermjet institucioneve publike dhe private ne zonen kufitare
Treguesit e procedurave dhe te progresit	
	Numri i aplikimeve te paraqitura
	Shkalla (%) e projekteve te aprovuara kundrejt aplikimeve te paraqitura
	Shkalla (%) e projekteve te aprovuara kundrejt projekteve te financuara
	Numri i projekteve te filluara
	Shkalla (%) e projekteve te perfunduara kundrejt projekteve te filluara
	Numri i projekteve te terhequra
	Numri i projekteve te anuluar

Kjo mase do te zbatohet nepermjet skemave te granteve. Specifikat ne lidhje me madhesine e projekteve, kerkesave te tjera dhe kriteret te perzgjedhjes, do te sqarohen ne dokumentat e “Ftesave per Propozim” (CfP).

3.1.2 MASA I.2 - Mbeshtetja dhe promovimi i ambientit

Zona e programimit eshte e pasur me burime natyrore dhe zona te mbrojtura. Pjesa Malazeze perfshin tre Parqe Kombetare nderkohe qe ne pjesen Shqiptare ndodhen 7 Parqe Kombetare, rezerva natyrore dhe ambiente te mbrojtura. Liqeni i Shkodres perben nje ekosistem kyc per zhvillimin e pergjithshem dhe ekuilibrin ambiental te te gjithë zones. Baseni i ketij liqeni perfshin vlera natyrore te jashtezakonshme per arsye te te rendesise biologjike, shkencore, kulturore, argetuese dhe turistike. Liqeni eshte nje nga zonat me prani zogjsh me te rendesishme te Europes Jug-Lindore.

Ekziston nje shqetesim i madhe ne lidhje me brojtjen e burimeve natyrore ne te dy anet e kufirit. Ndotjet industriale, manaxhimi i dobet i mbetjeve dhe ujrave, perdorimi i pesticideve bujqesore, gjuetia dhe peshkimi i paligjshem, ndertimet e paligjshme ne zonat urbane dhe ato turistike, jane te gjithë elemente te cilet e kane demtuar dhe vazhdojne te jene nje kercenim serioz per qendrueshmerine e ambientit ne keto zona. Ekziston nje nivel i ulet i ndergjegjesimit te popullsisë dhe komunitetit te biznesit ne lidhje me rendesine e ceshtjeve te ambientit.

Objektivi i kesaj mase eshte qe:

- Te mbeshtese iniciativa dhe veprime te perbashketa te cilat synojne mbrojtjen, promovimin dhe menaxhimin e ekosistemeve dhe zhvillimit te qendrueshem ambiental te zones.

Kjo mase do te mbeshtese bashkepunimin e organizatave per mbrojtjen e ambientit aktive ne zonen qe mbulohet nga projekti per pergatitjen dhe implementimin e planeve te manaxhimit per zonat eko-turistike me fokus kryesor ne zonen e Liqenit te Shkodres dhe rrethinave te tij.

Aksionet te cilat parashikohen te organizohen ne kuader te kesaj mase do te synojne forcimin e bashkepunimit nderkufitar nepermjet aktiviteteteve te perbashketa te ideuara per mbrojtjen e ambientit dhe te trashgegimnise natyrore.

Tabela e meposhtme jep nje permbledhje te aktiviteteteve indikative dhe te perfituesve potenciale qe duhen mbeshtetur ne kete mase, ashtu si edhe indikatorët e perfituesve dhe monitorimit.

DREJTIMI	Promovimi i afersise rajonale dhe konkurueshmerise nepermjet nje qendrimi i cili integron aktivitetet ekonomike, ambientale dhe sociale.	
PRIORITAR I		
MASA 1.2	Mbrojtja dhe promovimi i ambientit	
Aksionet indikative		Perfituesit

- Mbeshtetje per mbrojtjen dhe manaxhimin e integruar dhe mireperdorimin e ujrave siperfaqesore, duke i dhene perparesi mbrojtjes se basenit te Liqenit te Shkodres; - Mbeshtetje per zhvillimin e sistemeve dhe database-ve te monitorimit te integruar ambiental; - Aksione te ideuara per reduktimin e efekteve negative ndaj ambientit dhe inkurajimi i aktiviteteve ekonomike qe e ruajne ambientin; - Mbeshtetje per permiresimet e sistemeve te eliminimit te mbetjeve urbane dhe ujrave te zeza, me qellim mbrojtjen e zones nga ndotja ne vazhdim. - Aksione te ideuara per parandalimin dhe manaxhimin e fatkeqesive natyrore dhe demeve ambientale te shkaktuara nga njeriu - Bashkepunim nder-kufitar ndermjet organizatave te perfshira ne mbrojtjen dhe manaxhimin e mbrojtjes se ambientit dhe zonave te mbrojtura - Aksione te ideuara per te adresuar ne menyre te perbashket ndotjen ne zonen e mbuluar nga projekti; - Bashkepunim rreth ceshtjeve qe kane te bejne me dhenien e informacionit dhe ndergjesisimin e popullsise ne lidhje me rendesine, mbrojtjen dhe promovimin e ambientit dhe trashegimnise natyrore. - Pergatitje e studimeve te fizibilitetit dhe dokumentave te tjera teknike per nderhyrje ne shkalle te gjere ne infrastrukture, qe do te financoheshin nga burime te tjera jashte ketij programi.	- Njesite e Qeverisjes Vendore (Rajonet, Bashkite dhe Komunat) - Shoqatat Profesionale, - Parqet Kombetare; - Agjensite kombetare dhe lokale; - Organizatat publike ne nivel kombetar dhe lokal - Institucionet e edukimit dhe ato kerkimore; - OJQ-te
--	--

TREGUESIT ²³

-Treguesit e verifikueshem te objektivave	
	Numri i nderhyrjeve per t'u zbatuar 16)
	Numri i aktiviteteve per rritjen e ndergjegjesimit (5)
	Numri i aktiviteteve qe lidhen me sistemin e integruar te monitorimit te ambientit dhe database-et; (4)
	Numri i studimeve te fizibilitetit dhe dokumentacioneve teknike per nderhyrje te tjera te shkalles se vogel ne infrastrukture (2)
Treguesit e rezultateve	Numri i aksioneve per mbeshtetjen e mbrojtjes se integruar dhe manaxhimin e ekosistemit sensitov si dhe perdorimin e mire te ujrave siperfaqesore, duke i dhene perparesi ruajtjes se basenit te Liqenit te Shkodres. (3)
	Territori nder-kufitar i mbuluar nga manaxhimi i perbashket i zonave te mbrojtura
	Perfshirja e institucioneve qe kane te bejne me projektet per manaxhimin dhe ruajtjen e territorit
	Territori nder-kufitar i mbuluar nga sistemi i monitorimit
	% Zvogelimit te numrit te rasteve te ndotjeve nder-kufitare
Treguesit e impaktit	Burimet natyrore ne zonat nder-kufitare te perfshira ne sistemet e mbrojtjes dhe monitorimit
	Ndergjegjesim me i madh i popullsise ne lidhje me ceshtjet ambientale
	Zvillimi i ekuilibruar i zonave qe rrethojne liqenin
	Perputhje me e larte me standardet ambientale ne zonen nder-kufitare
	Permiresimi i sistemeve te manaxhimit te mbeturinave

23 Treguesit jane llogaritur vetem per periudhen 2007-2009 per te cilat eshte percaktuar tashme niveli I financimit

	Permiresim i manaxhimit te burimeve natyrore dhe nivel me i ulet i ndotjes
Treguesit e procedurave dhe te progresit	
	Numri i aplikimeve te paraqitura
	Shkalla (%) e projekteve te aprovuara kundrejt aplikimeve te paraqitura
	Shkalla (%) e projekteve te aprovuara kundrejt projekteve te financuara
	Numri i projekteve te filluara
	Shkalla (%) e projekteve te perfunduara kundrejt projekteve te filluara
	Numri i projekteve te terhequra
	Numri i projekteve te anuluar

Kjo mase do te zbatohet nepermjet skemave te granteve. Specifikat ne lidhje me madhesine e projekteve, kerkesave te tjera dhe kriterete te perzgjedhjes, do te sqarohen ne dokumentat e “Ftesave per Propozim” (CfP).

3.1.3 MASA I.3 - Permiresimi i afersise sociale nepermjet aksioneve person-me-person

Kjo mase synon ne inkurajimin e qytetareve te zonave te mbuluara nga programi qe te aktivizohen ne nje game te gjere mundesh per bashkepunim dhe krijim partneriteti. Keto lloje aksionesh person-me-person pritet qe te permiresojne drejtperdrejt fluksin e informacionit dhe komunikimit ne te dy anet e zones kufitare. Aksionet e ndermarra ne kuadrin e kesaj mase do te lehtesojne ne menyre intensive forcimin e komuniteteve lokale dhe OJQ-ve dhe do t'i inkurajojne keta aktore ne lidhjen e partneriteteve nder-kufitare. Aksionet person-me-person do te financohen nga te dy masat e mesiperme. Sinergjite ndermjet te tre masave do te ishin vecanerisht te mirepritura.

Aksionet ne kuadrin e kesaj mase do te synojne ne fund te fundit afrimin e njerezve, komuniteteve locale dhe organizatave te shoqerise civile te rajonit kufitar, duke mbeshtetur eksopozimin dhe promovimin e trashegimnise lokale nepermjet eksopozitave lokale, mbeshtetje per zejtarine dhe punimet tradicionale, zhvillimin e aspekteve kulinare dhe estetike, valorizimi dhe njohja e traditave te vjetra, etj.

Kjo mase do te zbatohet nepermjet skemave te granteve. Specifikat ne lidhje me madhesine e projekteve, kerkesave te tjera dhe kriterete te perzgjedhjes, do te sqarohen ne dokumentat e “Ftesave per Propozim” (CfP).

Tabela e meposhtme jep nje permbledhje te aktiviteve indikative dhe te perfituesve potenciale qe duhen mbeshtetur ne kete mase, ashtu si edhe indikatoret e perfituesve dhe monitorimit.

DREJTIMI	Promovimi i afersise rajonale dhe konkurueshmerise nepermjet nje qendrimi I cili integron aktivitetet ekonomike, ambientale dhe sociale.	
PRIORITAR I		
MASA I.3	Permiresim i afersise sociale nepermjet aksioneve person-me-person	
Aksionet indikative		Perfituesit

- Aksione per permiresimin e fluksit te informacionit dhe komunikimit ndermjet rajoneve kufitare; - Shkembime kulturore lokale; - Mbeshtetje per organizatat jo-qeveritare te cilat jane perfshire ne aktivitetet per perfshirje sociale - Mbeshtetje per programme te perbashketa bazuar ne perdorimin e asetave multietnike; - Iniciativa edukimi dhe trainimi; - Mbeshtetje per aktivitetet te perbashketa qe lidhen me mbrojtjen e ambientit - Aktivitetet per shkembime te rinise ne te dyja anet e kufirit - Organizimi i ekspozitave dhe panairove lokale; - Aktivitete promovuese per trashegimnine kulturore apo atraksionet natyrore; - Aksione dypaleshe per zgjidhje te perbashket te problemeve te perbashketa sociale. - Mbeshtetje ndaj prezantimeve te praktikave dhe modeleve te BE per promovimin e shendetit ne shkolla dhe krijimi i nje sistemi ndergjegjesimi e mbrojtjeje te qendrueshem te shendetit vecanerisht per grupet me te ekspozuara dhe Romet.	- Njesite e Qeverisjes Vendore (Rajonet, Bashkite dhe Komunat) - Shoqatat Profesionale, - Dhomat e Tregtise; - Agjensite kombetare dhe lokale; - Institucionet publike ne nivel kombetar dhe lokal - Universitetet dhe institucionet kerkimore; - Institucionet VET - Shoqatat kulturore dhe sportive - OJQ-te
---	--

TREGUESIT²⁴

Treguesit e verifikueshem te objektivave	Numri i programeve te zhvilluara dhe te implementuara (32)
	Numri i programeve te perbashketa te mbeshtetura qe lidhen me perfshirjen sociale (7)
	Numri i programeve te perbashketa bazuar ne perdorimin e asetave multietnike (4)
	Numri i aktiviteteve te perbashketa kulturore te mbeshtetura (11)
	Numri i projekteve dhe aktiviteteve te organizuara qe kane te bejne me mbrojtjen e shendetit (4)
	Numri i projekteve dhe aktiviteteve qe mbeshtetin institucionet kerkimore & shkencore dhe qeverisjen lokale (7)
Treguesit e rezultateve	Territori nder-kufitar i mbuluar nga manaxhimi i perbashket i zonave te mbrojtura
	Kontakte te reja te vendosura
	Niveli i shkembimeve ndermjet institucioneve dhe OJQ-ve
	Territori nder-kufitar i mbuluar nga sistemi i monitorimit
	Ndergjegjesim me i madh i popullsise ne lidhje me ceshtjet ambientale
Treguesit e impaktit	Permiresim i nivelit te bashkepunimit ne zonen kufitare
	Nivel i permiresuar i informacionit rreth traditave te perbashketa dhe individuale te lokaliteteve te zonave kufitare
	Pershirje me e larte sociale ne zonat kufitare
	Nivel i permiresuar i bashkepunimit ndermjet komuniteteve lokale
Treguesit e procedurave dhe te progresit	Numri i aplikimeve te paraqitura
	Shkalla (%) e projekteve te aprovuara kundrejt aplikimeve te paraqitura
	Shkalla (%) e projekteve te aprovuara kundrejt projekteve te financuara

²⁴ Treguesit jane llogaritur vetem per periudhen 2007-2009 per te cilat eshte percaktuar tashme niveli I financimit

	Numri i projekteve te filluara
	Shkalla (%) e projekteve te perfunduara kundrejt projekteve te filluara
	Numri i projekteve te terhequra
	Numri i projekteve te anul luara

Kriteret e perzgjedhjes se projekteve:

Ne pergjithesi, aksionet e lejuara ne kuadrin e cdo mase duhet te permbushin kriteret e meposhtme:

- Te perfshijne partnere nga te dy anet e kufirit
- Te vendosin kontakte dhe lidhje brenda komuniteteve lokale ne zonen e mbuluar nga programi
- Te mbeshtesin lidhjet ndermjet institucioneve/organizatave perkatese nga te dy anet e kufirit
- Te inkurajojne pjesemarrje te njejte te grave dhe grupeve te izoluara
- Te jene te qendrueshme nga pikepamja e ambientit

3.2 AKSI PRIORITAR II: Asistenca Teknike për një menaxhim efektiv te programit dhe qarkullimi i informacionit

Asistenca Teknike ne kuadër te këtij programi është parashikuar me qellim qe te siguroje një menaxhim efektiv te programit dhe qarkullimi i informacionit.

Objektivat specifik te këtij prioriteti janë te:

- Përmirësoje kapacitetet e strukturave kombëtare dhe te përbashkëta për te menaxhuar programin ndërkuftar,

- Përgatisë dhe shpërndaj informacione mbi programin autoriteteve kombëtare, publikut te gjere dhe përfituesve te programit dhe te përmirësoje kapacitetet e përfituesve potenciale te përgatisin dhe me pas implementojnë projekte te një cilësie te larte, dhe

- Siguroje ekspertize teknike për vlerësimet e jashtme te programit

Asistenca Teknike do te përdoret për te mbështetur punën e dy Strukturave Operuese (OS) dhe Komitetit te Përbashkët te Monitorimit (KPM) duke siguruar një implementim, monitorim, kontroll dhe vlerësim eficient dhe efektiv te programit. Kjo do te arrihet, nder te tjera, nëpërmjet krijimit dhe vënies ne pune te një Sekretariati te Përbashkët Teknik (SPT) ne Shqipëri dhe antenës se tij ne Mal te Zi. SPT do te ketë përgjegjësi për menaxhimin e përditshëm te programit do te përgjigjet përpara Strukturave Operuese dhe Komitetit te Përbashkët te Monitorimit.

Asistenca Teknike do te mbështesë aktivitete te cilat sigurojnë përgatitjen dhe përzgjedhjen e aktiviteteve te cilësisë se larte dhe shpërndarjen e informacionit mbi këto aktivitete dhe arritjet e tyre.

Asistenca teknike do te mbuloje kostot e punonjësve dhe ato operationale te SPT dhe antenës (me përjashtim te rrogave te zyrtareve publik) për një implementim efektiv dhe eficient te programit. Buxheti I asistencës teknike do te mbuloje gjithashtu kostot ne lidhje me informimin dhe publicitetin për përfituesit potencial dhe popullatës se gjere ne zonën përfituese. Nëse shikohet e arsyeshme, asistenca teknike do te mbuloje gjithashtu kostot e ekspertizës teknike për vlerësimin e jashtëm te programit.

Një shqetësim potencial, i cili lidhet zakonisht me këto lloj programesh ndihme, mund te jete mungesa e kapaciteteve absorbuese kryesisht përse I përket gjenerimit te projekteve nga ana e aktoreve lokale dhe aktoreve kryesore te cilët do te përfitojnë nga ky program. Kjo do te adresohet me aktivitete si p.sh ndërgjegjësimi dhe informimi, trajnimi I aktoreve lokal, promovimi I rezultateve qe do te arrihen dhe qëllimet.

Komponenti I Asistencës Teknike nuk do te jete me shume se 10% i shumës totale te alokimit financiar.

Ky prioritet do te implementohet nëpërmjet 2 masave.

Nr.	Masa
Masa II.1	Administrimi, monitorimi dhe vlerësimi I programit
Masa II.2	Informimi dhe publiciteti mbi programin

Asistenca Teknike do te implementohet nëpërmjet marrëveshjeve individuale te drejtpërdrejta granti pa thirrje për propozime midis Delegacioneve te Komisionit Evropian dhe autoriteteve kombëtare respektive (koordinatorete CBC ose Strukturat Operuese). Implementimi këtyre Masave mund te kërkojë nënkontraktim nga ana e autoriteteve kombëtare për ofrimin e shërbimeve ose pajisjeve. Marrëveshjet individuale te drejtpërdrejta te grantit mund te firmosen menjëherë pas hyrjes ne fuqi te Marrëveshjes se Financimit.

3.2.1 MASA II. 1 - Administrimi, monitorimi dhe vlerësimi I programit

Objekti i kësaj mase është krijimi i kushteve për implementimin efektiv dhe eficient te programit për te garantuar përdorimin optimal dhe eficient te burimeve. Strukturat Operuese dhe Komiteti i Përbashkët i Monitorimit do te mbështeten nga kjo mase. Tabela e mëposhtme paraqet një përmbledhje te aktiviteteve indikative dhe përfituesve potencial qe do te mbështeten nga kjo mase, si dhe treguesit e përfituesve dhe ato te monitorimit.

Aksi Prioritar II	Asistence Teknike per nje menaxhim efektiv te programit dhe rrjedhes se informacionit	
Masa II.1	Administrimi, monitorimi dhe vleresimi I programit	
Aktivitetet Indikative		Perfituesit
- Pajisja ne nivelin e duhur me staf te JTS dhe antenës se tij - Mbështetje për Strukturat Operuese kombëtare ne ushtrimin e përgjegjësiave te tyre gjate procesit te menaxhimit te programit - Mbështetje për Komitetin e Përbashkët te Monitorimit ne ushtrimin e përgjegjësiave te tij për përzgjedhjen e projekteve dhe monitorimin e programit - Sigurimi i mbështetjes logjistike dhe teknike për takimet e KPM-se. - Sigurimi i trajnimit për stafin e Strukturave Operuese kombëtare - Mbështetje për përfituesit përfundimtar potencial ne përgatitjen e projekteve - Sigurimi i ekspertizës se nevojshme teknike ne vlerësimin e aplikimeve te projekteve - Mbështetje për përfituesit përfundimtar ne zbatimin e projekteve - Ngritja e sistemeve te monitorimit dhe kontrollit - Vizita ne vend tek aktivitetet e programit - Përgatitja e raporteve te monitorimit te projekteve dhe zbatimit te programit		- Strukturat Operuese - Komiteti i Përbashkët i Monitorimit - Njësitë e Qeverisjes Vendore (qarqe, bashki dhe komuna) - Shoqata profesionale, - Agjencitë kombëtare; - Institucionet e arsimit; - OJQ-te
TREGUESIT		
Treguesit e verifikueshem te objektivave		
	Numri i stafit JTS te rekrutuar	
	Numri i takimeve te JMC te organizuara	
	Numri i trajnimeve për përfituesit përfundimtar potencial	
	Numri i përfituesve te asistuar	
	Numri i projekt propozimeve te vlerësuar	
	Numri i vizitave ne vend te zhvilluara	
Numri i raporteve te monitorimit te draftuara		

Treguesit e Rezultatit	
	JTS dhe antena e tij e krijuar
	Publiciteti i njoftimeve dhe aktiviteteve
	Aktivitete te ndihmës për përfituesit ne përgatitjen e projekteve
Treguesit e Impaktit	Publikimi i studimeve dhe analizave
	Kapacitete te forcuara te stafit te Strukturave Operuese
	Rritje e efektivitetit te programit
	% e ulur e kostove jo te lejuara te kërkuara nga përfituesit përfundimtar
	Rritja e cilësisë se projekt propozimeve
Treguesit Financiar	Rritje e numrit te përgjithshëm te projekteve te prezantuara nga përfituesit përfundimtar brenda një viti
	Rritje e efciences, efektivitetit dhe vizibilitetit te nderhyrjeve
Treguesit Financiar	Norma (%) e pagesave/ planifikuara vs. burimeve
	Norma (%) e pagesave / te angazhuara vs. burimeve
	Norma (%) e fondeve te përdorura vs. fondeve te alokuara

3.2.2 MASA II. 2 - Informimi dhe Publiciteti mbi Programin

Objektivi specifik I kësaj mase është te siguroje ndërgjegjësimin mbi programin ne komunitetet kombëtare, rajonale dhe lokale te zonës se tij. Ai gjithashtu mbështet aktivitetet për rritjen e ndërgjegjësimit, ne nivel vendi me qellim te informoje qytetaret e te dy vendeve rreth programit. Tabela e mëposhtme paraqet një përmbledhje te aktiviteteve indikative dhe përfituesve potencial për tu mbështetur nga kjo masë, si dhe treguesit e përfituesve dhe monitorimit.

Aksi prioritar II	Asistence teknike për një menaxhim efektiv te programit dhe rrjedhës se informacionit	
Masa II..2	Objektivi specifik I kësaj mase është te siguroje ndërgjegjësimin mbi programin ne komunitetet kombëtare, rajonale dhe lokale te zonës se tij.	
Aktivitetet Indikative		Përfituesit
- Zhvillimi dhe funksionimi i faqes se internetit - Organizimi i aktiviteteve te ndërgjegjësimit (takime, seminare, konferenca shtypi, transmetimet ne televizion/ radio - Përgatitja e materialeve informuese dhe dokumentave te tjera promocionale; - Forume te kërkimit te partnereve; - Prodhimi dhe shpërndarja e rregullt e news letters		- Strukturat Operuese - Komiteti i Përbashkët i Monitorimit - Njësite e Qeverisjes Vendore (qarqe, bashki dhe komuna) - Shoqata profesionale, - Agjencitë kombëtare; - Institucionet e arsimit; - OJQ-te
INDIKATORET		

Treguesit e verifikueshem te objektivave	Numri i aktiviteteve te organizuara
	Zhvillimi i faqes se internetit
	Informacioni i shpërndarë
	Numri i news letters te botuara
	Numri i përdoruesve te faqes se internetit
Treguesit e Rezultatit	
	Publiciteti i njoftimeve dhe aktiviteteve
	Publikimi i praktikave me te mira
	Publikimi i studimeve dhe analizave
Treguesit e impaktit	
	Eficienca dhe efektiviteti i sistemit te komunikimit
	Rritja e ndergjegjesimit te publikut te gjere mbi programin dhe aktivitetet e tij
	Rritje e transparences se aktiviteteve te programit dhe rezultateve midis perfituesve perfundimtar
	Norma (%) e fondeve te përdorura vs. Fondeve te alokuara

4. Koherenca me programet e tjera

Shqiperia

Ne Shqiperi programet nderkufitare percaktohen ne kuader te Dokumentit Indikativ Shumevjecar te Planifikimit (MIPD). Ai gjithashtu perputhet me dokumentat strategjik si me poshte:

- Strategjia Kombetare per Zhvillimin Social dhe Ekonomik (SKZHSE), e cila perben nje kuader te pergjithshem strategjik per zhvillimin e vendit. Ajo gjithashtu thekson sektoret qe perputhen me fushat e perfshira ne kete program, te tilla si zhvillimi ekonomik, infrastruktura mjedisore, zhvillimi urban dhe rural sidomos ne zonat me te varfra dhe me te thella, zhvillimi dhe diversifikimi i industrise se turizmit, etj.

- Strategjia e Decentralizimit e cila hedh themelet per rritjen e rolit te njesive te qeverisjes vendore ne raport me aktivitetet e zhvillimit socio-ekonomik e vecanerisht zhvillimit rajonal.

- Strategjia e Zhvillimit Rajonal – Objektivat e Zhvillimit te Mijevjecarit 2003, per Rajonin e Shkodres dhe dokumenti Promovimi i Zhvillimit Lokal nepermjet MDGs 2003 – Rajoni i Kukësit. Te dy dokumentet theksojne bashkëpunimin nderkufitare si nje mjet per te mbështetur zhvillimin ekonomik dhe social te rajoneve. Ato i japin rendesi heshtjeve te mjedisit, situates shendetesore dhe ceshtrejeve te tjera sociale, perspektives se tregut te punes, integritimit social.

Mali i Zi

Ne Mal te Zi ky program ndërkufitar është përcaktuar brenda kuadrit te Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm te Malit te Zi – NSSD. Ai është ne harmoni me objektivat e mëposhtme te NSSD te cilat kane si synim te :

- Përshejtojnë rritjen ekonomike dhe zhvillimin, dhe te reduktojnë pabarazitë ne zhvillimin rajonal;

- Reduktojnë varfërinë; sigurojnë akses te barabarte tek shërbimet dhe burimet;

- Sigurojnë një kontroll eficient dhe reduktim te ndotjes, dhe menaxhim te qëndrueshëm te burimeve natyrore;

- Përmirësoje sistemin qeverisës dhe pjesëmarrjen publike; mobilizojte te gjithë aktoret, dhe te ndërtojë kapacitetet ne te gjitha nivelet;

- Ruaj diversitetin kulturor dhe identitetet

- Dokumenta te tjerë te rëndësishëm përfshijnë:

- Master Plani për Zhvillimin e Turizmit. Master Plani reflekton kërkesat për qëndrueshmëri ne nivel te planeve te zhvillimit te turizmit, si dhe ne nivel te projekteve individuale. Sigurimi i sasisë se mjaftueshme te ujit te pijshëm te cilësisë se mire dhe ndryshimet e nevojshme ligjore dhe institucionale dhe përmirësimi ne kontrollin dhe monitorimin e cilësisë se ujit ne përputhje me standardet e BE-se dhe

dispozitat e WFD, përfaqësojnë orientimet kryesore të Master planit për furnizimin me ujë dhe reformat institucionale dhe ligjore në këtë drejtim në përputhje me procesin e aderimit.

- Plani Hapësinor I Republikës së Malit të Zi i cili për momentin është në formë drafti dhe Plani Hapësinor i Zonës Bregdetare i cili është në proces aprovimi nga Parlamenti. Te dy dokumentet përcaktojnë përdorimin e hapësirës me qëllim zhvillimin e planifikuar deri në vitin 2020. Kjo është e një rëndësie të veçantë në zonën bregdetare ku ka dukshëm trysni në lidhje me mbrojtjen e burimeve natyrore dhe vlerësime për qëllime të zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit.

- Plani I Veprimit Strategjik për liqenin e Shkodrës/Skadar Mars 2007, midis Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit të Malit të Zi dhe Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujerave të Shqipërisë. Qëllimi i Planit Strategjik të Veprimit është të asistojë institucionet qeverisëse dhe grupet/institucionet e tjera të interesuara të Malit të Zi dhe Shqipërisë për të përcaktuar aktivitetet dhe projektet në nivel lokal, kombëtar dhe bilateral, me qëllim përmirësimin e menaxhimit mjedisor dhe mbështetëse përdorimin e qëndrueshëm ekonomik të burimeve natyrore të Liqenit të Shkodrës/Skadar dhe rrethinave të tij. Plani Strategjik i Veprimit ka gjithashtu si synim lehtësimin e sigurimit të informacionit dhe shkëmbimit të tij midis aktoreve, për të krijuar një kuadër me baze të gjera për aktivitetet ndërkufitare dhe ndër-sektoriale në të ardhmen për menaxhimin e Liqenit dhe të përcaktojë iniciativat dhe procedurat që duhet të ndërmerren për arritjen e këtyre objektivave.

Ky program ndërkufitar është gjithashtu koherent me programe të tjera IPA si programi IPA Adriatik dhe Programi Hapësira e Evropës Juglindore.

SEKSIONI III DISPOZITAT FINANCIARE

1. Plani i Alokimit Financiar 2007-2009

Plani i alokimit financiar bazohet në MIPD. Shumat e bashkëfinancimit të BE-së dhe kombëtar të propozuara për Programin ndërkufitar IPA Shqipëri – Mal i Zi është treguar në Tabelën më poshtë. Kontributi i Komunitetit është llogaritur në raport me shpenzimet e lejuara, të cilat për këtë program ndërkufitar bazohet në shpenzimet totale, siç është rënë dakord mes vendeve pjesëmarrëse dhe parashikuar në programin ndërkufitar.

AKSI PRIORITAR		SHQIPERIA				MALI I ZI			
		Financimi i Komunitetit	Financimi Kombëtar	Financimi Total	Përqindja e kontributit të Komunitetit	Financimi i Komunitetit	Financimi Kombëtar	Financimi Total	Përqindja e kontributit të Komunitetit
		(a)	(b)	(c) = (a)+(b)	(d)= (a)/(c)	(a)	(b)	(c) = (a)+(b)	(d) = (a)/(c)
2007	1:Promovimi i kohezionit dhe konkurences rajonale	767,700	135,476	903,176	85%	540,000	95,294	635,294	85%
	2 - Asistenca Teknike	85,300	15,053	100,353	85%	60,000	10,588	70,588	85%
	TOTAL	853,000	150,529	1,003,529	85%	600,000	105,882	705,882	85%
2008	1:Promovimi i kohezionit dhe konkurrueshmerise rajonale	675,000	119,118	794,118	85%	540,000	95,294	635,294	85%
	2 - Asistenca Teknike	75,000	13,235	88,235	85%	60,000	10,588	70,588	85%
	TOTAL	750,000	132,353	882,353	85%	600,000	105,882	705,882	85%
2009	1:Promovimi i kohezionit dhe konkurrueshmerise rajonale	765,000	135,000	900,000	85%	540,000	95,294	635,294	85%
	2 - Asistenca Teknike	85,000	15,000	100,000	85%	60,000	10,588	70,588	85%
	TOTAL	850,000	150,000	1,000,000	85%	600,000	105,882	705,882	85%
TOTALI I MADH		2,453,000	432,882	2,885,882	85%	1,800,000	317,646	2,117,646	85%

SEKSIONI IV DISPOZITAT E IMPLEMENTIMIT

Dispozitat e Implementimit te programit ndërkufitar IPA Shqipëri – Mal i Zi janë ne përputhje me Rregulloren e Komisionit (EC) Nr 718/2007 (këtej e tutje referuar si 'Rregullorja e Implementimit IPA'), qe implementon Rregulloren e Këshillit (EC) Nr 1085/2006 qe krijon një instrument për ndihmën e para-aderimit.

Ne përputhje me Nenin 10(2) te Rregullores se Implementimit IPA, te dy vendet do te menaxhojnë programin sipas modelit te menaxhimit te centralizuar, ku Delegacionet respektive te Komisionit Evropian do te jene Autoritete Kontraktuese.

1. Strukturat e Programit

1.1 Strukturat organizative ne nivel kombëtar

Ne përputhje me nenin 32(2) te Rregullores se Implementimit IPA, ne secilin vend Koordinatori Kombëtar IPA ka caktuar një Koordinator për Komponentin II IPA:

Ne Shqipëri: Ministria e Integritimit Evropian (MEI) është Koordinatori Kombëtar IPA. Brenda MEI, Drejtoria e Mbështetjes Institucionale dhe Procesit te Integritimit, Sektori i Bashkëpunimit Rajonal, koordinon aktivitetet e Komponentit II IPA

Ne Mal te Zi: Personat përgjegjës për Koordinimin IPA (Koordinatori Kombëtar IPA) ne Mal te Zi është Zëvendëskryeministri për Integrimin Evropian. Sekretariati për Integrimin Evropian është Koordinator për Komponentin II IPA. Personi përgjegjës është Sekretari i Sekretariatit për Integrimin Evropian.

1.2 Strukturat Operuese ne nivel programi

Implementimi i programit ndërkufitar do te behet nëpërmjet një Strukture Operuese (OS) (Neni 139 i Rregullores se Implementimit IPA) qe do te caktohet ne secilin vend. Këto janë:

Shqipëria	Mali i Zi
Sektori i Bashkëpunimit Rajonal ne Drejtorinë e Mbështetjes Institucionale dhe Procesit te Integritimit ne Ministrinë e Integritimit Evropian - institucioni përgjegjës për koordinimin e Instrumentit te Ndihmës se Para-aderimit (IPA 2007-2013)	Sekretariati për Integrimin Evropian - institucioni përgjegjës për koordinimin e Instrumentit te Ndihmës se Para-aderimit (IPA 2007-2013)

Struktura Operuese e secilit vend do te bashkëpunojnë ngushte ne programimin dhe implementimin e programit ndërkufitar duke krijuar një mekanizëm te përbashkët koordinimi.

Struktura Operuese janë përgjegjëse për implementimin e programit ne vendet e tyre respektive.

Struktura Operuese janë, nder te tjera, përgjegjëse për:

- Përgatitjen e programit ndërkufitar ne përputhje me Nenin 91 te Rregullores se Implementimit IPA;

- Përgatitjen e ndryshimeve te programit për tu diskutuar ne Komitetin e Përbashkët te Monitorimit (KPM);

- Emërojnë përfaqësuesit e tyre ne KPM;

- Ngrëne Sekretariatin e Përbashkët Teknik (SPT) (Neni 139.4 i Rregullores se Implementimit IPA) dhe udhëheqin punën e tij;

- Përgatisin dhe implementojnë vendimet strategjike te KPM-se, me mbështeten e SPT nëse nevojitet;

- Raportojnë Koordinatorëve kombëtar respektive IPA ne lidhje me te gjitha aspektet e implementimit te programit;

- Ngrëne një sistem, te asistuar nga SPT, për mbledhjen e një informacioni te besueshëm mbi

implementimin e programit dhe t'i siguroje te dhëna KPM-se, koordinatorëve kombëtar dhe Komisionit;

- Sigurojnë cilësi në implementimin e programit ndërkufitar së bashku me KPM;
- Sigurojnë monitorimin e angazhimeve dhe pagesave në nivel programi;
- Sigurojnë që përfituesit e granteve të marrin masat e duhura për raportimin financiar dhe menaxhimin e mirë financiar (kontrollin);
- Dërgojnë Komisionit dhe Koordinatorëve kombëtar respektive IPA, raportet vjetore dhe raportin final mbi implementimin e programit ndërkufitar pas shqyrtimit nga ana e KPM;
- Udhëheqin punën e SPT në aktivitetet e informimit dhe publicitetit;
- Promovojnë aktivitetet informuese dhe publicitetin

1.3 Autoritetet Kontraktuese (neni 139.6)

Në të dy vendet Komisioni Evropian do të jetë Autoriteti Kontraktues (CA)

Shqipëri	Mal i Zi
Delegacioni i Komisionit Evropian në Shqipëri Rruga e Durrësit Nr. 127-1 Tiranë, Shqipëri Tel.: +355-4-228 320 Fax: +355-4-230 752	Delegacioni i Komisionit Evropian në Mal të Zi 81000 Podgorice Montenegro (Delegacioni do të ngrihet së shpejti)

Në të dy vendet, në përputhje me Nenin 140(1) të Rregullores së Implementimit IPA, Komisioni Evropian mban përgjegjësinë të përgjithshme për vlerësimet ex-ante të thirrjeve për propozime dhe për dhënien e granteve, tenderimit, kontraktimin dhe pagesat.

Përgjegjësitë e Autoriteteve Kontraktuese janë, ndër të tjera, si më poshtë:

- Aprovimi i dokumentave për propozime;
- Aprovimi i përbërjes së komiteteve të përbashkëta Drejtuese;
- Aprovimi i raporteve të vlerësimit dhe listës së projekteve;
- Ulen në komitetin e përbashkët të monitorimit në rol këshillues;
- Nënshkruajnë kontratat me përfituesit e granteve, duke përfshirë rishikimin e buxhetit (me ndihmën, sipas rastit, të SOs dhe SPT);

1.4 Komiteti i Përbashkët i Monitorimit

Brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e marrëveshjes së pare të financimit në lidhje me programin, vendet përfituese do të ndërtojnë një Komitet të Përbashkët të Monitorimit sipas nenit 142 të Rregullores së Implementimit IPA.

KPM është autoriteti vendimmarrës i Programit Ndërkufitar dhe përbehet nga përfaqësues në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal të vendeve përfituese, duke përfshirë përfaqësues të Strukturave Operuese dhe aktoreve socio-ekonomik në zonat përfituese. Komisioni Evropian do të marrë pjesë në punimet e JMC në rol këshillues.

KPM do të mbledhet të paktën dy herë në vit, me iniciativën e vendeve pjesëmarrëse ose Komisionit dhe do të drejtohet nga një përfaqësues i njërit nga vendet pjesëmarrëse me rotacion.

Në takimin e tij të parë, KPM do të hartojë rregullat e procedurave dhe do të aprovojë ato në mënyrë që ushtronte misionin e tij në funksion të Rregullores së Implementimit IPA.

1.4.1 Përgjegjësitë e Komitetit të Përbashkët të Monitorimit

Përgjegjësitë e Komitetit të Përbashkët të Monitorimit janë, ndër të tjera, si më poshtë:

- Mbikëqyre programimin dhe implementimin efektiv të Programit;
- Konsiderojë dhe aprovojë kriteret për përzgjedhjen e aktivitetëve për tu financuar nga programi ndërkufitar dhe aprovojë çdo rishikim të atyre kriterëve në përputhje me nevojat e programit;
- Rishikojë periodikisht progresin e bërë drejt arritjes së objektivave specifik (dhe të kuantifikuar) të programit në bazë të dokumentave të paraqitura nga strukturat operuese.
- Ekzaminojë rezultatet e implementimit, veçanërisht arritjen e targeteve të vendosura për çdo aks prioritar dhe vlerësimet referuar në nenin 57(4) dhe 141 të Rregullores së Implementimit IPA;

- Ekzaminoje raportet vjetore dhe finale te implementimit përpara dërgimit te tyre, nga SO, NIPAC-ve respektiv dhe Komisionit (neni 144 i Rregullores se Implementimit IPA);

- Ai do te jete përgjegjës për përzgjedhjen e projekteve. Për këtë qellim, sipas rastit, ai mund t'ja delegoje këtë funksion një Komiteti Drejtues (për te luajtur rolin e komitetit vlerësues) anëtarët e te cilit do te përcaktohen nga SO-e. Përbërja e Komitetit Drejtues do te miratohet nga Delegacionet e KE-se;

- Ai mund te propozoje rishikime ose rishqyrtime te programit ndërkufitar me qellim arritjen e objektivave te nenit 86(2) te Rregullores se Implementimit IPA ose te përmirësojnë menaxhimin e tij, duke përfshirë atë financiar;

- Ai do te shqyrtoj dhe aprovoj çdo propozim për te ndryshuar përmbajtjen e programit ndërkufitar;

- Ai do te aprovoje kuadrin për detyrat e SPT.

1.5 Sekretariati i Përbashkët Teknik

Ne përputhje me Nenin 139 (4) te Rregullores se Implementimit IPA, Strukturat Operuese do te ndërtojnë një Sekretariat te Përbashkët Teknik (SPT) i cili do te asistojë KPM dhe Strukturat Operuese ne ushtrimin e përgjegjësiave te tyre. Përshkrimet e punës te anëtarëve te SPT, si dhe Rregullat e Procedurave te detajuara për SPT do te zhvillohen bashke nga SO-e.

SPT do te menaxhohet bashkërisht nga SO-e.

Sekretariat i Përbashkët Teknik është organi administrativ i programit përgjegjës për menaxhimin e përditshëm te programit. Kostot e SPT dhe antenës se tij do te bashkëfinancohen nga buxheti i Asistencës Teknike te programit, nëse aktivitetet e tyre përputhen me rregullat e BE-se.

SPT do te vendoset ne Shkodër, Shqipëri dhe do te ketë një antene ne Podgorice, Mal i Zi.

SPT do te konsistojë ne te punësuar nga te dy anët e kufirit duke siguruar aftësi gjuhësore dhe njohuritë specifike. Staf i do te kontraktohet nga SO-e respektive.

1.5.1 Përgjegjësitë e SPT dhe antenës se tij

SPT do te jete përgjegjëse, nder te tjera, për detyrat e mëposhtme:

- Do te asistojë KPM dhe SO ne ushtrimin e përgjegjësiave te tyre, duke përfshire draftimin e te gjitha raporteve te monitorimit dhe vlerësimit si dhe raportet e vlerësimit vjetor dhe atë përfundimtar.

- Do te organizojë takimet e KPM dhe do te planifikojë dhe organizojë fushatat e informimit dhe aktivitete te tjera qe synojnë rritjen e ndërgjegjësimit te publikut mbi programin.

- Do te asistojë përfituesit potencial ne kërkimin e partnereve dhe përfundimin e hartimit te projekteve.

- Do te menaxhoje procesin e thirrjes për propozime, duke përfshirë marrjen dhe regjistrimin e aplikimeve te projekteve, bere vlerësimin fillestar (p.sh. shqyrtimin e dokumentave te aplikimit nëse janë te plota apo jo dhe nëse i plotësojnë kriteret e pranimit) dhe përgatitjen e dokumentave për procesin e vlerësimit.

- Do te asistojë KPM ose Komitetin Drejtues ne vlerësimin dhe përzgjedhjen e projekteve.

- Do te përgatisë formatin e standardizuar te aplikimit te projektit, vlerësimit, kontraktimit, dhe implementimit, monitorimit dhe raportimit bazuar sa me shume ne formatin dhe modelet e përfshira ne PRAG.

- Do te organizojë dhe menaxhoje një baze te dhënash ad-hoc te programit, ne baze te informacionit te marre drejtpërdrejt gjate thirrjes për propozime dhe atij te dhënë ne mënyrë te rregullt nga SO-e;

- Do te planifikoj aktivitetet ne përputhje me planin e punës vjetor te aprovuar nga KPM.

SPT ne bashkëpunim me KPM do te zhvilloje një strategji te përgjithshme për informimin dhe publicitetin ne lidhje me implementimin e programit dhe një sistemi te përgjithshëm për marrëdhëniet me publikun ne kuadër te këtij programi;

- Te zhvilloje dhe mirëmbaj faqen e internetit;

- Te mbaje marrëdhëniet e duhura publike dhe komunikimin me median;

- Te përgatisë materiale informimi dhe publicitetit;

- Te organizojë zhvillimin e projekteve te përbashkëta, seminare dhe konferenca;

- Te përfshijnë përfaqësues te Komisionit Evropian ne informim dhe publicitet,

- Te caktojë një person përgjegjës për informimin dhe publicitetin.

1.6 Përfituesit e Programit

Përkufizimi i përfituesve udhëheqës dhe përfituesve të tjerë

Ne përputhje me Nenin 96(3) të Rregullores së Implementimit IPA, nëse ka disa përfitues final të një aktiviteti në secilin vend pjesëmarrës, ata do të caktojnë një përfitues udhëheqës midis tyre përpara prezantimit të propozimit për një projekt. Përfituesi udhëheqës do të marrë përgjegjësitë e përcaktuara me poshtë në lidhje me implementimin e projektit.

Përgjegjësitë e Përfituesit udhëheqës dhe përfituesve të tjerë

Përgjegjësitë e përfituesit udhëheqës

Ne përputhje me dispozitat e nenit 96(3) të Rregullores së Implementimit IPA, përfituesi udhëheqës do të marrë përgjegjësitë si me poshtë për pjesën e projektit që zhvillohet në vendin e tij respektiv :

- Do të përcaktojë arranzhimet për marrëdhëniet e tij me përfituesit përfundimtar në pjesën e projektit që zhvillohet në vendin e tij respektiv në një marrëveshje që përfshin, ndër të tjera, dispozita që garantojnë menaxhimin e mirë financiar të fondeve të alokuara për projektin, duke përfshirë arranzhimet për kthimin e shumave që nuk janë paguara siç duhet;
- Do të jetë përgjegjës për të siguruar që projekti po implementohet në vendin e tij respektiv;
- Do të jetë përgjegjës për transferimin e kontributeve të Komunitetit tek përfituesit përfundimtar pjesëmarrës në projekt në vendin e tij respektiv;
- Do të sigurojë që shpenzimet e paraqitura nga përfituesit përfundimtar në projekt janë paguar me qëllim implementimin e projektit dhe korrespondojnë me aktivitetet e rena dakord midis përfituesit përfundimtar që marrin pjesë në të.

Përfituesit udhëheqës nga vendet pjesëmarrëse do të sigurojnë një koordinim të ngushtë midis tyre për implementimin e projektit.

Përgjegjësitë e përfituesve të tjerë

Çdo përfitues që merr pjesë në një projekt do të:

- Marrë pjesë në projekt;
- Do të jetë përgjegjës për të siguruar implementimin e aktiviteteve që ka në përgjegjësi në përputhje me planin e projektit dhe marrëveshjen e nënshkruar nga partneri udhëheqës;
- Bashkëpunojë me partnere të tjerë përfitues në implementimin e projektit dhe raportimin mbi monitorimin;
- Sigurojë informacionin e kërkuar për auditim nga organet e auditit përgjegjëse për të;
- Marrë përgjegjësi në rastin e një parregullsie në lidhje me shpenzimet të cilat janë deklaruar, duke përfshirë ripagesën përfundimtare tek Komisioni;
- Jete përgjegjës për masat e informimin dhe komunikimin për publikun.

Partneri Udhëheqës Funksional

Në rastin e projekteve të përbashkëta (ku Përfituesit Udhëheqës nga të dyja anët marrin pjesë dhe nënshkruajnë kontratat veç e veç me Autoritete Kontraktuese të Shqipërisë dhe Malit të Zi,) 2 Përfituesit Udhëheqës do të caktojnë midis tyre një Partner Udhëheqës Funksional përpara dorëzimit të projekt propozimit.

Partneri Udhëheqës Funksional është:

- Përgjegjës për koordinimin e përgjithshëm të aktiviteteve të projektit në të dy anët e kufirit;
- Përgjegjës për organizimin e takimeve të përbashkëta të partnereve të projektit;
- Përgjegjës për t'i raportuar SPT mbi progresin e përgjithshëm të projektit të përbashkët

2. Rregullat e Implementimit

2.1 Rregullat Baze të Implementimit

Programi ndërkufitar do të financojë aktivitete të përbashkëta të cilat do të përzgjidhen bashkërisht nga vendet pjesëmarrëse nëpërmjet një thirrje të vetme për propozime që mbulon gjithë territorin përfitues.

Projektet e përzgjedhura do të përfshijnë përfitues përfundimtar nga të dy vendet, të cilët do të bashkëpunojnë në të paktën një nga mënyrat e mëposhtme: zhvillim i përbashkët, implementim i përbashkët, staf i përbashkët dhe financim i përbashkët (neni 95 i Rregullores së Implementimit IPA).

KPM është përgjegjës për përzgjedhjen e projekteve.

Autoriteti Kontraktues është përgjegjës për lëvrimin e kontratave të grantit si dhe kontrollet ex-ante të procesit të dhënies së granteve.

2.2 Thirrja për propozime

Procedurat e dhënies së granteve do të jenë në përputhje me dispozitat e Rregullores së Implementimit IPA (p.sh. neni 95, 96, 140, 145, etj.)

Sipas rastit, procedurat dhe formatet standard dhe modelet e PRAG-ut duhet të ndiqen, me përjashtim të rasteve kur dispozitat e Rregullores së Implementimit IPA dhe/ose natyra e thirrjeve të përbashkëta kërkon ripërshtatje.

a) Përgatitja e Paketës së Aplikimit

1. SPT, nën mbikëqyrjen e KPM, drafton thirrjet e vetme për propozime, Guidën për aplikuesit dhe formën e aplikimit dhe dokumenta të tjera për implementimin e skemës së granteve, duke shpjeguar rregullat që kanë të bëjnë me aplikimet dhe partneret, llojet e aktiviteteve dhe kostot e lejueshme për tu financuar dhe kriteret e vlerësimit, duke u munduar t'i qëndrojnë sa më afër formateve të parashikuara në PRAG;

2. Forma e Aplikimit duhet të mbulojë të dyja palët në projekt (në të dyja anët kufirit d.m.th. aplikimin e përbashkët), por me ndarje të qarte të aktiviteteve që do të zhvillohen në secilën anë të kufirit. Elementet që përmban Paketa e Aplikimit (kriteret e pranimit dhe të vlerësimit, etj.) duhet të jenë plotësisht konsistent me Marrëveshjen e Financimit përkatëse.

3. Me të aprovuar nga KPM, SO-e respektive i paraqesin thirrjen për propozime, Guidën për aplikuesit dhe anekset e tij Delegacioneve respektive të KE-së për aprovim ;

b) Publikimi i thirrjeve të vetme për propozime

4. Kur lançohen thirrjet për propozime, SO, me ndihmën e SPT, marrin të gjitha masat e duhura për të siguruar që thirrjet për propozime të cilave u është bërë publicitet në nivel kombëtar dhe rajonal, të arrijnë tek target-grupet në përputhje me kërkesat e Guidës Praktike. Paketa e aplikimit do të vihet në dispozicion në faqen e internetit të programit dhe ato të Delegacioneve të KE-së (Autoriteti Kontraktues) dhe në format të printuar;

5. SPT është përgjegjëse për fushatat e informimit dhe dhënien përgjigjeje aplikuesve potenciale. SPT këshillon aplikuesit potencial të projekteve për të kuptuar dhe formuluar në mënyrën e duhur formatet e aplikimit.

6. FAQs duhet të jenë të botuara në faqet e internetit të programit dhe Delegacioneve të KE-së.

2.3 Përzgjedhja e projekteve pas thirrjes për propozime

Siç parashikohet në Rregulloren e Implementimit IPA, projekt-propozimet e paraqitura do t'i nënshtrohen procesit të përzgjedhjes. Vlerësimi i projekteve do të ndjekë rregullat e PRAG-ut (Kapitulli 6.4.) si amenduar nga dispozitat e Rregullores së Implementimit IPA (p.sh. neni 140 mbi rolin e Komisionit në përzgjedhjen e projekteve)²⁵. Një Komitet i Përbashkët Drejtues, dizenuar nga KPM, do të vlerësojë projektet kundrejt kriterëve të caktuar në Paketën e Aplikimit dhe do të përgatisin një listë me projekte sipas PRAG-ut. Mbi atë bazë, KPM do t'i dërgojë vendimin përfundimtar mbi projektet e rekomanduara për financim Autoriteteve Kontraktuese (Delegacioneve të KE-së).

Hapat kryesore të kësaj procedure duhet të jenë si më poshtë:

25 IPA Implementing Regulation for Component II provides, *inter alia*, a certain degree of decentralisation in the evaluation and selection process, namely in beneficiary countries where IPA funds are managed under a centralised approach (e.g. where the evaluation committee is nominated by the national authorities sitting in the JMC, not by the Commission i.e. the Contracting Authority).

- Projekt propozimet e ardhura mblidhen dhe regjistrohen nga SPT.
- KPM është përgjegjës për vlerësimin e projekt propozimeve ne përputhje me kriteret e pranimit; gjithsesi, kur shihet si e nevojshme, ai mund te caktojë një Komitet te Përbashkët Drejtues, KPD, për vlerësimin e përputhshmërisë administrative, pranimit dhe vlerësimit te cilësisë teknike dhe financiare te propozimeve.
- Anëtarët e KPD përzgjidhen ekskluzivisht ne baze te ekspertizës teknike dhe profesionale ne fushat përkatëse. Delegacionet e KE-se mbështesin përbërjen e KPD. Një vëzhgues i caktuar nga Delegacionet e KE (autoriteti kontraktues) mund te marre pjese ne punimet e tij.
- Te dy SO mund te propozojnë te njëjtin numër vlerësuesish te jashtëm për tu paguar nga fondet respektive te AT.
- KPD vlerëson projektet kundrejt kushteve dhe kriterëve te vendosura ne paketën e aplikimit te thirrjes për propozime dhe ne përputhje me procedurat e PRAG-ut.
- KPM merr nga KPD Raportin e Vlerësimit dhe listën e projekteve dhe e voton atë. Anëtarët e KPD janë prezent ne takimin e KPM për te prezantuar procesin e vlerësimit. KPM ka mundësinë te:
- Pranojë Raportin e Vlerësimit dhe i rekomandon autoriteteve kontraktuese te nënshkruajnë kontratat e projekteve te përzgjedhura;
- Kërkojë një raund re-shqyrtimi te projekt propozimeve nëse një maxhorancë e kualifikuar e anëtarëve te tij votojnë një gjë te tille, me kusht qe te ketë një arsye teknike te shprehur qarte qe ndikon ne cilësinë e Raportit te Vlerësimit d.m.th nuk është e qarte se si projektet janë vlerësuar dhe listuar;
- Hedh poshtë Raportin e Vlerësimit dhe listën e projekteve, nëse ka një arsye te justifikuar për te dyshuar objektivitetin ose kualifikimet e KPD;
- Ne asnjë rast KPM nuk ka te drejte te ndryshojë piket e KPD ose rekomandimet dhe nuk duhet te ndryshojë tabelat e vlerësimit te plotësuar nga vlerësuesit.
- Delegacionet e KE-se aprovojnë Raportin e Vlerësimit mbi procesin e përzgjedhjes dhe listën përfundimtare te granteve qe do te jepen. Nëse kërkohet, Delegacionet e KE-se mund te kërkojnë sqarime nga KPM.
- SPT njofton çdo aplikant me shkrim mbi rezultatet e procesit te përzgjedhjes
- Delegacionet e KE-se ne secilin vend lëvrojnë kontratat e granteve partnereve udhëheqës respektiv te secilit projekt te përzgjedhur.

3. Informimi, Publiciteti dhe Konsultimi

Vendet përfituese dhe Koordinatorët Kombëtar IPA do te sigurojnë informimin mbi programin dhe publicitetin e tij dhe aktivitetet me ndihmën e SPT, sipas rastit.

Ne përputhje me Nenin 90 te Rregullores (EC, Euratom) Nr 1605/2002, Komisioni do te publikojë informacionin e duhur mbi kontratat. Komisioni do te publikojë rezultatet e procedurave te tenderit ne Gazetën Zyrtare te Bashkimit Evropian ne faqen e internetit EuropeAid dhe medias, ne përputhje me procedurat e aplikueshme te kontratave për veprimet e jashtme te Komunitetit.

Masat e informimit dhe publicitetit paraqiten ne formën e një plani komunikimi ndërsa implementimi do te jete përgjegjësi e SO respektive dhe Koordinatorëve te Komponentit te dyte IPA. Një plan i detajuar informimi dhe publiciteti do t'i paraqitet ne një forme te strukturuar KPM nga SPT (shih me poshtë), ku do te përcaktohen qarte qëllimet dhe target grupet, përmbajtja dhe strategjia e masave dhe një buxhet indikativ i financuar nga Asistenca Teknike e programit.

Masat e veçanta te informimit dhe publicitetit do te fokusohen kryesisht ne:

- Sigurimin e një shpërndarje sa me te gjere te programit ndërkufitar (përkthyer ne gjuhen vendase) midis aktoreve dhe përfituesve potencial.
- Sigurimin e materialeve te publicitetit, organizimin e seminareve dhe konferencave, informacionet e shkurtra për median dhe funksionimin e një faqe interneti te programit për te rritur ndërgjegjësimin dhe interesin dhe për te inkurajuar pjesëmarrjen;
- Sigurimin e publicitetit me te mire te mundshëm te thirrjes për propozime.
- Publikimin e listës se përfituesve përfundimtar.

4. Monitorimi dhe Vlerësimi

4.1 Monitorimi ne nivel projekti

4.1.1 Detyrimet Kontraktore

Përfituesit udhëheqës i dërgojnë Autoriteteve Kontraktuese respektive Raportet e Ndërmjetme dhe atë Final ne forme narrative dhe financiare ne përputhje me kushtet standarde te kontratave te tyre te grantit.

4.1.2 Raportimi ne nivel te projekteve ndërkufitare

Përveç te tjerave, sipas rastit, Partneri Udhëheqës Funkcional i projektit i paraqet SPT Raport Progresin e Projektit, duke dhënë një përshkrim te shkurtër te aktiviteteve te projektit dhe arritjet ne te dy anët e kufirit dhe koordinimin e tyre ne përputhje me treguesit ne projekt propozimin e përbashkët.

4.2 Monitorimi ne nivel programi

Bazuar ne raportet e ecures se projekteve te mbledhura, SPT harton Raportin e Përbashkët te Implementimit dhe ia paraqet për shqyrtim KPM.

Strukturat Operuese te vendeve përfituese do t'i dërgojnë Komisionit dhe koordinatorëve kombëtar respektiv IPA, një raport vjetor dhe një raport përfundimtar mbi implementimin e programit ndërkufitar pas shqyrtimit nga KPM.

Raporti vjetor duhet te dorëzohet brenda datës 30 Qershor çdo vit; vitin e pare raporti do te dërgohet ne vitin e dyte qe pason aprovimin e programit ndërkufitar.

Raporti përfundimtar do te dorëzohet maksimumi 6 muaj pas mbylljes se programit ndërkufitar.

Përmbajtja e raporteve duhet te jete ne përputhje me kërkesat e nenit 144 te Rregulloren e Implementimit IPA.

4.3 Vlerësimi i programit

Vlerësimet do te bëhen ne përputhje me Nenin 141 te Rregullores se Implementimit IPA. Vlerësimi duhet te jete si qellim përmirësimin e cilësisë, efektivitetit dhe konsistencës se asistence se Komunitetit dhe strategjisë dhe implementimit te programit ndërkufitar ndërsa marrin ne konsiderate objektivin e zhvillimit te qëndrueshëm dhe legjislacionit Komunitar përkatës ne fushën e ndikimit mbi mjedisin.

Nuk është zhvilluar një vlerësim ex-ante ne përputhje me dispozitat e nenit 141 ne përputhje me parimin e proporcionalitetit.

Gjate periudhës se programimit, vendet pjesëmarrëse dhe/ose Komisioni Evropian duhet te bëjnë vlerësime lidhur me monitorimin e programit ndërkufitar sidomos aty ku ai monitorim tregon një zhvendosje domethënëse nga qëllimet e vena ose kur propozimet janë bere me qellim rishikimin e programit. Rezultatet duhet t'i dërgohen KPM dhe Komisionit.

Vlerësimet duhet te bëhen nga eksperte ose organe, te brendshme ose te jashtme. Rezultatet duhet te publikohen ne përputhje me rregullat e aplikueshme mbi aksesin ndaj dokumentave. Vlerësuesit duhet te financohen nga buxheti i asistencës teknike te programit.

5. Menaxhimi Financiar

Nen menaxhimin e centralizuar, Komisioni Evropian do te merret me tenderimin, kontraktimin dhe pagesat, ne baze te dokumentave te paraqitura nga përfituesit, dhe ne përputhje me rregullat e kontraktimit dhe prokurimit te përcaktuara ne dokumentin PRAG.

KPM do te siguroje qe një llogari e besueshme kompjuterike për raportimin mbi monitorimin dhe atë financiar te funksionojë, qe do te beje te mundur gjurme adekuate auditimi;

Komisioni Evropian dhe autoritetet kombëtare te auditimit do te kenë bëjnë auditimin mbi programin nderkufitar.

ANEKSI B

Marrëveshja kuadër midis Komisionit të Komuniteteve Europiane dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë është miratuar në parim nga Këshilli i Ministrave më datë 3.10.2007 me vendimin nr.642 dhe është firmosur më datë 18.10.2007 nga Ministri i Integrimit dhe Kryetari i Delegacionit të Komisionit të Komuniteteve Europiane në Tiranë. Kopja origjinale e marrëveshjes i është dërguar Ministrisë së Punëve Jashtme në datën 24.10.2007, me shkresën me nr.prot.1710 dhe është

ratifikuar nga Parlamenti në datën 10.12.2007 me ligjin nr.9840.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 258 472 (Kryeredaktori).
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2008 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 3.10.2008
Doli nga shtypi më 5.10.2008

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja “Ilar”
Tiranë, 2008

Çmimi 60 lekë